SHËNIME BIOGRAFIKE

SI E BËMË LUFTËN

(Pjesa e parë)

Skender Ibrahim Basha

**~~~

luftëtarë të paepur për çlirim e bashkim kombëtarë; Shokëve të shumtë që nuk u kursyen tërë jetën në përballje me robërinë; Luftëtarëve trima për liri që luftuan fyt a fyt me pushtuesin; Dhe dëshmorëve tanë që ranë burrërisht në fushëbeteja të përgjakshme gjithandej në troje shqiptare në lule të rinisë.

"Do ta kemi më mirë kur i bëjmë mirë atdheut". (Autori)

~~~
~~~

joserioze, dhe e cila do të jetë krejt pacifiste shoqëruar me sjellje e dukuri që po na denigronin çdo ditë ngase programi i saj s'po frymëzonte kënd; Ndërsa që kjo Lidhje, ata që ishin përpjekur e po përpiqeshin për kombin, dy herë do ti bëj të ndjeheshin keq: Herën e parë- menjëherë pasi të jetë krijuar, kur kishte përndjekë ata që po persekutonte regjimi gjakatar serb (Këtu duhet pas parasysh dallimin e madh mes këtyre dy mentaliteteve, kur ne po vinim nga burgjet e Serbisë, kurse kreu i LDK- së nga Lidhja e Komunistëve); Dhe herën tjetër, në pasluftë, kur populli i kishte dhuruar pushtetin për mos punën e saj e kjo i kishte hyrë sërish avazit të vjetër të përndjekjes, tani të luftëtarëve çlirimtar.

Fare përciptazi, ashtu kalimthi, përmendë edhe aktet me rëndësi për zhvillimet, dhe ndoshta ndonjë perceptim timin për ato, me komente fare të shkurtra mbi mënyrën se si do të doja të reflektonin gjatë veprimit të tyre në zhvillimet e kohës dhe në rrjedhën e ngjarjeve dramatike që gjithherë po ndodhnin hovshëm.

Meqë është fjala për biografi individi, nuk do të përdorë asgjë nga lëndë e shumtë e arkivuar nga veprimi im konkret. Këtu gjeni rrëfimin për të kaluarën time, shoqëruar me ndonjë koment për ngjarjet dhe rrethanat e kohës kur po ndodhnin këto ngjarje; Dhe, shkëputur, dokumentacionin nga raporte me mekanizma të sigurisë shtetërore serbe për të qartësuar ngjarje reale që nuk do të thuhen në plotësi, ose që nuk do të përmenden fare këtu.

Vë në pah sjellje devijante e veprime të dëmshme individësh, ndërsa që nuk personalizoi të thuash asgjë edhe pse nga ky kapërthim kategorish, ngjashëm me shumë të tjerë, do të pësoj edhe unë. Kjo për hir të pasardhësve, që ata të mos vuajnë nga papërgjegjësia e prindërve të tyre.

Thuhet me të drejtë se fati nuk caktohet çdo ditë, dhe se ato që mund të te ngjajnë përditë edhe nuk paraqesin fatin. I pafat është secili që lindë në kohë diktatorësh. Ja që edhe unë si shumë të tjerë do të kem fatin të jem i pafat e që për pasojë do ta kem jetën "luftë", ndërsa do të jetë përzgjedhja ime që këtë jetë "luftë" ta bëj për liri; Dhe ja, liria erdhi. Do të vije edhe bashkimi që aq shumë na duhet, madje shumë shpejt. Viti '12 është vit yni. Populli e din çka do. Kreu politik po ngecë, dhe duket të jetë i pa interesuar e pa vizionin e duhur për të ardhmen. Jemi para zhvillimeve të mëdha dhe padyshim para ndryshimeve të mëdha. Mjafton të shuhen krijesat artificiale (Shteti i

Kosovës dhe Shteti i Maqedonisë) si dhe të na lejohet shtrirje e qetë, e papengueshme, e të kufizohemi me fqinjët tanë historik. Kjo mund të bëhet fare lehtë; Në fund të fundit: Ne (kosovarët dhe maqedonasit) më mirë ndjehemi si shqiptarë dhe si bullgar. Nuk guxojmë të përsërisim gabimet, e ngjarjet le të rrjedhin me hovin dhe në kahun që iu japim ne.

Skenderi me prindërit, Feriden e Ibrahimin dhe motra, Sherifja
(Foto e vitit 1963, nga entuziasti: Azem (Zymer) Rraqi).

KAPITULLI I PARË

SHËNIME BIOGRAFIKE

Data dhe vendi i lindjes

Jam i lindur me 25 maj 1961, në rrugëtim e sipër, me qerre me kalë, për në spitalin e Prizrenit, përkatësisht nën urën në Lagjen Eglanicë-tani Dardani, në hyrje të Prizrenit.

Prindërit, vëllezërit dhe motrat

I biri i Ibrahimit dhe Ferides, të cilët kanë lindur gjithsejtë pesë fëmijë: Fatmirin (i cili do t'iu vdes pas një viti), Sherifen, Skenderin, Veziren dhe Enverin.

Shkollimi dhe përgatitja profesionale

Pas shkollës fillore, të cilën e kreva në Bukosh, kam përfunduar edhe dy shkolla të mesme: Të parën në drejtimin Biologji-Kimi në QAMO "Jeta e re" në Suharekë duke qenë nxënës i rregullt si gjithë shokët dhe shoqet e mia të gjeneratës, dhe tjetrën, në rrethana burgu, gjersa po vuaja njërin nga dënimet me burg të rëndë për veprimtari politike, në drejtimin Pylltari-Përpunim Druri, në Foçë të Bosnjë-Hercegovinës. Fakultetin e Shkencave Natyrore, drejtimin e Biologjisë, në Prishtinë, deri më tani ende nuk e kam përfunduar.

Në mësime gjithherë kam treguar sukses të shkëlqyeshëm, ndërkaq në sjellje isha shembullor. Një nga nxënësit më të mirë në shkollë. Kam përfaqësuar shkollën time kudo në gara komunale të arsimit dhe në lëndë të ndryshme mësimore.

Isha në klasën e pestë, dhe edhe pse sapo kishte filluar ora e mësimit nga gjuha shqipe, në të cilën po bënim hartim me shkrim, isha duke e përfunduar hartimin, kur në klasë na vije një nxënës nga dy klasat e teta të cilat po mbanin, së bashku, orë nga lënda e matematikës. Arsimtari, Qamil Buzhala, po më kërkonte të shkoja t'iu zgjidhja një ekuacion me dy të panjohura, problem matematik të cilin s'po mund ta zgjidhte asnjë nga shtetëdhjetëeshtatë nxënësit e të dyja këtyre klasave. Normalisht që, problemin ua kisha zgjidhur me lehtësinë më të madhe dhe që e kisha bërë të ndjehej mirë arsimtari Qamil meqë unë po shkruaja dhe po flisja, me zë të lartë, ato që po shkruaja, ndërsa që anë të tabelës po mi fshinte një nxënës nga këto klasa ngase po më duhej hapësirë për këtë; Por i kisha dhuruar kënaqësi të veçantë dhe e kisha befasuar këndshëm, në masë sa të ma jep dorën dhe të më përkëdhelë me shumë respekt e dashuri, kur këtë ekuacion, tani me nismën dhe vullnetin tim, ua e kisha zgjidhur edhe në një mënyre dhe formë tjetër duke nxjerrë sërish të njëjtin përfundim. Të përmendë se ngjashëm me shokët e shoqet e mija, edhe unë po lexoja shumë, shumë më shumë sesa kërkohej prej nesh, dhe se i pasionuar pas leximit do të mbetem tërë jetën, kurse që po rritesha

me dashurinë për shokët e fëmijërisë: Mustafë (Mulë) Basha e Nijazi (Azem) Basha.

Edukimi

Për mësuesin gjithë herë kam pas respektin e duhur. Edhe tani, mësuesve, ju fali tërë respektin, madje nuk më ndodhë ti thërras ndryshe pos "Mësues", duke aluduar në diçka më të mirën që ka njerëzimi e veçanërisht çfarë i kishim ne. Si fëmijë, kohë të gjatë kam menduar se: "Mësuesit nuk hanë bukë". E po të pyetesha: "Ç'ha mësuesi"? Do të thosha se: "Mësuesi s'ha asgjë, ngase ai është mësues".

Respektin e duhur ua kam falur, gjithë herë, të gjithë njerëzve, veçmas mësuesve që përmenda fillimisht e mandej veprimtarëve të devotshëm dhe dëshmorëve, ndërsa që kjo edukatë imja është, para së gjithash, meritë e prindërve të mijë, e gjyshit dhe gjyshes sime. Njerëzit e kohës ishin të tillë që edukatë merrnim nga secili në rreth e në farefis, ngase secili prej të rriturve përkujdesej për këtë. Që në fëmijëri të hershme, pos shokëve të gjeneratës, kisha shokë edhe nga të rriturit. Më pas, edhe unë do të shoqërohem me të vegjlit, me të tillë që dallonim shumë në gjenerata, dhe jo sa për të thënë, por me ta po bënim punë të shumta, të mëdha, nga më të ndryshme e edhe të tilla me dobi të veçantë për shoqërinë e për kombin; Ndër to edhe aso që përcilleshin me rreziqe të mëdha për ne që po vepronim. Ishim ndonjëherë edhe në krye të këtyre veprimeve, dhe duhej përgatitje e duhur, por ja që ne do ta kemi këtë përgatitje gjithherë, andaj s'kishim lejuar të pësonte kush nga veprime tona. Gjërat i bëja me përkushtimin dhe kujdesin më të madh. E tëra zhvillohej si në film, kurse unë do të krijohem e mbetem idealist.

Fëmijëria

Që në fëmijëri kam krijuar autoritet dhe kam gëzuar respekt në familje, në shoqëri, në rrethin e gjerë familjarë e në farefis. Meqë kisha lindur pas fëmijës vajzë, motrës sime Sherifes, dhe pas Fatmirit i cili iu kishte vdekur pas një viti; Prindërit dhe gjithë familjarët tjerë më kishin falë gjithë dashurinë, dhe kishin tërë përkushtimin të rritesha i shëndoshë e sa më shpejtë. Kështu kam provuar tërë

lumturin e jetës fëmijërore dhe jam rritur në ambient tepër të ngrohtë familjarë, ndërsa që shumë nga ato që thosha do të mi mbajnë mend dhe do ti marrin si të mençura.

Kur isha tri vjeç, familjarët e mi përfshirë këtu edhe axhën Avdyl që ishte më i ri se i ati im Ibrahimi, ishin ndarë nga axhët e tyre: Baftiu e Hajrushi dhe familjarët e tyre; Ndërsa që shtëpinë e kishin ndarë në tri pjesë, neve na kishin rënë hise vetëm dy dhoma të vogla gjumi, dhe s'kishim odë; E ngaqë e kisha vërejt se gjyshja ime, Hajria, ndjesë pastë, po vuante për këtë, i kisha thënë: "Të mos kishte dert, se pas një viti do ta blinim odën nga axha Hajrush, dhe se do të blinim radio të kemi në odë". Dhe vërtetë kështu do të bëhej.

Ndoshta, ishim të parët në fshat që kishim radio, ndërsa që e di mirë se ishim të parët që odën e kishim shtruar me tepihë, dhe se ishim fëmijët e vetëm në fshat që mbrëmjeve pasi të kem larë sytë, duart e këmbët; Vishnim pizhame, dhe ashtu me pizhame hynim e rrinim në odë. Këtu do të marrim gjithë edukatën e shumtë dhe do të kalojmë, vërtetë, fëmijëri të lumtur; Iu qofshim falë: Gjyshit, gjyshes dhe të dy prindërve tanë.

Pjekuria e hershme, brumosja

Nga leximet e shumta, por edhe nga mësimet që mora në ndejat, në odën që kishte pritur burra si Ramë Bllaca, me gjyshin tim-Veselin, me gjyshin tim nga nëna, - Zeqir (Abaz) Aliajn, me Destan Bajraktarin, Haxhi Zybën, Xhavit Bashën e me shumë burra të tjerë të kohës; Do të mësoj të kaluarën, sa heroike po aq edhe të dhimbshme të popullit tonë. Do të mësojë se me gjithë kryengritjet, luftërat dhe rezistencën shekullore, si dhe me gjithë sakrificën e shumë burrave e grave të kombit për ta zgjidhur përfundimisht çështjen kombëtare shqiptare, mospërputhja e kufijve të shtetit shqiptar me kufijtë etni-kulturorë, e kishte vulosur si të pazgjidhur këtë çështje.

Duke e ditur këtë e i brumosur me këtë ndërgjegje, ngjashëm me shumë shokë e shoqe të mia, me shumë vullnet, i gatshëm për çdo sfidë e çmim që do të paguaj për të vënë gurë në themelet e Shqipërisë Etnike, më gjeni të angazhuar në lëvizjen ilegale nacional- çlirimtare të kohës, e më pas do të jem gjithherë aktiv në çdo pikëpamje.

Ishte në traditën e familjes sonë të jemi të vendosur e në papajtueshmëri me pushtetin dhe me robërinë. Tregjyshi im, Bafti

(Hasan) Basha, ishte rreshtuar bashkë me burrat e tjerë nga fshati, në forcat mbrojtëse të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në krye me Sylejman Vokshin, dhe ishte pjesëmarrës aktiv në të gjitha luftërat pengesë shpërnguljeve të mëdha të elementit shqiptarë që nga Nishi, Leskovci, Prokupja e deri këtu, në gjithë hapësirat e Kosovës që përfshinte Dardania antike Ilire; Luftëtarë i paepur i kauzës kombëtare shqiptare.

Skenderi: Foto e vitit 1975.

Stërgjyshi, Malë (Bafti) Basha, ishte bashkë- veprimtar i Ramë Bllacës e bashkëluftëtar i Bajram Currit, Ymer Devetakut e Abdyl Dures; Pjesëtarë i lëvizjes Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, në lidhje të vazhdueshme me: Bajraktarin e Suharekës, Sherif Vocin, Destan Palushin e Budakovës dhe me Imer Baftiun e Jezercit; Kurse që më pas, gati gjithherë, do të jetë i shoqëruar nga: djali i tij- Veseli, nga Tahir (Mustafë) Kadriaj i Dardhishtës, Hajrush (Halit) Hyseni e Fejzë Haliti i Kashtanjevës, Abaz (Kajtaz) Aliaj, Zeqir (Abaz) Aliaj e Shaban (Nuhi) Ndreca i Maqitevës, Hasan (Halit) Emini i Mushtishtës si dhe nga Sali (Beqir) Kolgeci, Ali (Nebih) Loshi, Osman (Sylë) Basha dhe Hamëz (Veli) Matoshi, të cilin e kishte edhe shok të jetës së kaçakut të malit.

Mala ishte pjesëmarrës i Kuvendeve Shqiptare: Në Blinajë dhe në Ferizaj më 1908 si dhe pjesëmarrës aktiv në kryengritjet e vitit 1908– 1913, e në shumicën e luftërave kundër pushtuesve turq, serbo-sllav dhe austro-hungarez në Krahinën e Lumes, në Malësi të Gjakovës dhe në rrethinën e Suharekës, në Carralevë e në Gjinoc, që nga luftërat ballkanike, Lufta e Parë Botërore e deri në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore dhe më pas.

Në kohën e Mbretërisë Shqiptare, derisa Kosova ishte nën pushtimin gjerman, italian e bullgar, jetoi i rrethuar nga njerëz që kishin fituar famë e respekt për të kaluarën e tyre të lavdishme, e menjëherë pas kësaj, në ikje nga "Narodna Obrana", i shoqëruar nga Kadri (Izlam) Muqa dhe Shaqir (Fazli) Basha, do të qëndroj një kohë të gjatë në Derven e në Novosejë të Shqipërisë, mandej do të fshihet tek mbështetësit e tij: Bajram (Sylë) Rraqi, Sylë (Bajram) Shehu dhe tek Ali (Ramadan) Kolgeci, kurse më pas do të bashkohet me grupin kaçak të Abdyl Durës. Pas shkatërrimit të këtij grupi do t'i kthehet sërish këtyre mbështetësve deri në amnisti të përgjithshme. Malës ia do fati të vdes natyrshëm, më 1953. Kështu do t'i shpëtojë dhunës e terrorit të pushtetit serb në krye me Rankoviqin.

Veprimtarinë e tij atdhetare e kishte filluar si gjithë të tjerët që s'po pajtoheshin me robërinë dhe me dhunën e të huajit, ndërsa e kishte pjekur që herët përkushtimi për ta kundërshtuar e për ta ndalë këtë dhunë.

Terrorit që po ushtronte serbi mbi popullatën e pafajshme shqiptare do ti përgjigjet aty për aty. Vëllai, thoshte Mala: "Do rrahë sa herë bënë faj, qoftë ai vëllai i vogël apo i madh, kurse hasmëri e hakmarrje në mes të vëllezërve s'duhet të ketë"; "E kur vëllain ta rrahë ose ta vret i huaji, që s'është i gjakut tënd, kushdo qoftë ai, vëllait duhet marrë hakun, aq më tepër nëse i huaji këtë e bënë në vatrën, në vendin, në mallin e në pasurinë tënde". "I huaji s'të rrahë e s'të vret që ka dëshirë", thoshte Mala. "Ai e bënë këtë për ta thyer moralin, të te robëroj e që më pas të te shfrytëzoj bashkë me mallin e pasurinë tënde dhe gjithë të mirat tua, kurse që jeta e robit s'është jetë që duhet jetuar, prandaj jeto i lirë e me nderë ose vdis". "Jeta në robëri është vdekje, andaj mos lejo të vdesësh dy herë, ose të vdesësh i gjallë, por jeto i vdekur". "Në fund të fundit: Ç'të duhet jeta kur s'mund t'iu dalësh zot e ti mbrosh gjërat tua e gjërat amanet"? "Kur

s'mund ta bësh këtë, ti se meriton jetën, ndërsa edhe bukën e vendit e shkeljen e tokës e ke haram".

Në kapërthim të viteve të katrahurave të rënda, si shpesherë në të kaluarën e dhimbshme të popullit tonë, kur sado që gjaku i shqiptarit ishte derdhur rrëke, por që kishte rezultuar me njohjen e krijimit e pavarësimit vetëm të një copë toke nga areali e trungu shqiptarë, ndërsa që edhe kjo s'po njihej e s'po lehej e qetë nga fqinjët grabitqarë; Dhe kur kishin mësyrë kush sa mundte të merrte nga ky trung me qëllimin dhe me kushtin të vrisnin, prisnin e digjnin, por edhe të shpërngulnin deri në shfarosje e zhbërje të etnisë shqiptare; Në kohën kur pushteti policor e ushtarak serb po vendosej sërishmi në Kosovë, do të ndodhë që: Ramadan (Miftar) Muqa, i cili ishte kthyer në shtëpi pas njëmbëdhjetë vitesh shërbimi ushtarak në ushtrinë turke në Jemen, të ketë sjellë me vete një palë dylbi, gjë krejt e pazakontë për kohën. Këtë e kishte biseduar me shokun e tij të fëmijërisë e të rinisë së hershme, Halit (Sylë) Basha, e meqë të dy këta po e adhuronin Malën për qëndrimin e tij burrërorë, kishin vendosur të vinin të merrnin Malën, e që të tre së bashku të dilnin te "Lisi i Pudarit", nga ku mund të vëzhgonin lëvizjet e mëdha të forcave ushtarake e të xhandarmërisë serbe që po bëheshin ngado e veçmas në rrugën nga Suhareka në drejtim të Prizrenit dhe anasjelltas.

Në rrugëtimin e tyre për atje, në afërsi të tyrbes e të varrezave të fshatit, Mala do të ndalet në bisedë me një kalimtarë të rastit, njeri i fshatit Vraniq, dhe do të zgjatet paksa në bisedë me të. Këta, sapo të kenë mbërri kishin filluar vëzhgimin, ndërsa që ishin hetuar nga xhandar serb të cilët po ndodheshin ose po kalonin andej pari në rrugën e fshatit, dhe menjëherë ishin ftuar të shkonin te ata dhe të dorëzoheshin. Gjersa këta të rinj kishin arritur të hidhnin aty diku dylbitë dhe po hezitonin të dorëzoheshin, sakaq xhandarët serb kishin arritur aty dhe i kishin kapur që të dy, ndërsa që nën kërcënimin e armëve e kishin urdhëruar të ndalej e të dorëzohej edhe Shaban (Sylë) Rraqi, i cili ishte kalimtar i rastit në rrugën këmbësore që qonte nga lagjja e Rraqve në drejtim të qendrës së fshatit e i cili në atë moment kishte tentuar t'iu shmangej e të ikte. Që të tre këta do ti marrin dhe do ti zhdukin pa gjurmë, kurse Mala, i mllefosur, e kishte bërë publike dhe krejt të ditur se do të hakmerrej për që të tre.

Fillimisht do të vras një zyrtarë serb që po punonte në Komunën e Sopisë e të cilin do ta vras në afërsi të kishës serbe në fshatin Reqan,

kurse ishte i shoqëruar nga Shaqir (Fazli) Basha dhe i ndihmuar nga një burrë i cili ia kishte sjellë në pritë, por që këtë e kishte bërë për para dhe kjo është arsyeja pse nuk do t'ia përmendim emrin. Pas kësaj e meqë do të bëhet e ditur se Mala e kishte bërë këtë vrasje, do të jetë i përndjekur i pushtetit dhe i detyruar të bëj jetën e kaçakut të malit. Në ndërkohë pushteti serb vret pa gjurmë edhe Osman (Sylë) Bashën, kurse Mala shndërrohet në vrasës serik, ndërsa që për këtë s'po bisedonte me kënd. Kështu do të vras edhe katër serb radhazi, të gjithë serb autoritativ, ndërsa që të gjithë do ti vras në vendin e quajtur "Qeremidegjinjët" që ndodhet në rrugën nën fshatrat Popolan, Dvoran dhe Mushtishtë. Vrasjen e fundit, siç ishte shprehur më vonë, e kishte bërë të mos shkonte gjak humbur. Sado që askush nuk po e dinte për këto, pushteti për të gjitha po ngrite dyshimin në Malën, duke i ngritur akuzë për pesë vrasje dhe duke e burgosur e mbajt në burg nëntë muaj, ndërsa që nuk e kishin zhdukur e as nuk e kishin dënuar nga frika, por edhe nën presionin publik dhe nën presionin e njerëzve autoritativ të kohës (Ramë Bllaca, Bajraktari i Suharekës, Sherif Voci), të cilët ishin shprehur se Mala ka rreth të gjerë shokësh, miqsh dhe mbështetësish të tij, të cilët do të mund të hakmerreshin shumëfish.

Ata që e njohin mirë e përshkruajnë si njeri fjalë pak e që mbante fjalën, i prerë në qëndrime dhe tepër konkret. Atë që thoshte, e realizonte aty për aty. E karakterizonte vet- disiplina dhe respekti i duhur për secilin që siç kishte thënë meriton respekt, por edhe përbuzja për armikun, ndjenja e përkrahjes për të tjerët dhe ndjenja e bamirësisë ndaj të varfërve. I përmendet dalja në një shëtitje, çdo mbrëmje, në të gjitha rrugët dhe rrugicat në fshat, për të marrë, strehuar e për të ushqyer të uriturit e shumtë në vitet e krizave (qesatit) në shoqëri. Motoja e tij se: "Shqiptarin kudo që të jetë e ke vëlla dhe duhet dashur si vëllain nga nëna, kurse lidhjet tjera që mund të krijojmë përditë duhet të na shërbejnë për tu përkrahur e ndihmuar mes vete në hallet e përditshmërisë së jetës; Dhe qëndrimi kësaj motoje kishin bërë që, Mala, të jetë aq i dashur e i respektuar saqë i madh e i vogël, madje edhe burra e gra më të moshuara se ai, po e thërrisnin "Baba Malë".

Pleqësitë po i ndante drejtë, ndërsa gjithmonë këtyre pajtimeve po iu qëndronte vet mbrapa; Madje as garant (dorëzanë) s'po kërkonte. Thoshte se: "Punëve të mia iu rri dorëzanë vet". Në një rast dëmi për të tjerët, kishte dënuar djalin e tij, Baftiun, me gjobë të

trefishtë, dhe ndërsa që ky po paguante gjobën, po i thoshte Baftiut: “Kurdo që gabon sërish, unë prapë paguaj trefish”.

Stërgjyshi i Skenderit: Malë (Bafti) Basha (1880- 1953)

Në rrethanat e reja, tmerrësisht të rënda, të krijuara në kohën e sundimit të egër të pushtuesit serb, kur grupet kaçake të rezistencës ishin shuar, ndërsa kufiri me Shqipërinë ishte i mbyllur, të thuash plotësisht, gjyshit tim, Veselit, do t’i bie hise që për të bëmat e babait të tij (Malës) si dhe për ato që kishte bërë, e për ato që s’i kishte bërë, të jetë i rrahur e i torturuar skajshmërish, fillimisht me pretekst të kërkimit të armëve e më pas do të ndiqet për vepra të shumta të rënda, ndërsa që i tërë shtypi serb i kohës po merrej me të. Do të përpiqen, që në tri seanca gjyqësore radhazi, ta dënojnë me vdekje, duke harruar qëllimisht se Veseli kishte marrë pjesë në Luftën Nacional- Çlirimtare dhe se kishte komanduar një njësi partizanësh në kuadër të Brigadës VII të UNÇJ–së, në frontet e luftës në Baqkë, Banatë dhe Srem. Mirëpo, pasi që nuk gjejnë dëshmitarë e prova, e dënojnë me 32 vjet burg për disa vepra të rënda, të cilat kur ia bashkojnë në një dënim të vetëm ai do të jetë 20 vjet. Nga këto, katërmbëdhjetë vjet e gjysmë, do t’i mbajë në burgjet famëkëqija në Prizren dhe në Nish. Veseli

ishte dënuar për vrasje dhe keqtrajtim të serbëve autoritativ të kohës dhe kjo ishte kuptuar si veprim kundër elementit dhe pushtetit serb. Do ta ketë fatin që gjatë vuajtjes së dënimit të jetë në rrethin e shokëve dhe pranë Adem Demaçit, të cilin e kishte parë si pishtarë që do të na ndriçoj rrugën. Si rrjedhojë, Veseli, kishte ndritur mendjen së lexuari dhe pas lirimit të tij nga burgu, më 1970, ishte në gjendje të jepte këshilla dhe mësime të mira. Gjatë vuajtjes së dënimit ai kishte zgjedhur emrat Skënder dhe Shpresë, për fëmijën që do t'i lindte djalit të tij - Ibrahimit, varësisht nga gjinia.

Gjyshi i Skenderit: Vesel (Malë) Basha (1909-19.11.1980)

I ati im, Ibrahimi, do ta bëjë "luftën" krejt ndryshe. Tërësisht i shtypur e i persekutuar politikisht, madje i diskriminuar në të gjitha mënyrat, do të jetë i izoluar dhe i bojkotuar edhe nga rrethi e nga bashkëfshatarët e tij. Fare i ri në moshë do t'i bie barra e kryefamiljarit dhe atë në rrethana tepër të rënda; Dhe që ta ketë jetën edhe më të rëndë, përpiqen ta nëpërkëmbin. Për katërmbëdhjetë vjet e gjysmë do t'i duhet që, bashkë me nënën e tij - Hajrijen, të qëndroj para dyerve të burgjeve: në Prizren dhe në Nish, për t'i dërguar ushqim e veshmbathje Veselit, të cilin tri vjet e kishin mbajtur plotësisht të izoluar në qeli burgu dhe nën pranga zinxhirësh të rëndë, me hallka të farkëtuara, dhe të cilit ia kishin ndaluar vizitat për shtatë vjet me radhë. Ligji thoshte se edhe po të vdiste në burg, trupi i Veselit nuk do t'i jepej familjes, deri në përfundimin e afatit ligjor të vuajtjes së dënimit. Kjo ua bënte më të rënd vuajtjen dhe ua ndrydhte edhe më shumë shpresën dhe vullnetin. Me gjithë këto vuajtje e mundime,

Ibrahim Veseli, kurrë s'do t'i humb shpresat e as s'do të thyhej, përkundrazi do të jetë njeriu që më së miri është përkujdesur dhe e ka mbajtur babanë e tij në burg, si me ushqime ashtu edhe me veshmbathje, dhe se nuk do t'i mungoj as edhe një herë në vizitë.

Ngjashëm do ta ketë fatin edhe më vonë, por tashti, së bashku me gruan, Feriden, sikur dikur me nënën, do t'i ndjekin rrugët që çojnë në burgun e Prizrenit, për të vizituar dy djemtë: Skënderin dhe Enverin. Këtu Enveri do ta vuaj gjithë dënimin prej një viti, sa ishte dënuar si i mitur, për veprimtari nacional-çlirimtare e për bashkim kombëtar, ndërsa mua do të më çojnë në Smrekonicë, për të përmbyllur dënimin e parë prej pesëmbëdhjetë muajsh, kurse dënimin tjetër prej katër vitesh, do ta vuaj në Prizren, Pejë, Sarajevë e Foçë të Bosnjë-Hercegovinës. Këto ishin burgjet ku Ibrahimi duhej të vizitonte njerëzit e tij. Dhe aty e kemi gjithë herë krejt te pathyeshëm e të vullnetshëm, por me fat që asnjëherë s'e kishte provuar vet burgun edhe pse krahas përkrahjes që u jepte djemve të tij, kishte lexuar në vazhdimësi shtypin dhe literaturën ilegale të kohës dhe se kishte shkruar parulla e kishte shpërndarë material propagandistik tek të tjerët. Për më tepër, për këtë ishte ndaluar dy herë në stacionet policore, në Mushtishtë dhe në Suharekë, ku të dy herët do të rrahet e torturohet. Asgjë s'do të jetë e rëndë për njeriun plot krenari, tepër punëtor e me ndjenja të mëdha kombëtare e bamirësie.

Babai i Skenderit, Ibrahimi, në shoqëri me nipa e mbesa.

S’do të jetë i plotë shpjegimi për burimet prej nga u frymëzova e u brumosa po të mos them se ndikim të madh kishte edhe qëndrimi burrërorë i nënës Feride, burrneshës së kohëve të rënda që na kishin pllakosur, e cila në çdo sfidë po na jepte kurajë të qëndronim të paluhatshëm. Feridja është e bija e Zeqir (Abaz) Aliaj, nga një familje Maqitevase, lindur e rritur në Dvoran. Zeqiri ishte shembull se si duhej të bëhej jeta. Edhe pse i të vetmes familje shqiptare në një fshat me mbi njëqind familje serbe, çdo herë ishte i papajtueshëm e në armiqësi me ta dhe me pushtetin serb. Trim mbi trima, bombahedhësi më i mirë i Brigadës V dhe i gjithë UNÇJ–së, për çka kishte marrë mirënjohje, dekorata e medalje të shumta; Hero i gjallë i kohës, në bazë të te bëmave të cilit thuhet se ishte inskenuar e gjiruar filmi për bombahedhësin e mirënjohur, Boshko Buha; Ndërsa që s’kishte as përkujdesjen më të vogël shoqërore, përkundrazi, ishte nën vëzhgim të vazhdueshëm, i urryer dhe halë në sy të pushtetit serbo- sllav, kurse edhe në moshë krejt të shtyre po akuzohej në shtypin e kohës dhe në gjithë mediat private e shtetërore përfshirë edhe mediat elektronike se po frymëzonte nacionalizmin shqiptarë këtu, dhe se po nxiste popullin në protesta e demonstrata kundër pushtetit dhe dhunës serbe ndaj çdo gjëje që ishte shqiptare. Meqenëse një kohë kishte luftuar për lirinë e Bosnjës dhe Hercegovinës, i kishte rënë që pos kundër gjermanëve e italianëve të luftoi edhe kundër bandave çetnike të Drazha Mihajloviqit, dhe kjo do të jetë arsyeja e presionit të më pasmë mbi të, kurse ky gjithherë haptazi po ju thoshte se kishte vrarë shumë çetnik por ja që i kishin mbetur këta pa vrarë.

Skenderi me nënë Feriden dhe me djalin e madh, Meritonin.

Hapi drejt ilegales

Që në fëmijëri, do t'i lexojë disa numra të revistës "Shqipëria e Re", revistë e ilustruar që botohej në Tiranë, e të cilën e sillte Beqir (Vesel) Llugaxhiu nga Gjermania, të cilën e merrja nga Taip (Beqir) Llugaxhiu. Këta numra të revistës, ia jepja për lexim Shpresë (Rrahman) Baraliut dhe Mustafë (Mulë) Bashës. Ndërkohë, nga Shpresa do ta marr romanin "Gjarpinjtë e gjakut" të Adem Demaçit, të cilin do ta përshkruaj në tërësi dhe do t'ua jep me kthim Mustafës dhe Taipit. Përmbajtjen e përshkruar të romanit "Gjarpinjtë e gjakut", ia jap edhe Rifat (Rrahman) Rrahmanajt dhe Fadil Vatës, nga fshati Sallagrazhdë. Nga këta do të marr literaturë të shumtë, kryesisht vepra të Enver Hoxhës si dhe "Lahuta e Malcisë". Në Odë do të dëgjojë tërë bisedat që zhvillonte gjyshi dhe babai im, me: Destan Bajraktarin, Haxhi Zybën e Xhavit Bashën, të cilët ishin mysafirë të shpeshtë, ndërsa do të kem në dorë gazetën "Liria", "Bashkimi",

“Lajmëtari i Lirisë” e literaturë të shumtë që e sillnin mysafirët. Veçmas do të ndikoi amaneti i gjyshit tim, Veselit, i cili duket se kishte nuhatë rrjedhën e gjërave dhe kah po shkonim, që të mos iu përtoja në jetë: ushtrisë, burgut dhe luftës, të cilin amanet do të ma lë në ndarje me të, në spitalin e Prishtinës, kur po shkoja në shërbim ushtarak. Të gjitha këto do të ndikojnë në formësimin tim si njeri, por dhe në pjekurin dhe burrërimin tim të hershëm, ndërsa që më kishin lënë krejtësisht pa rini dhe jetë rinore. Gjatë gjithë këtyre viteve, deri në përfundimin me sukses të luftës së UÇK-së, do të jem i përndjekur ose i përvuajtur i regjimit.

Skenderi: Fotografi nga rinia e hershme e fillimet e veprimit ilegal.

Peripecitë e para

Në shërbimin ushtarak, në armatën jugosllave, shkova menjëherë pasi të kem mbaruar shkollën e mesme, në tetor të vitit 1980. Atje do të persekutohem dhe do të kem shumë peripeci ngase në Kosovë dhe në vende tjera të ish Jogusllavisë më ishin burgosur shokët e shoqet e shkollës së mesme: Fadil Vata, Halil Krasniqi, Ibrahim Shala, Shemsie Elshani, Murat Bytyçi e ndonjë tjetër, që të gjithë këta

nxënës të profesorëve të nderuar e shumë të respektuar Shefki Muqa e Begjet Berisha, për të cilët pyetesha në vazhdimësi nga shërbimi informativ ushtarak jugosllav KOS-i. Më ishin problematike edhe letrat e shumta që merrja në vazhdimësi, gati çdo ditë, nga baca, Malë (Bafti) Basha, e veçmas ato që më dërgonte daja, Besim (Adem) Ndreca, që të dy këta në vuajtje dënimi në burgun famëkeq të Lepogllavës, në Kroaci; Aq më tepër që Besimi kishte therë me bajonetë një oficer të tij, serb, derisa ishte në shërbim ushtarak në armatën Jugosllave. Më pyesnin për: Gjyshin tim, Veselin, Destan Bajraktarin, Haxhi Zybën, Xhafer Bashën e për shumë veprimtarë të tjerë të çështjes kombëtare shqiptare, të dënuar e të përndjekur politik, ndërsa që më pyesnin për shokët e mi ushtarë, shqiptarë, me të cilët po shërbeja. E gjithë kjo pasi të kenë ndodhur ngjarjet e mars - prillit ’81 në Kosovë e të cilat na kishin zënë atje, në shërbim ushtarak. Do ta kem të vështirë gjatë gjithë kohës, ndërsa do të jem fatlum që nuk më kishin ngritur akuzë, krejt të pakuptimtë, për ndonjë sjellje tonë atje. Fadil Vatën s’do të kem fat ta shoh kurrë më, ngase ishim në burg, ose ai ishte në ekzil, në Zvicër.

Skenderi: Fotografi e vitit ’81, nga shërbimi ushtarak në ish Jugosllavi.



Veprimtari me emrin e të cilit identifikohet koha e tij:
Fadil Vata (1962- 1990).

Fillimet e veprimit në organizime ilegale

Në tetor të vitit 1981 kthehem nga armata dhe i filloj studimet në Fakultetin e Shkencave Natyrore-dega e Biologjisë, në Universitetin e Prishtinës. Këtu njihem me Shemsi Veselin e përmes tij do të lidhem me organizatën ilegale "Fronti Nacional Çlirimtarë"- "FNÇ". Do të marr pjesë në demonstratat e vitit 1982-83 në Prishtinë, dhe do të kujdesem për mbarëvajtjen e demonstratave në detyra të caktuara, ndërsa nga Prishtina do të sjellë trakte, të cilat bënin thirrje që të organizoheshin demonstrata edhe në Suharekë, në përvjetorin e demonstratave të 81–shit. Këto trakte i shpërndaja në vende publike, ndërsa isha i ndihmuar nga: Skender (Tahir) Bytyqi, Xhavit (Hamit) Sadikaj, Sylejman Gega, Vesel (Jupë) Qerkinaj, Gani (Elez) Buzhala, Sali (Jakup) Basha, Mustafë (Mulë) Basha, Nijazi (Azem) Basha, Gjelal (Jetulla) Basha, nga vëllai im Enver (Ibrahim) Basha, Isuf (Mulë) Basha, Elmi (Qerim) Loshi, Sadri (Azem) Zyba, Ruzhdi (Kadri) Kolgeci, Bislim (Rrustem) Muqa, Azem (Miftar) Kolgeci, Ruzhdi (Bajram) Basha, Avdyl (Qazim) Kolgeci, Hagji (Hysen)

Kolgeci, Regjë (Hajrulla) Kolgeci, Agim (Musli) Kolgeci, Zenel (Hajrush) Kolgeci e nga të tjerë, shumica nxënës të shkollës së mesme. Ngjashëm do të veproj edhe në vitin 1983. Tani këta djem, ishin bërë anëtarë të FNÇ-së, ndërsa po shkruanim parulla dhe po shpërndanim shtypin ilegal.

Bashkëpunimin që kisha nisur me Malë Morinën e Lybeniqit të Pejës, UDB-ja do ta ndërpres dhunshëm, duke e kidnapuar dhe varë Malën në një arrë të një serbi në Lybeniq me pretekstin se Mala kishte provuar të kalonte në Perëndim familjarë të Vëllezërve Gërvalla.

Ne vjeshte te vitit 1983 së bashku me Ibush Vishin, Enver Topallin, Shemsi Veselin dhe Nuhi Berishën do të arrijmë të bashkojmë: "Frontin Nacional Çlirimtar" (FNÇ), të cilin po e kryesonte Sejdi Veseli, "Partinë e Luftës së Kosovës" (PLK), kryetar i së cilës ishte Kadri Osmani dhe "Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi" (LRSHJ), të cilën në Kosovë e përfaqësonte Rexhep Mala; Duke i shkrirë në LRSHJ.

Ishte periudhë e ndritshme e qëndrimit dhe veprimit politik të masave shqiptare kudo në viset shqiptare nën Ish Jugosllavi e këtu në Kosovë në veqanti. Veçmas ishte politizuar rinia përparimtare studentore, por edhe nxënës të shkollave të mesme, ndërsa që spo mungonte përkrahja e hapur e klsës punëtore dhe e fshatarësisë, andaj pos që ishte e nevojshme ishte edhe kënaqësi të veprohej me njeriun e këtushëm. Do të thosha që ishte periudhë e një rilindje të fuqishme kombëtare kur secili nesh po bënte përpjekje për ditë më të mira për ne, ndërsa që s'do shpjegim se kjo ishte arritë falë punës dhe angazhimit të veprimtarëve të shumtë që po bënin sakrificën duke vepruar pandalshëm me devotshmëri që prej kohësh. Ndikim thelbësorë kishin ngjarjet e vitit 1981- '82 dhe masat represive që kishte marrë e po merrte edhe më tej pushteti kundër pjesëmarrësve në këto ngjarje e në zhvillimet politike pas tyre. Për fat të keq si gjithëherë edhe tani pushteti represiv serb po gjente bashkëpunëtor, madje të tillë po rekrutonte përditë e më shumë, nën trysninë e të cilëve do të jemi gjithnjë e më të rrezikuar.

Skenderi: Fotografi e vitit ’83, nga koha e ilegales, para se të burgosesha herën e parë.

Enveri: Fotografi e vitit ’83, nga koha e ilegales, para se të burgosej.



Veprimtari i çështjes kombëtare:
Destan Bajraktari (17.04.1930-28.02.2005).

Veprimtari i çështjes kombëtare:
Haxhi Zyba (03.02.1944- 21.10.2007).

Burgosja e Parë

Në shkurt të vitit 1984 do të shembet shumëçka. Do të burgoset Kadri Osmani e Sejdi Veseli me të gjithë vëllezërit e tij. Në një luftë heroike me forcat serbe do të vriten Rexhep Mala e Nuhi Berisha, dy nga bijtë më të mirë që kishte lindur nëna shqiptare e që kishte rritur dheu arbërorë. Do të burgoset numër i madh veprimtarësh anekënd Kosovës. Të gjithë do të kalojmë nëpër torturat nga më mizoret. Disa nga ne do të thyhen e gjymtohen këmbë e krahësh, do të dënohemi me shumë vite burgim të rëndë e do të kalojmë rininë nëpër të gjitha burgjet e ish-Jugosllavisë. Do të persekutohemi, të rrihemi e torturohemi, por asnjë s'do të thyhet e gjunjëzohet, e as do të lejoj ta humb kohën kot. Përkundrazi, do të ndrisim mendjet së lexuari, do të piqemi e aftësohemi për sfida edhe më të mëdha. Unë dhe Skënder Bytyçi, do të dënohemi, me proces të ndarë, si anëtarë të FNÇ–së. Do të mbajmë qëndrim të fortë, burrëror, edhe gjatë hetimeve edhe gjatë vuajtjes së dënimit; do të arrijmë të mos denoncojnë e të mos dekonspirojmë asnjë prej shokëve tanë. E kisha të rëndë që hetimet po mi kryenin hetues shqiptarë që të thuash për inatin tim të gjithë kishin ardhur nga mësuesia dhe arsimi, kurse le që po tregoheshin të dhunshëm e të pashpirte, por ishin edhe krejt të pa cipë. Gjykimi do të na bëhet në Prizren dhe do të mbahemi aty për disa kohë, ndërsa më vonë, mua, do të më qojnë në Smrekonicë të Vushtrrisë. Populli flet me admirim për qëndrimin tonë prej revolucionarësh të vërtetë në gjykatë dhe për mbrojtjen me këmbëngulësi të qëndrimeve politike për Republikën e Kosovës, për lirinë dhe barazinë e shqiptarëve në Jugosllavi.

Gjatë vuajtjes së dënimit do ta kem fatin të qëndrojë me shumë nga shokët që i njihja dhe më shumë të tjerë që s'i njihja më parë. Do të bashkëjetojë dhe të mishërohem me ta. Do të brumosem e çelikosem edhe më shumë, do të vuaj bashkë me shumë burra të dheut. Me shumë të tjerë do të komunikoj fshehurazi për një kohë të gjatë. Do të shqyrtojmë ide çlirimtare e forma veprimi nga më të ndryshmet. Në ndarje do t'i premtojmë e do ti betohemi njëri-tjetrit se nuk do të pushojmë së vepruari për liri, ndërsa që shumica dërmuese prej nesh s'kishim pushuar së vepruari deri në përfundimin e Luftës së UÇK-së.

Lirimi nga burgu, angazhimi i serishëm në ilegale

Në maj të vitit 1985 do të lirohem, pasi ta kem vuajtur në tërësi dënimin. Nëntë ditë pasi të lirohem, sërish do të aktivizohem në Lëvizjen Ilegale, tani në "Organizata e Marksist Leninistëve të Kosovës (OMLK) nga Haki Gashi dhe Gafurr Elshani. Shumë shpejt do të krijojmë "Komitetin e Rrethit të Suharekës të OMLK–së". Gafurri do të jetë Sekretar për Çështje Politike, Hakiu, Sekretar Organizativ, kurse unë, Sekretar për Agjitacion dhe Propagandë si dhe Arkëtar i Komitetit të Rrethit. Do të shtrihemi shpejt dhe guximshëm në terren, menjëherë pasi të kemi dhënë betimin. Do të grumbullojmë mjete financiare dhe do të përpiqemi të armatosemi, së paku për t'u vetëmbrojtur, kur rrezikohemi dhe deri sa jemi në veprim. Do të krijojmë e shpërndajmë organin e organizatës sonë "Pararoja" e materiale të tjera propaganduese; do të fuqizohemi me anëtarë të rinj dhe do të gjejmë shokët kudo që janë; do të punojmë me njerëz të rinj. Unë, do të veproj me pseudonimin "Izeti", do të kontaktoj të gjithë shokët e më hershëm të veprimit dhe të gjithë do të më bashkohen. Gafurri dhe Hakiu do të punojnë në çështjet politike dhe organizim. Do të përpiqemi të kontaktojmë grupet dhe organizatat që vepronin në terren; do të arrijmë të bashkohemi me grupin në të cilin vepronte Sadik Halitjaha. Bëhej punë e madhe, e palodhshme dhe me shumë përkushtim, këtu e kudo, e si rezultat po rriteshin radhët tona e po bëheshim shumë e më shumë.

Martesa "nëpër flakë pushkësh"

Isha i fejuar, që para se të burgosesha herën e parë, me Raba (Azem) Loshin, kurse do të martohem vetëm pak javë para se të burgosem sërish. Prindërit dhe familjarët më kishin organizuar dasmë me shumë të ftuar, me zurla, tupanë e më këngëtarë, ndërsa që mua s'po më kishin kuptim gjërat. Në ditën e dasmës e të martesës sime, unë do të jem në takim me shokët e ilegales, Gafurrin e Hakiun, në livadhet mbi fshatin Reqan dhe normalisht që shokët si kisha ftuar në dasmë, kurse e kishin mësuar këtë kur po i lusja të mos vonoheshim në takim meqë unë po martohesha prandaj s'mund të vonohesha shumë ngase nusja merrej aty, në fshatin Vraniq, e krushqit do të ktheheshin shumë shpejtë.

Burgosja e dytë, lirimi nga burgu

Në fund të nëntorit të vitit 1985 serish shembet diçka. Prapë burgosje të shumta anekënd Kosovës. Mua, do të më përsëritet historia, vetëm pas më pak se gjashtë muaj qëndrimi jashtë grilave, siç do të thoshin atëherë, në burgun e madh të shqiptarëve. Tani isha edhe më i fortë se më parë. Bashkë me Hakiun do të kursejmë të gjithë shokët tanë. Arrijmë ta mbrojmë, deri në lirim nga burgu ,edhe Sadik Halitjahën, i cili do të lirohet në fund të procesit gjyqësor. Gafurri ishte në ilegalitet e më pas do të arratisej jashtë vendit, në Zvicër. Sërish gjithë peripecitë që sillnin burgjet; serish bashkë-vuajtja me burrat e dheut, krenari e kombit atëherë dhe sot, për jetë e mot. Shumë prej tyre tani janë bërë të pavdekshëm-yje që shndrisin e shumë prej tyre edhe më tej përpiqen të drejtojnë rrjedhat deri në çlirim definitiv dhe bashkim kombëtar. Të shumtë janë edhe ata që sot përbëjnë kreun e shtetit e të politikës se vendit. Edhe kësaj radhe do të burgosem e do të gjykohem në Prizren. Do të dënohem me katër vjet burg, kurse Haki Gashit do t'i shqiptohet dënim me shtatë vite burg të rëndë. Dënimin do ta vuaj në burgun e Prizrenit, atë të Pejës, Sarajevës, dhe në Foçë të Bosnjë-Hercegovinës, ku pos shokëve të shumtë shqiptarë do ta kem fatin të vuaj bashkë dhe të njihem për së afërmi edhe me ish-disidentin jugosllav, Marko Peroviq, dhe me të burgosurin politik boshnjak, Alia Izetbegoviq, i cili më pas do të jetë kryetar i Bosnjë e Hercegovinës dhe themelues e kryekomandant i ushtrisë boshnjake, në luftën për çlirimin e Bosnjë-Hercegovinës. Nga këta do të mësoj gjëra të shumta me rëndësi për veprimin dhe për luftën për çlirim kombëtar. Edhe këtë dënim do ta vuaj të tërin. Lirohem në nëntor të vitit 1989, në kohën e vlimeve e ndryshimeve politike në Kosovë e Jugosllavi.

Sa herë po ndahesha nga shokët e po i leja ata në burg, po më copëtohej zemra dhe po vdisja nga pak, dhe sa më shumë që po largohesha nga objektet e burgjeve më bëhej se aq më thellë po fundoseshin e po bëheshin greminë këto burgje dhe s'po më hiqeshin nga mendja ata njerëz të mbushur lavdi e unë po sforcoja betimin se do të përpiqesha për lirinë.

Anëtarësimi në LDK, angazhimet

Ishte në proces ndryshimi në planin e organizimit politik, kur Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë (LKJ), po binte nga skena edhe në Kosovë dhe kur po krijohej Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Do të më vizitojë numër, vërtetë, tepër i madh njerëzish me rastin e lirimit nga burgu, ndërsa gati secili prej tyre do të këshillohet me mua si të veprohej në këto rrethana. Do t'i këshillojë që të shkojnë të gjithë në LDK. Kështu do të ndihmonin largimin nga skena të Lidhjes së Komunisteve të Jugosllavisë (LKJ-së). Ndërsa kur më pyesnin se, a do të jem edhe unë në LDK? Ua ktheja me shaka se: Unë, më parë, duhet t'i pyesja shokët.

Pos në masivizim, LDK-në do ta ndihmoj edhe për të krijuar strukturat e saj, në Suharekë e në Nëndegë-në Vraniq, kurse do të anëtarësohem në këtë parti pas një këshillimi me Adem Demaçin, në një takim në odën e Maliq (Sylejman) Zyba në Bukosh, nga i cili, pos që njerëzit porositeshin të anëtarësoheshin në LDK, t'i japin asaj edhe shpirt e ta bënin të fortë dhe efektive. Me të dëgjuar për këtë, aktivistë të LDK-së, në fshatin Vraniq, më angazhojnë në Kryesi të Nëndegës, e me pas do të jem Kryetar i LDK-së, deri në zgjedhjet e fundit të kësaj partie, ato të dhjetorit të vitit 1997, të cilat do t'i organizojë por vet nuk do të pranojë të zgjedhë dhe as të jem i zgjedhur.

Duke qenë kryetar i nëndegës, në të vërtetë isha kryetar fshati dhe kështu do jap kontribut të veçantë. Njerëzit më mbajnë mend si kryetar që e kisha ngrit edhe më lartë rendin, rregullin dhe disiplinën në fshat e si udhëheqësin e tyre që po respektonte dhe po ftonte me sukses të tjerët të respektojnë gjithë rregullat dhe normat e krijuara shumë vite, dekada e shekuj më parë nga pararendësit e mi këtu: Në mbrojtjen dhe ruajtjen e pyllit e të fushës si dhe në shfrytëzimin e drejtë e racional të ujit për pije dha atij të ujitjes, por edhe në respektimin e një varg normash të tjera që tashmë shin ligje të pashkruara për njeriun e fshatit Vraniq. Do të më mbajnë mend edhe për kohë të gjatë, për "Qukën" që ua kam ringjallë së mbjelluni me drunj pishe, dhe për "Parkun e fshatit" që me këtë rast ua kam dhuruar e lënë trashëgim gjeneratave.

Veçanërisht do t'i përkrah njerëzit në halle e vështirësi, por edhe problemet që kanë do t'ua zgjidhë me urgjencë e me shumë urti. Bënim punë ekipore dhe krejt të pa lodhshme, ndërsa që përkushtimi në angazhim do të jetë i tillë që ngatërresën më të madhe mes njerëzve në fshat do ta zgjidhim brenda tridhjetë e katër orëve, kurse gjatë

gjithë kësaj kohe s'kishim pushuar e ngrënë bukë. Për të realizuar të gjitha këto, me sukses, do të bashkëpunojë ngushtë me kryesinë e fshatit ku krahë kisha: Selim (Brahim) Kolgecin, Xhavit (Jetulla) Bashën, Shefki (Hamëz) Kolgecin, Sylë (Jakup) Bashën, Agim (Sherif) Rraqin, Shefket (Kadri) Kolgecin, Tahir (Vesel) Kolgecin, Musli (Hasan) Muqën, Isuf (Mulë) Bashën, Bajram (Musli) Kolgecin, Xhemajl (Gjeladin) Kolgecin dhe Bislim Rr. Muqën; me imamin e fshatit Halim (Hamit) Shehu dhe Këshillin e xhamisë; me rojën e pyllit dhe të fushës Muharrem (Qazim) Kolgecin, si dhe me kurbetçinjtë e fshatit, me të cilët kisha krijuar rregull në mbajtjen e takimeve vjetore, me ta.

Sa herë që strukturat e LDK-së në fshat kishin organizuar zgjedhje të partisë, por edhe kur u mbajt referendumi për pavarësi të Kosovës, më 26 shtator 1991, mua, do të më liheshin çështjet e sigurisë, ndërsa këtë do ta realizojmë me njerëz nën armë, me sistem komplet radio-lidhjesh, dhe do të bllokojmë rrugët që çonin te vendvotimi me automjete, traktorë etj.

Ne sektorin e mbrojtjes që kishte krijuar LDK–ja, do të punoj me Ibrahim Shalën, Sylë J. Bashën e Ukë Bytyçin. Këtu do të krijohen regjistra të shumtë me emra të te rinjve që përzgjidheshin për polic dhe kuadro ushtarake për të ardhmen e vendit, të cilët mendohej të dërgoheshin në akademi përkatëse në Shqipëri për aftësim.

Në sektorin e financimit të mekanizmave që po krijoheshin, përkatësisht në grumbullimin e mjeteve në kuadër të Këshillit për Financim, do të punoj vullnetshëm e pa kompensim, me Bislim Muqën dhe Haxhi Kolgecin.

Isha pjesëmarrës dhe një nga organizatorët që drejtojnë dhe kujdesen për mbarëvajtjen e të gjitha demonstratave të përgjakshme të viteve 1990–91, në Suharekë e në rrethinë, ku kërkohej demokratizimi i shoqërisë, por edhe të atyre të viti 1997- '98 ku i brohoritej UÇK- së e ku i jepej haptazi e në sy të pushtetit serb përkrahja e parë morale luftëtarëve të saj trima.

Angazhimi i serishëm në ilegale

Në vitin 1991, me porosi të Xhavit Hazirit nga Obiliqi, te unë, do të vijnë: Hysen Gega, Halil Krasniqi dhe Ilaz Kadolli, të cilët më angazhojnë në radhët e "Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës"

(LPRK), e cila në gusht të vitit 1993 do të shndërrohet në "Lëvizja Popullore e Kosovës" (LPK). Këtu do të jem deri në përfundimin e luftës së UÇK-së.

Në vjeshtë të vitit 1992, në shtëpinë time, vije Raif Qela nga Mitrovica, me idenë që të shkëputeshim njëanshëm nga LPRK-ja, me arsyetimin se ajo ishte bërë pasive dhe nuk po zhvillohej aktivitet i duhur revolucionar dhe se me veprimet e saj, LPRK-ja, kishte filluar t'i ngjante LDK-së. Ideja e Raif Qelës ishte krijimi i "Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës" (LKÇK). Për ta biseduar në detaje këtë çështje, bashkë me Avdi Kadollin, kishim shkuar në shtëpinë e Fadil Vatës në Sallagrazhdë. Kishim biseduar shterueshëm deri në mëngjes dhe nuk kishim mundur të pajtoheshim, ngase, unë, isha për idenë e angazhimit për ta bërë me efikase LPRK-në, dhe jo që ajo të ndahej. Perceptimi im për realizimin e bashkimit kombëtarë ishte se ai realizohet duke bashkuar fillimisht individët.

Në LPRK- LPK, kontribut të çmueshëm, në aktivitet me Xhavit Hazirin, dhe Remzi Ademajn, do të jap: Në përpunimin e tezave për krijimin e një fronti të përbashkët politik në Kosovë dhe për përfaqësimin politik të gueriles që ishte krijuar. Në lidhje me këtë Xhavitit i pata punuar një material njëzetetetë faqesh në dorëshkrim. Përcjellim me kujdes dhe lexojmë gjithë shkrimet e shtypit ilegal të kohës: "Zëri i Kosovës", organ i LPK- së, "Çlirimi", organ i LKÇK-së dhe "Kushtrimi i Lirisë", organ i "Partia Revolucionare Shqiptare" (PRSH); Ndërsa në nismë të përpjekjeve për unifikim meqë rast, unë, do të duhej të kontaktoja me LKÇK- në, kurse Remzi Ademaj me PRSH- në do te krijohen rrethana ndjekje dhe persekutimi për aktivistët. Ndërkohë burgosen numër i konsideruar shokësh dhe aktiviteti pëson rënie.

Angazhimet tjera

Në lëvizjen kombëtare për pajtimin e gjaqeve dhe ngatërresave do të angazhohem nga Opojari nga fshati Kuk, Bedri Halimi dhe nga Qazim Kabashi në vitin 1990. Këtu, veçmas, jam tepër aktiv me grupin e njerëzve të mijë dhe do të bëjmë punë të efektshme, deri në pranverën e vitit 1992, kur e përmbyllëm këtë aktivitet me një tubim madhështorë të pajtimit në "Zabeli i Pajtimit", në Savrovë, me ç'rast do të arrijmë të pajtojmë disa dhjetëra hasmëri.

Isha njeri nga nismëtarët e themelimit të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ), Dega në Suharekë, ku do të jem anëtar Kryesie dhe do ta themelojë Nëndegën e KMDLNJ-së në Vraniq, të cilën do ta kryesojë. Në Degë do të bashkëpunojë ngushtë me Besim Baraliun, kurse në nëndegë me Bislim Muqën, Azem Kolgecin, Hagji Kolgecin, Avdyl Kolgecin, Enver Bashën e Faton Kolgecin.

Bashkë me Besim Baraliun, Haxhi Zybën e Brahim (Ramë) Bllacën do të iniciojmë dhe do ta formojmë Shoqatën e të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politik. Kuvendin themelues të kësaj shoqate do ta mbajmë në objektin e shkollës fillore në Grikoc, kurse kryetar shoqate do të zgjidhet Nexhmije Demiri- Morina. Nëndegën e kësaj shoqate do ta krijojë edhe në fshatin Vraniq dhe do të jem kryetar i saj.

Do të marr pjesë në kuvendin themelues dhe do të jem anëtar i Kuvendit të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe të Kosovës, Dega në Suharekë, ku kryetar do të zgjidhet Kosovë Bajraktari. Kuvendi themelues do të mbahet në shkollën fillore "Shkëndija" në Suharekë.

Themeloj Nëndegën e shoqatës humanitare bamirëse (SHHB) "Nëna Terezë" në Vraniq, sipas kërkesës së Haxhi Bajraktarit dhe profesor Vesel Hysës. Këtu do të punojë me Jakup A. Llugagjiun dhe me Sali A. Llugagjiun. Veçmas do të zhvillojë aktivitete bamirësie mes njerëzve të fshatit dhe asnjëherë s'do të lejojë që njerëzit të ndjejnë barrën e skamjes. Kishim krijuar atmosferë dhe gjendje në të cilën njerëzit vet po e ndihmonin njëri tjetrin, ndërsa që ne po ndërmjetësonim me informata mbi gjendjen materiale të individit dhe me porosinë kurë, kujt dhe me çka ti ndihmohej. Mund të thuhet se përfundimisht i heqë arnat nga veshjet e varfanjakëve këtu.

Me gjithë varfërinë e thellë, gati të skajshme, që kishim në ato rrethana dhune e terrori të pushtetit të dhunshëm serb kur gati të gjithë punëtorët ishin dëbuar nga vendet e tyre të punës, falë vullnetit të popullit kishim arritur që, në një rast, popullit Boshnjak dhe luftëtarëve të tij ti dërgonim sasi të konsiderueshme gjërash ushqimore dhe veshmbathje.

Në vitin 1996, së bashku me Bislim Muqën, Haxhi Kolgecin, Nexhmije R. Loshin, Shkurte Sh. Kolgecin, Nakije B. Llugagjiun, Naile M. Llugagjiun, Ervehe F. Muqën, Alida H. Muqën, Violetë N.

Kolgecin dhe Naile Rr. Muqën, do të krijojmë grupin letrar "Lasgush Poradeci", i cili do të organizoj aktivitet të gjallë letrar dhe krijues, duke mbajtur tri orë letrare, me të cilat do të ndikohet ndjeshëm në ngjalljen shpirtërore të njerëzve në fshat, ngase pjesëmarrja e tyre ishte tepër e madhe dhe mund të krahasohej me evenimente të mëdha kulturore që për kohën ishin të pakta.

Tërë këtë aktivitet dhe gjithë gatishmërinë për sakrificën që do ta bëjmë më pas, e kishim mbështetur fort në sigurinë që kishim në fitore. Ishim në mision të shenjtë, bëhej me lirin e popullit e të atëdheut, dhe këtu s'duhej mëdyshje e as s'duhej pritur më. Gjatë veprimit tonë, në rrugëtimin e gjatë, do të japim shokë të shumtë; Shumë prej tyre u martirizuan e shumë të tjerë ranë me pushkë në dorë. Në fund vije liria e paguar shtrenjtë; Liria për të cilën dham gjakun dhe jetët e më të mirëve tanë.

Përkujdesja për veprimtarët

Për arsye që mund ti supozoj (ndoshta ngaqë isha nxënësi më i mirë në shkollë), si nxënës i klasës së tretë ose të katërt, më ishte dhënë të bartë mbishkrimin e varrit me yllin pesë rrembash dhe me datën e lindjes dhe të vdekjes në të, në ditën e varrimit të Miftar (Hamit) Kolgeci, ndërsa që po i prija kortezhit funeral. Isha anëtarë i këshillit për organizimin e varrimit të veprimtarit, Fadil Vata, me emrin e të cilit identifikohet koha kur ka vepruar ky vigan. Shumë kohë më pas, do të jem në komisionin për varrim dhe do të lexoj mbi varrin e veprimtarit Ruzhdi (Kadri) Kolgeci (ku kishte një incizim me kamerë) dhe më pas mbi varrin e Rrustem (Bislim) Muqa, kurse veprimtarit Elmi (Qerim) Loshi, bashkë me shokët i kishim organizuar e udhëhequr varrimin më të numërt të te pranishmëve dhe më madhështorë deri atëherë kudo në këto anë e më gjerë. Të dy këta të rinj, edhe Ruzhdiu edhe Elmiu, veprimtarë të devotshëm të veprimit patriotik e atdhetarë kishin provuar tërë dhunën serbe dhe padrejtësitë e mëdha në çdo plan që po na bëheshin, ndërsa që edhe vet ishin të përndjekur e të persekutuar meqë s'po ju lejohej mundësia e shkollimit më tej e as e punësimit kudo këtu, kurse Elmiu edhe i dënuar politik e i larguar nga procesi mësimorë; Nën trysninë e rrethanave të rënda të kohës, e për të mbajtur familjen, do të marrin rrugën e kurbetit, por që kurrë s'patën pushuar veprimin e tyre për të

mirën tonë të përgjithshme, ndërsa fati i keq ua deshi që të dy të humbin jetën aksidentalisht mu në kohën kur më së shumti po na duheshin.

Ruzhdi (Kadri) Kolgeci (10.07.1962- 08.06.1993).

Elmi (Qerim) Loshi (19.06.1964- 01.04.1995).

Thirrja publike për unifikim, edhe unë bëhem trim (Rrëfim)

Kishim demonstruar gjatë vullnetin tonë politik dhe ai s'binte ndesh me parime mbi të drejta nacionale dhe as s'dëmtonte kënd. Gjithashtu edhe kishim protestuar pareshtur për të treguar se s'po pajtoheshim me atë që në vazhdimësi po ndërmerrte e synonte të realizonte pushteti serbo- sllav duke zbatuar përmbledhur të gjitha planet, programet dhe elaboratet serbe nga e kaluara që nga ai i Ilia Garashaninit e deri te këto të tanishmet të freskuara e të plotësuara nga ide e mësime shoviniste të Dobrica Qosiqit e të Kishës Serbe, por ja që s'kishim vendosur të rezistonim së kundërvuri gjërave që po na ndodhnin në mënyrë që ato të mos na ndodhnin më, ndërsa që në rrethana të tilla ishim të thirrur e të obliguar nga zë i arsyes t'ua kthenim goditjen.

Ishte gjendje skajshmërish e rëndë, veçmas tani kur po ndiqeshim në formë fushate dhe kur pushteti serb na kishte inkriminuar absolutisht të gjithëve. Pushteti tani më spo zgjidhte e veçonte kënd as spo e kursente kënd. Ishim dëbuar përfundimisht nga shkollat tona përfshirë edhe nga të gjitha objektet universitare, nga vendet e punës kudo, nga të gjitha institucionet publike, ndërsa që këtë e kishte bërë duke na helmuar masivisht e duke na vrarë një nga një; E meqë kjo ishte projekt i tyre kishin abstrahuar institucionin e përgjegjësisë, prandaj për çfarëdo që bënin mbi ne kush s'mbante kurrfarë përgjegjësie madje as përgjegjësi morale, bile konsideroheshin serb të mëdhenj dhe gradoheshin e ngriteshin në vende të tyre të punës ose avancoheshin më lart në politikë. Sa për t'ua mbajte ison e për të vendosë gjërat edhe në emër tonë po gjenin ndonjë të sojit tonë ose edhe rom që fliste shqipen, siç ishte rasti me Sejdo Bajramoviqin, një plak i matufosur, krejt i pa shkollë por ja që serbët do ta bëjnë madje Kryetarë të Jugosllavisë për të na paraqitur para botës si të barabartë me të tjerët por edhe që të fliste në emër tonë. Serbi na urrente me tërë forcën dhe kjo ishte e qartë, por jo për të gjithë ne për fat të keq.

Ata që ishin në struktura udhëheqëse politike, në pushtetin që tërësisht ishte shkëputur nga populli, po i bënin argatin serbit dhe pushtetit serb që ishte bërë krejt gjakatar, ndërsa që po "hanin" njëri tjetrin në luftë krejt të pist për pushtet. Kushtimisht mund të thuhet se ishin harxhuar së "ngrëni" njëri tjetrin saqë, në një rast, tërë pushteti në Kosovë do të përqendrohet në një njeri, në Remzi Kolgeci, dhe kjo sa për ti bërë pushtetit serb shërbimin e nënshkrimit të humbjes së asaj "Autonomie" formale që kishim e për të qenë e keqja dhe ironia më e madhe këtë e kishin bërë të këshilluar nga kuazi intelektual që mbanin tituj të lartë shkencorë, por që i kishin shitur shpirtin djallit.

Ishin të shumtë edhe bashkëpunëtorët e imtë që kishte pushteti përfshirë këtu edhe ndërmjetës të shumtë që me veprime të tyre po ia zgjatnin jetën pushtetit serb e robërisë sonë e që po ia bënin argatin gjithherë në dëmin tonë që ishim bërë krejt të mjerë, ndërsa që çdo veprim i tillë i dëmshëm na ishte thikë në shpinë, kurse që këta spo kuptonin ose nuk donin ta kuptonin se ishin shitur lirë dhe se kjo në të vërtetë ishte vetëvrasje e tyre. Të tillët po i bënin shërbime nga më të ndryshme pushtetit. Pos të tjerash po ndërmjetësonin në shitblerje armësh pushtet- njeri i ynë, e më pas po i denonconin këta njerëz te

pushteti. Ishin të shumta rastet edhe kur po i paraqitnin rrejshëm, duke shpifur për ta, gjoja posedojnë armë, që më pas të ishin shpëtimtarët e tyre duke ndërmjetësuar te njerëz të caktuar të pushtetit me të cilët ishin bashkë kudo natë e ditë, në mënyrë që të zhvatnin para të majme nga të denoncuarit e të akuzuarit e shumtë që si raste po i krijonin vet. Në këtë kuptim ishte krijuar gjendje e rëndë kudo këtu, kurse në fshatin Korishë e në Grikoc po përsëritej gjendja e kohës dhe rrethanave të pushtetit të Rankoviqit. Atje praktikisht po bastisej çdo shtëpi, ndërsa që po merrej e torturohej mizorisht deri në alivanosje çdo mashkull i rritur, kurse që po liheshin të lirë vetëm pasi këtyre kriminelëve serb e shqiptar t'iu mbushte fyti nga para të djersës së këtyre të përvuajturve të mjerë.

Në këto rrethana të një gjendje të rëndë që s'mund të përshkruhet, ndihet krismë e armës së trimit; Besim Ndreca vret kryepolicin e kryekriminelin Millan Shoshkiq dhe atë mu për faktin se s'donte t'ia dorëzonte armën të cilën, gjithherë, gati haptazi po e barte me veti e të cilën po ia kërkonin që moti por që ky burrë s'po iu përgjigjej në ftesa, kurse që ata s'kishin guximin ta ndalnin e t'ia merrnin. Në të vërtetë, në një aksion të tyre, kishin provuar ta çarmatosnin në vend krejt publik, por le që se kishin çarmatosë, por të ndjekur nga ai kishin ikur si minjtë e ishin futur në stacionin policor në Suharekë, ndërsa që ky kishte ftuar komandantin e tyre në oborr të stacionit policor dhe i kishte thënë se: "Po t'ia lëshonte edhe njëherë këta zagarë, ai do të kishte punë me te".

Menjëherë pas këtyre krismave të trimit, fillimisht, shumica nesh do të mendojnë: "Çfarë do të bëhet, cila do të jetë hakmarrja dhe si do ta pësojmë"? Kurse shumë shpejtë do të kuptojmë: "Se kishim fituar një copë lirie". Kjo ngase dhuna do të ndalet e të thuash kishte marrë fund.

Rrethanat e reja të krijuara me këtë rast e i mllefosur nga ku ishim dhe për të mos u kthyer kurrë më aty, duke qenë kryetar fshati, kisha ftuar të gjithë njerëzit e fshatit në një takim të rregullt me ta. Takimin si zakonisht do ta mbajmë në lokalet e shkollës së fshatit, ndërsa që edhe kësaj here, si gjithherë në të kaluarën, kisha të pranishëm të ftuar të shumtë, të mos them të gjithë burrat e fshatit. Do të jetë një nga takimet e zakonshme të rregullta, ndërsa që për dallim prej herëve të tjera kur po ju predikoja e po i thirrja në mbarësi, tani i thirra haptazi në unitet dhe në krijim të një fronti të përbashkët kundër

së keqes, dhe ju mbajta një ligjëratë të gjatë duke ju shpalosë tërë gjendjen, kurse do t'ju shpalosë edhe efektet e krismave të armës së trimit; Dhe se kisha të vështirë ngase unë veç isha ekzaltuar paksa, por edhe ata ia kishin ndier aromën asaj copë lirie që po gëzonim. Kishte edhe të tillë që kishin ulur veshët. Meqë isha i përgatitur pak më mirë për këtë takim në mënyrë të thuash telegrafike, por shumë burrërisht i kisha thirrur me emër e mbiemër të gjithë ata që në një mënyrë a në mënyrë tjetër ishin afër pushtetit, po bashkëpunonin ose po ia bënin çfarëdo argati, dhe në sy të burrave të thuash ua kisha qitur të gjitha të palarat e të gjitha ligësitë në shesh; Por që ua kisha thënë aq sinqerisht e aq vëllazërisht sa që asnjëri prej tyre s'do të më hidhërohej dhe këtë e kam vërejtur në ditët në vijim dhe gjatë gjithë së ardhmes, kurse që edhe sot garantoj moralisht se askush nuk më kishte denoncuar te pushteti për këtë.

Në këtë kohë, shokë të mijë nga e kaluara dhe ndonjëri nga të kryesisë së fshatit ku unë isha kryetar, po hetoheshin për një aferë armësh këtu. Njëri prej tyre, Isuf Basha, nën kërcënimin se do të mund të burgosej kishte ikur jashtë, në Zvicër, dhe ishte strehuar te vëllezërit e tij, ndërsa që nuk e di ç'po ndodhte me të implikuar të tjerë në këtë rast, por që baca Xhavit (Basha) po merrej në pyetje, në lidhje me rastin, në stacionin policor në Mushtishtë. Në njërën nga pyetjet e shumta që i kishin shtruar, baca Xhavit ishte përgjigjur se: "Kryetar fshati kemi Skenderin", ndërsa që kjo ju kishte mjaftuar ti thoshin që: "Të nesërmen të më merrte me vete edhe mua dhe që të mos shkonte pa mua, përndryshe do ta kishte edhe më keq".

Mënyra se si po më ftonin mu duk krejt e pazakontë, ndërsa që po mendoja se isha spiunuar nga ndonjë i pranishëm në takimin në shkollë. Sidoqoftë kisha guximin të mos iu përgjigjesha në këtë ftesë dhe ti thosha bacës Xhavit, t'iu thoshte që Skenderi është shprehë se: "Nuk ju vij për selam të askujt e nëse ju duhem le të vijnë të më marrin". Baca, thjeshtë për të mirën time më kishte thënë të shkoja, por ja që unë kisha ngulë këmbë.

S'kishte kaluar gjysmë ore, kur ja, erdhën. Ishin dy polic serb, që të dy të rinj në moshë; Ndërsa unë që kisha një përvojë të mirë nga e kaluara i testova që në fillim, duke ju thënë: "Të merrja automjetin tim apo do të më kthenin ata"; Sepse unë, siç po thosha: "S'doja të kthehesha në këmbë nga Mushtishta", ndërsa kur ata më than që: "Vëllai të vinte me automjet për të më marrë e unë duhej të shkoja me

ta”, kuptova se s’kishte gjë serioze dhe vërtetë me ta më pas po luaja si macja me miun.

Ishin kohë kur për shkak të seriozitetit të gjendjes, pos armëve të brezit, policët po bartnin edhe pushkë automatike; E derisa po udhëtonim, ndërsa që këto armë i kishin në automjet, pranë vete, por që unë mund t’ju qasesha me lehtësi; Në shenjë provokimi po ma tërhiqnin vërejtjen të mos provoja asgjë, kurse që unë do ti provokoj tepër rëndë ngase me pushkën e Besim trimit, ne me të vërtetë ia kishim marrë orën serbit, se s’ishin të fortë siç paraqiteshin e siç dukeshin dhe këtë unë po e vëreja mirë. Do ti pyes se: “A po e dinin se kënd kishin marrë”? Dhe këtu mbetën. S’kishte përgjigje. Me kaq kishte përfunduar muhabeti me ta deri në stacionin policor në Mushtishtë. Më duhet të them se veçmas nga njëri prej tyre prisja të jetë i dhunshëm. Ishte shtat lartë dhe se i kishte duart tërësisht të prera nga xhama shishesh e nga pija e tepërt dhe pa kontroll e alkoolit, ndërsa që dukej se mund të ketë provuar edhe drogën a narkotik tjerë të ndryshëm. Tjetri prej tyre s’është për tu përmendur, ishte më thatak se unë dhe po më humbte sysh.

Sapo të kishim hyrë në njërën nga zyrat në stacion policor më prezantuan të pranishmin aty që s’po ia njihja gradat por që më than se ishte zëvendës komandant në këtë stacion policor dhe se quhej Marjan, por që menjëherë, me ftesë të këtyre policëve, që të tre kanë dalë jashtë, edhe kjo, gjë krejt e pazakontë për përvojën time, ndërsa që mua po më shërbente mirë dhe se unë po mësoja se kush ishin në të vërtetë këta, tani. Thjeshtë ishin bërë hiq. Edhe ky, Marjani, s’është për tu përmendë, por ja që po kërcente siç themi ne: “Si kastravec”. Më pyeti për armën, nëse kisha dhe më tha ta dorëzoja menjëherë. Iu përgjigja shkurt: “Se s’kisha armë, të mos më pyeste më për të dhe të mos priste se do ti dorëzoja armë”. Brofi në këmbë dhe filloi të më pyeste: “Kush isha unë që s’doja të dorëzoja armën”? Dhe po më shante Ibrahim Rugovën. Do ti them shkurt: “Se s’doja të merresha më me ç’po thoshte për armën”, ndërsa që ia tërhoqa vërejtjen: “Të mos gabonte të më shante nënën, dhe të mos lodhej kot duke më sharë Rugovën”. Kishte përfunduar duke më thënë: “Se tash vije komandanti” e që po ma përmendte me emrin Dragan dhe se “Do ta shihja, unë që sipas tij isha i sëmurë”. Më pat qitur jashtë në korridor dhe më pat thënë: “Të prisja komandantin ngase ky s’po donte të merrej me të sëmurë”, ndërsa që më lan të prisja aq gjatë saqë më ishte

mbushur mendja se ishin në hall me mua si të më thoshin të shkoja në shtëpi, por ja që edhe unë doja ti testoja sa më mirë e sa më gjatë deri në fund.

Pas ndonjë dy orësh erdhi komandanti, më përshëndeti për dore, aty në korridor, duke mu drejtuar me: "Si je Bashë"? Dhe më mori, urtësisht, brenda, po në të njëjtën zyrë. S'mund të them nëse kështu lexoi në tre rreshtat e shkruar që i kishte lënë kolegu i tij, në një copë letër, në tavolinën e tij të punës apo më tha siç ishte sugjeruar, por që bisedën e nisi duke më quajtur "njeri interesant" duke më përmendë: "Se në përvojën e tij isha rast i veçantë dhe tepër interesant". Do ti them: "Se s'po kuptoja gjë", dhe do ta pyes: "Pse"? Më tha: "Bashë, ju keni thënë se s'doni të dorëzoni armën". Kurse unë ia ktheva aty për aty, paksa mjeshtërisht e meqenëse po sillej me butësi: "Se ata djemtë", duke aluduar e duke i bërë me dije se po flisja për policët: "Ishin djem të mirë, ndërsa që bashkëpunëtorin, përkatësisht zëvendësin e tij, e kishte krejt të pacipë". Më përmendi: "Se mund ta kem hidhëruar unë me një deklarim timin të tillë"; Ndërsa që unë i thash: "Se s'po më dëgjonte mirë" dhe ia përsërita se: "Kishte bashkëpunëtorë krejt të pacipë". Tani kur po më pyeste: "Pse"? Unë, s'po i jepja shpjegim, por do ti them: "Se të tillët qojnë në përshkallëzim të dhunës dhe se askush s'fiton nga kjo". Do ti them: "Se s'kisha kujt ti flisja përndryshe do ti thosha se s'duhej lejuar të rrezikosh vetën për një plaçkë të vogël që mund të te dal së shantazhuari njerëzit në kërkim të armës që se kanë e mandej duke hequr dorë nga kërkesa në emër të ndonjë përfitimi për këtë". Më tha: "Fol, fol Bashë". I thash: "Po, edhe nëse nuk më beson e nuk më kupton"; Do ti them: "Se zëvendësi i tij kishte filluar me të shara. E kënd po më shante- Rugovën, që unë e shoh vetëm në televizor e në faqe gazetash, kurse që ai bën jetë të mirë sikurse udhëheqësit tuaj e ne të vegjlit rropatemi me vështirësitë e jetës për bukën e gojës, ndërsa që neve na shtyjnë të rrahim ose të vrasim njëri- tjetrin për një armë që zakonisht se kemi e edhe po ta kemi çfarë mund ti bëjmë, me të, Jugosllavisë që po e zhbëjnë të mëdhenjtë tuaj përditë nga shumë". Po mirë më tha Bashë: "Pse jeni ju të pakënaqur"? I thash shkurt: "Nga dhuna që ushtroni ju, nga i tërë aparati i juaj shtetërorë, që s'është as pushtet i popullit tuaj, por që ju kanë verbuar sytë aq shumë nga shovinizmi sa më s'jeni në gjendje ti bëni mirë llogaritë dhe se s'po kuptoni se ne, në fund të fundit, mund të humbim veç robërinë, kurse

ju jeni bërë argat të shpërbërjes dhe shkatërrimit të Jugosllavisë ku realisht e keni pasur mirë"; "Deri dje na quanit vëllezër, kurse tani gjithë kjo urrejtje e dhunë ndaj nesh". "E pse"? "Ngase duam të jem të barabartë me ju"; "Dhe çka i prishë punë kjo njeriut të thjeshtë serb, ose edhe ty që ke pushtet, ndërsa udhëheqësit tuaj po, se ai kështu mbahet në pushtet, përndryshe bashkë unë edhe ju do të kërkonim kushte më të mira jetese e ai s'mund të na i siguroj, prandaj të ka krijuar kushte e të ka dhënë pushtet të ushtrosh dhunë me pretekste nga më të ndryshme e të marrësh ndonjë plaçkë që s'ia vlen kur familja jote s'ka siguri nëse ti do të kthehesh sa herë të përcjellin nga shtëpia, kurse për ne gati e dinë se jemi të vrarë kurdo dhe kudo që ju na hasni edhe kur jemi thjeshtë në punët tona e në pasurin tonë". Do të më pyes: "Nëse më rrinte mendja te vrasja e fundit", dhe po aludonte në vrasjen që atyre iu kishte djegë e që vërtetë kishte bërë jehonë dhe kishte ndryshuar padyshim gjendjen. Do ti them: "Po, por jo vetëm në atë, në të gjitha". "Më shumë në ato tjerat ngase ato janë dhuna, kurse kjo është përgjigje dhunës". Do të më thotë: "Se ai ishte kriminel". E unë ia ktheva se" Ishte dajë imi dhe shok imi me të cilin jam shoqëruar gjatë dhe se ishte nga burrat e fortë që po të kishte drejtësi do ti duhej shumë vendit e njeriut të këtushëm, por ja që e kishit mbështetë për muri siç po na mbështetni përditë e më shumë secilin prej nesh, ndërsa që secili detyrohet të reagoj". Më pyeti: "Nëse vërtetë e kisha njohur Besimin"? Ndërsa unë i thash: "Se s'po më dëgjonte, dhe se ndoshta duhej lënë bisedën. Ja përsërita se: "Besimi ishte nga njerëzit më stabil që njihja dhe se ishte me karakter të fortë e s'po i bënte të keqe kujt, ndërsa që s'po e duronte dhunën dhe padrejtësitë që po na bëhen në vazhdimësi të gjithë neve vetëm e vetëm ngase jemi diçka tjetër nga ju- që jemi Shqiptarë". Do ti them se: "Edhe macja që është mace ne e dimë që se duron dhunën e aq më pak burri". Do të më pyet: "Nëse mund ta merrnim si hero, ndërsa aktin e tij si burrëror e heroik"?. Iu përgjigja: "Se që tani më ka rënë të dëgjoj se po i këndohet kënga e ne iu këndojmë vetëm trimave". Më tha sërish: "Se jam rast i veçantë në përvojën e tij". E unë i thash: "Se isha i sinqertë edhe kur kam thënë se s'kam armë dhe se ishte koha të shkoja ngase jam kryefamiljar dhe i pari i fshatit e meqë jam tepër i përkushtuar punëve të mira, kamë punë dhe obligime të shumta". Krejt në fund më tha: "Se do të vinte personalisht, për mu, nëse dikush i thotë se Skenderi ka armë"; E unë ia ktheva: "Se, kuptova që tërë kjo

ishte rrenë". Më tha: "Se s'ishte e ndershme që po ia thosha këtë". Do t'ia kthej se" Burri kurrë nuk rrenë dhe se ne ende kemi kohë të burrërohemi", këtë ia thash ngase edhe ky ishte ende i ri në moshë.

Në pyetjen e fundit, për kërshërinë e tij: "Nëse kisha pasur punë ndonjëherë me pushtetin"? Do ti them: "Po, madje disa herë dhe se isha i dënuar politik"; Sapo i thash këtë cingëroi telefoni, ndërsa në telefon kishte Mishkoviqin që ishte Shef në Njësinë e Shërbimit të Sigurimit Shtetëror për Komunën e Suharekës e të cilit si përgjigje ç'po bënte, i tha: "Se kishte Skender Bashën këtu dhe se mund të ishte një rast interesant për të". Mishkoviqi i tha: "Që të më dërgonte të nesërmen atje", ndërsa që unë me ngulm po thosha e po insistoja të mos shkoja dhe se s'do të shkoja. Ata po bisedonin edhe më tej në telefon dhe u dakorduan që ky këtu të më lëshojë ftesë. E kur iu thash: "Se s'do ti përgjigjesha as ftesës"; më janë lutur njëzëri ti përgjigjesha ftesës dhe të shkoja ngase unë do ta kisha më lehtë që të mos më shqetësohej familja. Iu thash se do ti përgjigjesha ftesës, por që vërtetë ma bënë keq ngase siç isha shprehë, unë thjeshtë, s'kisha kohë për të tilla gjëra. E lamë të zgjohesha vonë dhe të shkoja diku nga ora dhjetë.

Të nesërmen, në bisedë me Mishkoviqin dhe me zëvendësin e tij, edhe më mirë kisha parë e kisha kuptuar se këta thjeshtë ishin tërhequr nga çfarëdo veprimi i dhunshëm. Vërejta se në plan të parë kishin biznesin dhe keqpërdorimet e plaçkën, ndërsa që kuptova se po luanin me parat tona dhe se për të realizuar këtë kishin bashkëpunëtorë e argat të shumtë nga të sojit tonë. Shkonin aq larg saqë po ndanin parat e po kusuriteshin para meje prandaj më ishte e rëndë të bisedoja çfarëdo me ta. Më mbanin aty e meqë po dilnin e po më lenin shpeshherë vetëm po më kërkonin falje herë njëri herë tjetri. Pyetjet që po më bënin ishin nga më banalet. Po më pyesnin: "Çmendoja unë për Luftën në Bosnjë- Hercegovinë? Meqenëse isha i përndjekur e i dënuar politik e që tani isha kryetar nëndege në LDK: "A isha më afër Rugovës apo Demaqit"? E të ngjashme, deri te: "A kisha patentë shofer, apo ndoshta më duhej"? Kurse që unë shpeshherë s'po merrja mundin t'ju përgjigjesha fare dhe s'po ju prishte gjë punë. E kishin thjeshtë për të raportuar se kishin punuar, ndërsa që më kishin krijuar përshtypjen se s'donin të prishnin raporte me kënd dhe se në secilin njeri shihnin mundësi fitimi e biznesi për ta. Në kushte e rrethana të tilla më kishin thënë të shkoja edhe të nesërmen e unë iu isha përgjigj se s'vij më dhe kështu kisha vepruar e edhe ata sado që po më

kërcënonin se do të më merrnin dhunshëm me polici, do ta lënë me kaq.

Të them se të gjithë bashkëfshatarët e mi ishin trazuar dhe po ndjenin keqardhje, po më vizitonin më shumë se gjithherë më parë, kurse unë po ju thosha, me tepër modesti, se kisha kaluar mirë, se s'isha i spiunuar nga askush dhe se vërtetë kjo po më kënaqte tej mase, ndërsa që s'po ju flisja më gjatë për rastin. Kjo është hera e parë që rrëfehem publikisht, ndërsa që shokëve ua kam biseduar këtë edhe më parë, me qëllimin më të mirë për të treguar efektet e krismave të pushkës së Besim Ndrecës dhe të bëmat e këtij trimi, nderë e krenari e kombit, i cili me krismën e kësaj pushke e krismat e pushkëve të Drenicës e të Dukagjinit, po pasonte Ali Ajetin në kthimin e krenarisë kombëtare në këto troje.



Dëshmori i kombit:
Besim (Adem) Ndreca (10.maj 1956- 03.maj 1995).

Fëmijë të Skenderit, dhe fëmijë të Enverit; Në vizitë lapidarit të Besim Ndreca: Hajria, Diamanti, Bleona, Vlora, Fitorja, Merita, Thëllënza, Meritoni dhe Flamuri.

Jeta private

Nga viti 1990 deri në fillim të luftës në këto anë, për të mbajtur familjen do të bëjë punën e zdrukthëtarit dhe drugdhendjes, ndërsa që po merresha edhe me punë bujqësie e blegtorale prej nga do të sigurojë një jetë solide për familjen dhe shpeshherë do të ndihmojë të tjerët në tejkalimin e vështirësive. Përkrahja nxënës të fshatit në shkollim; Isha i kyçur në "Familja mban familjen".

Kam pasion dhe më njohin për drugdhendje; Dhe shpesherë krijoj vepra me vlera të mirëfillta arti.

Pamje e kutisë së dyzenit. Punuar, për nusen, më 1985.

Në bashkëshortësi me Raba Loshin kemi lindur shtatë fëmijë. Fëmijët e parë do të na lindin binjakë, në ditën e Flamurit Kombëtarë e të Pavarësimit të Shqipërisë: Vlora dhe Flamuri. Flamuri (i parë) do të na vdes pas nëntë muajve, kurse më pas do të na lindë: Thëllënza, Hajria, Merita, Meritoni dhe Flamuri, i cili do të na lindë në kohën kur po varrosej dëshmori i parë i UÇK- së në këto anë, Kadri (Sadri) Kokollari.

Fillimet e veprimit politik-ushtarak

Në fillim të vitit 1998 do të jem në kontakt të vazhdueshëm me Hysen Gegën, Halil Krasniqin, Ilaz Kadollin, Gafurr Elshanin e shokë të tjerë dhe do të shqyrtojmë mënyra të veprimit në rrethana të reja të krijuara në Kosovë.

Fillimet e veprimit ushtarak-luftarak, angazhimet tjera

Më 15 maj 1998, në shtëpinë time do të vije stafi komandues i njësisë së UÇK-së "Çeliku 50", përkatësisht komandanti Habib Elshani dhe Ilaz Kadolli, të cilët shtëpinë time do ta caktojnë bazë të parë ushtarake, ndërsa mua do të më jepet detyra të krijojë e komandojë njësinë e parë të UÇK- së në këto anë. Gjatë marsit të atij viti, së bashku me Bislim Muqën, Azem Kolgecin dhe Enver Bashën, do të krijojmë bërthamën e më pas njësinë në përbërje të së cilës do të veprojnë dy skuadra, të cilat i komandonin Bislim Muqa dhe Azem Kolgeci, kurse në përbërje të njësitit kishte shtatëmbëdhjetë ushtarë, të gjithë të armatosur, të cilët deri në qershor do të bëjnë roje vëzhgimi. Në këtë kohë, njësit ishte në pritje të ardhjes së një oficeri; Kjo ishte marrëveshja ime dhe "Çeliku 50".

Krahas kësaj, këtu ishin bërë të gjitha përgatitjet për rrethanat e reja. Kështu, unë, do të këshillohem me Bajrush (Sahit) Llugagjiun e Sejdi (Miftar) Muqën, ndonjëherë edhe me Mustafë (Adem) Kolgecin; Do të regjistrojmë vullnetarë të cilët do të na i ushtrojë e përgatis për luftë "Abi" (Afrim Basha) dhe do ta caktojmë shitoren e Hamit Rraqit si qendër për grumbullimin e informatave, kurse në marrëveshje me Velime (Brahim) Loshi do të vendosim që komanda e njësisë të vendosej në shtëpinë e tyre. Gjatë kësaj kohe, mua dhe njësitin tim do ta vizitojë Idriz Hyseni nga Drenica dhe Avdi (Sadik) Kadolli, me ç'rast bashkë do ta vëzhgojmë objektin e Antenës.

Në ndërkohë, sapo kishte ardhur Sadik Halitjaha, i cili kishte marrë detyrën të formonte Batalionin II, do të më kontaktojë mua dhe bashkë do të vendosin që njësiti që po vepronte në Vraniq të ishte Togë që vepronte në kuadër të Kompanisë që mbulonte territorin e Buzhalës, Bukoshit dhe Vraniqit, e në kuadër të Batalionit II, me komandë në Budakovë. Me propozimin tim do të merremi vesh që të bisedonim me Adem B. Kolgecin mundësinë e emërimit të këtij të fundit komandant të Togës në Vraniq, dhe kështu u bë. Më pas, jam pran komandantit Sadik Halitjaha; në kontakt të vazhdueshëm me Kryesinë e fshatit dhe me këshilltarët e mijë, në realizim të kërkesave dhe të detyrave të kohës dhe të atyre që shtronin bashkatdhetarët, bashkëluftëtarët dhe rrethanat në prag të luftës. Tanimë do të veproj haptazi, nën armë, dhe do të derdh mundin në realizimin e detyrave nga më të ndryshmet në tërë zonën që pretendonte të mbulojë me veprimtari luftarake Batalioni II, për të organizuar ushtrinë dhe luftën.

Në verën e vitit 1998, me kërkesën e profesorit Shefki Muqa dhe Halil Krasniqit do të ndihmojë në pajtimin e kundërshtimeve dhe në tejkalimin e mosmarrëveshjeve mes njësiteve "Çeliku-50" dhe "Lisi". Këtë do ta bëjmë në kontakt me Feim Balajn dhe me Ukë Bytyçin.

Skenderi: Foto nga koha e luftës, dimër 1998- ’99.

Pas ndërhyrjes së forcave armike kundër organizimit ushtarak të UÇK- së dhe pozicioneve të saj, më 27 shtator 1998, me kërkesën e shokëve, sërish marr komandën në njësitin e Vraniqit dhe e komandoj atë për tri ditë, sa zgjati kjo përballje me forcat armike: ushtarake, policore e paraushtarake serbe. Për zëvendës timin kisha emëruar Reshat Muqën.

Me të kaluar ky rrebesh, sërish jam në organizim dhe rimëkëmbje. Për ta arritur këtë do të bashkëpunojë me Sadik Halitjahen, me Komandant “Guri”, me Kurtesh Fondajn, Halil Krasniqin, Selim Hazirajn, Mehmet Mustafën, Haqif Kadriajn, Haxhi Sallaukën, Agim Zybën, Muhamet Buzhalën etj; Kurse me t’u ndërruar komanda e Batalionit II, në nëntor të vitit 1998, komandanti i ri i Batalionit II, Fehmi Berisha nga Gurbardhi i Malishevës, më emëron: Ndihmës të tij për çështje morale e politike, si dhe për çështje

informimi e marrëdhënie me civil, përkatësisht Komisar Politik në Batalionin II.

Këtu jam deri në fund të luftës, në realizim të detyrave të shumta, ku pos të tjerash më bie barra që të krijoj, në të gjitha fshatrat e pjesës Jug- Lindore të Komunës së Suharekës, Shtabet Civile të Mbrojtjes dhe të koordinojë veprimet e tyre si dhe të ruaj e të ngritë lart e me lart moralin e popullatës dhe të ushtarëve të UÇK- së, me të cilët e bënim luftën; do të ruaj e kultivojë raportet e bashkëpunimit e bashkëveprimit mes Batalionit II dhe njësisë së Komandant "Abi", Komandant "Guri" dhe njësitet e Zonës Operative të Nerodimes, me të cilat kufizoheshim në veprime luftarake e të cilat i komandonte Ahmet Kaçiku. Në këtë kohë, nga Sadik Halitjaha e nga drenicasi Idriz Hyseni, do të jem i propozuar që këtë detyrë ta kryej pranë komandantit Tahir Sinani në Zonën Operative të Pashtrikut (ZOP). Por, me këtë, nuk do të pajtohem, me arsyetimin se këtu isha mes njerëzve që më njihnin dhe se do të jepja kontribut dhe ndihmesë më të madhe.

Si përgjigje kërkesës së komandantit të Batalionit II, Fehmi Berisha, do ta propozojë Reshat Muqën për Komandant të Kompanisë Vëzhguese- Diversante në Batalionin II, e përgatitur për ndërhyrje të veçanta e të shpejta dhe kështu ishte vendosur e bërë, e më pas ngjashëm do të veprojmë edhe kurë emërojmë Zaim Muqën komandant të Togës II në Vraniq.

Për të ruajtur karakterin çlirimtar të luftës do të bashkëpunojë me serbët lokal të fshatit Popolan dhe Dvoran. Kjo deri në mobilizimin e përgjithshëm, të dhunshëm të tyre, kur e prishën këtë marrëveshje.

Qëndrimi im i parë me të përfunduar lufta, ishte: Të rehabilitoheshin të plagosurit, të rivarroseshin ushtarët dhe civilët e varrosur gjithandej, të ruhej pasuria e njerëzve dhe fondi i bagëtisë, të rehabilitohej gjendja e rënd e krijuar si pasojë e luftës.

Veçmas do të kujdesem për fatin e robërve të luftës.

Angazhimet pas përfundimit të luftës

Më kishte rënë të dëgjojë se forcat serbe i kishin marrë ata në rrugëtimin e tyre për Serbi, e megjithatë, do të lus komandantin dhe zëvendëskomandantin e ZOP–it, Tahir Sinanin e Sadik Halitjahën, të

urdhërojnë kontroll të hollësishëm, thyerjen e të gjitha depove në Prizren, në kërkim të ndonjë të mbylluri, robi lufte. Për t'u siguruar do pyes në çdo shtëpi a banesë që ndodhet pranë burgut të Prizrenit dhe do të kontaktojë KMLDNJ në Prizren. Më pas do t'u rri fare pranë familjeve të këtyre robërve të luftës, deri në kthimin e tyre nga burgjet serbe, pas luftës.

Qeveria e Përkohshme e Kosovës do të më caktojë bashkë-koordinator, me Riza Vatën, për komunën e Suharekës. Detyrë e jona ishte të krijonim pushtetin civil në komunë, ndërsa ishim sugjeruar që vendin e kryetarit dhe nënkryetarit të Komunës ta rezervonim për vete. Për të shmangur çfarëdo fërkimi të mëtejmë, të dëmshëm, mes krahëve politikë në terren; do të përcaktohemi që për Kryetar Komune të sillnim, nga Durrësi, Halit Berishën, kurse për Nënkryetar të sillnim, nga Vlora, Haxhi Zybën. Dhe për të realizuar këtë, në Shqipëri kishim dërguar të afërmit e tyre. Me këtë nuk do të pajtohen shokët tanë, veçmas, Besim Baraliu dhe do ta emërojnë: Haki Gashin për Kryetar dhe Ilaz Kadollin Nënkryetar të Komunës së Suharekës, vendim të cilin do ta përkrahë Ramë Buja.

Për kontributin e dhënë dhe detyrat që kam kryer gjatë luftës, komanda e Batalionit II do të më nominojë për gradën e kapitenit, ndërsa udhëheqësit e rinj komunal do të më emërojnë Drejtor në Ndërmarrjen e Pyjeve të Komunës së Suharekës. Këtu do të qëndroj deri në vjeshtë të vitit 2000, kurse me vendimin tim, të parë në këtë ndërmarrje, do t'ia ulë vetës pagën për 50 për qind, duke zbutur dallimin mes pagës maksimale dhe asaj minimale nga gjashtë me një, në tre me një. Do të angazhojë në terren të gjitha mundësitë që kisha të mbrojë pyjet.

Angazhimet në jetën civile të pasluftës

Në fund të vitit 2000 UNMIK-u, krijon Agjencionin Pyjorë të Kosovës (APK) dhe do ta shuaj Ndërmarrjen e Pyjeve, duke krijuar Njësitë Komunale të Pylltarisë. Tani caktohem Përgjegjës i Njësisë Komunale të Pylltarisë për Komunën e Suharekës dhe këtu do të jem deri kur "Partia Demokratike e Kosovës" (PDK), ta marr pushtetin në nivel qendror, me ç'rast, njerëzit e saj, më largojnë nga aty. Pas këtij zhvillimi, bëj punën e teknikut të pyjeve.

Në vitin e parë pas përfundimit të luftës, pasi arrijë ti pajtojë kundërshtitë dhe të shuaj tendencat për ndarje të ish- luftëtarëve, themelojë Degën e Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK- së për Suharekë. Kuvendi do të zgjedh kryetar Nezir Kryeziun, kurse unë do të jem anëtar i kryesisë së kësaj shoqate. Meqë, kryesia e shoqates ishte jofunksionale, do të bëjë përpjekje të shumta, ta bëjmë funksionale, por pa sukses, andaj me kërkesën time dhe ndonërit nga ne, do të vet- shkarkohemi.

Po atë vit, bashkë me Bislim Muqën dhe Arben Veselajn, do të përkrahë dhe do të ndihmoj në themelimin e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK- së, ku shokët do ta zgjedhin kryetar Enver Bashën, të cilin më pas, sapo ai ti vë punët në binarë, do ta heqin nga aty, në mënyrë krejt joparimore dhe atë për interesa të ngushta një grup njerëzish që në luftë kishin pasur fatin e njëjtë me të.

Veçmas do të kujdesem dhe padyshim, jam më i merituari, për demokratizimin e jetës dhe për tolerancën politike në fshatin Vraniq por edhe në nivel komune deri në zgjedhjet e para politike të pasluftës e edhe më tej.

Jeta politike pas luftës

Menjëherë pas luftës do të refuzojë ofertën tepër serioze t'i kthehem Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me "shpërblimin" se do të merrja "gjithë të mirat e botës" duke filluar nga paratë e shumta me të cilat LDK- ja atëherë po blinte aktivistët, postet në parti, në pushtet e deri te karriera e bujshme e garantuar në politikë.

Me gjithë vërejtjet dhe sugjerimet nga shokët e LPK-së do të ikë nga ajo dhe do të bëhem anëtar i "Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës" (LKÇK). Do të jem nismëtar dhe bashkë me Haxhi Zybën, Riza Vatën, Ibrahim Hoxhën, Leonard Shalën dhe shumë shokë të tjerë do të themelojë Degën e LKÇK-së në Suharekë. Në LKÇK gati gjithherë do të jem kryetar ose do të ushtrojë detyrën e Kryetarit të Degës, kur Haxhi Zyba kishte probleme me shëndetin, ndërsa do të jem edhe Anëtar i Këshillit të Përgjithshëm në nivel Qendror, në Prishtinë, në mandatin e fundit, para se ajo të shndërrohet në Lëvizje për Integrim e Bashkim (LIB). Në LIB, isha Kryetar i Degës për Suharekë dhe Anëtar i Këshillit të Përgjithshëm në nivel Qendror.

Lufta kishte përfunduar suksesshëm por megjithatë me marrëveshje (Marrveshja e Kumanovës), andaj në këtë pasluftë e sa i përkiste statusit të Kosovës çdo gjë ishte pezull. Po kontaktohesha nga përfaqësues të mekanizmave të shumtë ndërkombëtarë, madje deri te përfaqësuesi i qendrës së NATO- s në Bruksel, me të cilin ishim zgjatur plot gjashtë orë në bisedë. Në të gjitha këto takime me këta, veçmas po përmendja qëndrimin e LKÇK- së: "Se çfarëdo kthimi i Serbisë në Kosovë, për ne do të thoshte luftë". Disa herë po më përmendnin se më karakterizon sinqeriteti, se jam i këndshëm në bisedë dhe se jam bashkëbisedues interesant. Do të më thurin edhe lavde të tjera që nuk më bënin përshtypje, ndërsa që ne kishim tërë përkushtimin të mos e humbnim paqen- pasluftën. Ishin vite të rënda, politika kosovare kishte marrë tatpjetën, e ne në pamundësi t'ia ndërronim rrjedhën, kishim dalë me kërkesën të mos dilej në zgjedhje. Kohë dhe rrethana skajshmërisht të rënda e të mundimshme, tani në plan politik. Numër i konsiderueshëm bashkëluftëtarësh i ishin kthyer LDK- së, të cilën ishte një rast i mirë ta qonim në histori ose edhe më mirë në harresë, meqë kishte ulur kokën dhe ishte përmbysur e tëra; E edhe më keq që numër poashtu i madh i tyre po i bashkoheshin PDK- së me gjithë gënjeshtrën e sajë, që në lindje, se kishte dalë nga lufta. Janë kohë kurë këta të parët (LDK) duhej të ndjeheshin keq për të bëmat, por edhe për ato që si kishin bërë, ndërsa që këta kishin ngritur kokë kundrejt çlirimtarëve, kurse të dytët (PDK) po sakatoseshin së rrahuri gjoks për të bëmat e tyre. Të lirë ishin vetëm të pamoralshmit; E unë për herë të parë kisha kërkuar ndihmën e Zotit.

Me gjithë respektin për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), s'do të pranojë të shkojë Kryetar i Degës së saj në Suharekë, në një moment vështirësie që kishte kjo parti, para se të shkonte Vesel Maliqaj kryetar. S'do të pranoj, edhe dy herë të tjera, të jem Kryetar i Nëndegës në Vraniq për t'ua ringjallur këtë nëndegë, ndërsa gjithë herë do t'i përkrahë në zgjedhje, qofshin ato lokale ose vendore.

Sado i lutur nga profesorët e nderuar, Shefki Muqa e Bexhet Berisha, s'do të pranoj të shkoj të instalohem kryetar as në Degën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për Suharekën, kjo në një moment të krizës së thellë në këtë degë, para se të shkonte aty Safet Hoxha. Tashti, përcjell me shumë simpati veprimet dhe mënyrën se si i bënë veprimet politike lëvizja "Vetëvendosje" dhe jam duke e përkrahur moralisht atë.

Kisha emocione kur arritëm bashkimin e serishëm të “LIB” dhe “LB”, por meqë burrat s’po gjejnë mundësi unifikimi me subjektet tjerë që angazhohen për bashkim kombëtarë, e i vetëdijshëm se bashkimi arrihet vetëm duke u bashkuar, fillimisht, individët; Sapo i zgjedhur Anëtarë në Këshillin e Përgjithshëm të “LB”, paksa i revoltuar do të pushoj aktivitetin tim politik, në ruajtje të energjisë që ka mbetur për ndonjë veprim atdhetarë. Këtu duket të jetë hera e parë që “Ik”; Por edhe do të mësoj se ikja në të vërtetë nuk është gjithëherë një gjë e keqe. Njeriut, gjithësesi, ndonjëher iu dashka të strehohet. Ose, thjeshtë arratisem sado i vetëdijshëm që arratisja s’është liri, edhe për t’iu lehtësuar punë atyre (LDK- së në fshat) që në pasluftë ishin marrë vesh dhe i kishin vu vetes detyrë të më shkatrronin politikisht. Thënë më drejt: Kishim fituar mbi pushtuesin, dhe nuk doja të mundem e as të fitoja mbi shqiptarët. Është për keqardhje kështu si popull inteligjent që jemi, ndërsa nga mospuna jonë jemi bërë krejt injorant dhe të pa ditur. Sikur nuk ndjehemi mirë kur s’kemi kënd mbi kokë. Nga kjo vuajm e do të vuajmë edhe më, tani kur do duhej të përjetojmë një rilindje të bujshme e të fuqishme kombëtare. Sërish po vonohemi, të mjerët ne.

Letërnjoftimi im

Më karakterizon dashuria dhe respekti për njerëzit, veçmas për shokët; Sinqeriteti dhe ndjenja e bamirësisë. Flas sipas shembullit tim, nuk thërras; S’lidhem me individin, ngase aty ku është thënë më së shumti “Rroftë”, aty ka dalë gërmadhë; Te njerëzit gjithherë kam kompensuar zhgënjimet; Kurrë s’kam treguar shenja prej karrieristi; Gjithherë i jam shmangur çfarëdo klani e çfarëdo rryme; Përkulem para flamurit kombëtar dhe veprës së dëshmorëve; Më shkatërron varfëria intelektuale, psikologjia e robit, mendësia fisnore e organizimit dhe qeverisjes. Shkruaj poezi, të cilat herë pas here i botoj aty- këtu.

Kështu siç përshkruaj besnikërisht veten, duket të mos jem i keq. Pranoj se edhe gjithaq i mirë nuk isha. Lexuesi mund të lajthit. Mund edhe të kuptohem si një uragan kur është fjala për punë të mira; Por jo. Edhe unë jam njeri, ndërsa që Niqe, gati dy shekuj më parë, i lodhur nga çfarë jemi ne, ka kërkuar Mbinjeriun. Unë them se kishte shumë të drejt. Shtazorja te ne po e mundë gjithherë njerëzoren në ne.

Edhe më tej njeriu po mbytë njeriun për asgjë. Për më shumë edhe po e dhunon atë; Edhe po e han atë. Dua të them se po i ha mishin, gjë që si bëjnë shtazor të tjerë llojit të vet.

Ka një varg dobësish që me të drejt i përshkruaj vetes. Përmendë se i jam nënshtruar autoritetit të gati secilit e që për pasojë shpeshherë ose gati gjithherë isha i dyti, ndërsa që me tepër mund mbaja në këmbë të parin. Më ishin pengesë, madje më ndalnin të bëja punë të mira, njerëz që s'ka qenë dashtë të mund të më ndalnin ngase ishin për tu mos u përfillur, por ja që unë e teproja me respektin për ta.



Skenderi (foto e vitit 2010)

POEZIA

Urrejë

Nëse diçka urrejë,

urrejë armët;
E ngaqë më së shumti urrejë robërinë,
rroka pushkën të fitoj lirinë.
Qershor 1999, Vraniq.

E pabesueshme
Shumë dhe ra në varrin tim
e unë s'jam aty
është kjo liria e kërkuar
a amshimi im është ky?
Qershor 1999, Vraniq.

Betimi
O ju që vdiqët për atdhe.
Unë, që më iku rasti,
Betohem:
Se do të qëndroj te këmbët e këtij populli,
Dhe do të jem hija juaj mbi këtë dhe.
Qershor 1999, Vraniq.

Veli Muqa
Të lumtë që i mbajte:
Fjalë e besë Ibrahim Lutfisë;
E që i dhe dëshmorin,
Reshat Muqa, lirisë.
Shtator 1999, Vraniq.

Pishtarëve të lirisë
(Zaimit e Reshatit)
Ju, që dëgjuat:
zërin e atdheut,
gjëmën e tokës mëmë.
Ju, që më së miri
ditët të jetonit jetën,

por që se deshët atë pa nderë.
Ju, o trima të lirisë
me gjakun tuaj njomët tokën,
e ne, na e bëtë jetën pranverë.
Tetor 1999, Vraniq.

UÇK
Dorë e zërit të arsyes,
Dritë e agut të lirisë,
Kandil që ndrite mendjet,
Krenari Shqiptare sot.

Gjoks Kosove,
Fole shqiponjash,
Gjak i ri qe derdhet,
Flamur më i kuq se kurrë.

Lindja e motit të madh,
Betim për fitore,
Cicërimë zogu i lirë,
Behar lirie sot.

Fëmijë i djepit të pluhurosur,
Shkëndijë zjarri e zemrash,
Rreze dielli e shprese,
Dritë e syve tanë.

Stinë e pranverës,
Ag lirie e vonuar,
Guri i themelit- muri,
Çatia e lirisë sot.

Forcë që shpërndanë errësirën,
Që ndritë shpirtin,
Ngrohë zemrat,
Burim i këngëve të trimërisë.

Pjellë e qiellit të përflakur,

E nënës së përlotur,
E vashës që priste kot,
Zot i tokës së larë me gjak, sot.

Flamur i shpalosur trimërie,
Roje trojesh stërgjyshore,
Flakë e ndezur për liri,
Krejt qëndresë dhe krenari.
Tetor 1999, Vraniq.

Pushka për liri këngë e poezi
Kur e kishim jetën në të sosur,
zemra na ish e plagosur.
Kur shkonim kah perëndimi,
na kishte kapluar hidhërimi.
E kur u dëgjua jehonë e pushkës,
u dha kushtrimi për liri,
armën mbajtëm fort në duar,
atë e kishim këngë e poezi.
Nëntor 1999, Vraniq.

Urtësisht
Një shok te një varr,
dëgjova duke mërmëritur.
Lum ky që vdiq tash,
e shpëtoi pa u koritur.
Dhjetor 1999, Vraniq.

Luftëtarit të lirisë
Ti pjellë e dheut- atdheut,
mbaje kokën lart ndër mote,
Ballin hapur ke, i nderuar je.
Të shajnë, të njollosin kot,
nuk përdhosesh dot.
Mos ia vë veshin zhurmës shurdhuese,
mjerim i shoqërisë dje e sot.
Janar 2000, Vraniq.

Edhe sa
Edhe sa do t'u këndojmë trimave
Heronjve,gjakut të dëshmoreve
edhe sa do t'i ankojmë dhembjet,
trishtimin,plagët e marra
edhe sa ... edhe sa....
Janar 2000, Vraniq.

Ag i zbehtë lirie
O fjalamani e fitores,
shpirti ende vlon.
Dhembjen e kemi krenare,
e krenaria na dhemb.

Drita në fund të tunelit,
na i verboi sytë.
E zemra s'i shëroi plagët,
edhe këtë mot.

Agun e lirisë e zbehim,
përditë e më shumë.
Zërin e kemi të mekur,
e nga sytë s'na hiqet loti.

Prangat që shtrëngojnë duart,
na shtrëngojnë edhe në zemra.
E kështu tërhiqemi zvarrë,
nga plagë që ende kullojnë.
Janar 2000 Vraniq

Të burgosurve
Liria do të vije edhe për ju,
o ju, shtrënguar prangash,
këmbë e duar.
Ju, që ende shikoheni,
sy më sy me vdekjen.
Ju, që jeta a vdekja juaj,
varet nga duar të përgjakura kriminelësh,

të këtij fundshekulli.
Ju, pengu dhe çmimi shtesë i lirisë sonë.
Ju, plagë e hapur në trupin tonë.
Janar 2000 Vraniq

Arbëreshës
(In memoriam)
Këtu nuk lae emër.
Lae vetëm mirësi.
Thënkan, se edhe në parajsë ka lulekuqe.
Them, se i quajnë të Arbërit;
Ose lulembese.
O, Jo; I quajkan "Arbëreshe".
Pranverë 2007 Vraniq

Vraniqi
Nëse ju thotë mendja
më quani shqiponjë,
dine që krahë kisha
Maqitevë, Budakovë.

Sy, mendje Reshatin
zemër Zaim trimin,
kështu jam përgjigj
kushtrimit në Kosovë.

Luftën e kem bërë
ashtu siç ka hije,
për liri dhashë djemtë
të jem të lumtur lirie.

Marrim sërish veten
një orë e më parë,
drejt fitoreve të reja
Bashkimit Kombëtarë.
Nëntor 2011, Vraniq.

Dokumentacion i krijuar në raport me mekanizma të sigurisë së shtetit në Ish Jugosllavi

KSA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS PRIZREN
~~DREJTORATI I SHSSH~~
(organi i punëve të brendshme)
Numër 204
Me 22.02. 19 84.

Në bazë të nenit 196 alineja 1 e Ligjit mbi proceduren penale ~~DSHSSH~~ merr

A K T E V E N D I M I N

Kundër Basha Skender profesini student me banesë ne Vraniq Suharreka nr. / i lindur më / 19 25.5. 61 në

CAKTOHET PARABURGIMI.

22.2.1984

Paraburgimi 20.00 do ti llogaritet të ëmërtuarit prej datës prej orës, kur i është hëqur liria.

Kundër këtij aktvendimi i emërtuari ka Prizren jtë ankese kolegjit të gjyqit në Prizren në afat prej 24 orësh nga dorzimi i aktvendimit. Ankesa nuk e ndalë zbatimin e aktvendimit.

A r s y e t i m

Paraburgimi te permendurit i caktohet per araye se egziston dyshimi i themelt seka kryer veper penale nga neni 133.al.1.KP

PERSONI I AUTORIZUAR ZYRTAR,

Hep.nr.25/84

Gjyqtari hetues i Gjykatës së qarkut në Prizren,në lëndën penale kundër Skender Bashkës,nga fsh.Vranig dhe Skender Bytyqit,nga fsh.Kostëre , për shkak të veprës penale të cenimit kontrarevolucionar të Rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ,duke vendosur sipas kërkesës për zbatimin e hetimeve dhe caktimin e paraburgimit të PPQ-ës në Prizren PP.nr.26/84 të datës 24.II.1984,me datën 24.II.1984,muarr këtë

A K T V E N D I M
MBI CAKTIMIN E PARABURGIMIT

Kundër Skender Bashkës i lindur më 25.maj 1961,nga i ati Ibrahim dhe e ëma Feride, i lindur në fsh.Vranig ku edhe tani banon,me kombësi shqiptar - shtetas i RSFJ, student i fakultetit matematiko - natyrore - dega e biologjisë në Prishtinë,

SKENDER BYTYQI, i lindur më 17.qershor 1961,nga i ati Tahir dhe e ëma Zylfije-e lind.Basha, i lindur në fsh.Kostëre, ku edhe tani banon,me kombësi shqiptar - shtetas i RSFJ,student i vitit të dytë i fakultetit të shkencave matematiko-natyrore - dega e biologjisë në Prishtinë,

Për shkak të dyshimit të themelltë:

Se kanë kryer veprën penale të cenimit kontrarevolucionar të Rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ.

Paraburgimi të pandehurëve do ti llogaritet që nga data 22-II.1984,prej momentit kur janë privuar nga liria sipas aktvendimeve të SSB-ës në Prizren - drejtorati i SHSSH në Prizren.

A r ë s y e t i m

Nga denuncimi penal i Sekretarijatit për punë të brendëshme në Prizren - drejtorati i SHSSH me nr. 215 të datës 24. II.1984,si dhe provave gjerë më tani informativisht të mbledhura, rezulton dyshimi i themelltë se të dyshuarët Skender Bashka dhe Skender Bytyqi,kanë kryar veprën penale të cenimit kontrarevolucionar të Rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ.

Në rastin konkret në pyetje është vepra penale e natyrës së rëndë që sipas ligjit mund të shqiptohet dënimi jo ma pak se një vit, e për hirë të shvilliimit normal të procedurës së hetimeve,paraburgimi është i arësyeshëm dhe janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 191 al.2 p.2 të LPP.

Andaj,nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi konformë nenit 192 të LPP.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN,Më 24.VI.1984,Hep.25/84 d. v.
c. p.

Gjyqtari hetues,
Sejdemin Limanid,v.

UDHËZIM JURIDIKË:pala e pakënaqur mund të ankohet ankesë në afat prej 24 orëve prej momentit të marrjes së aktvendimit për Kolegjitn penal të gjykatës së qarkut në Prizren,nëpërmjet të gjyqtarit hetues të kësaj gjykate. Ankesa nuk e ndalë egzekutimin.

Hep.nr.25/84

Gjyqtari hetues i Gjykatës së qarkut në Prizren,në lëndën$ penale kundër Skender Bashës,nga fsh.Vraniq - KK Suharekë dhe Skender Bytyqit,nga fsh.Kostërc - KK Suharekë,për shkak të veprës penale nga neni 114 të LP të RSFJ,duke vendosur sipas kërkesës për zbatimin e hetimeve të PPQ-ës në Prizren PP.nr.26/84 i dt.24. II.1984,më datë 28.II.1984,muarr këtë

A K T V E N D I M
MBI ZBATIMIN E HETIMEVE

Kundër:

1.Skender Bashës,nga i ati Ibrahim dhe e ëma Fetije-e lind. Alijaj,i lindur në fsh.Vraniq - KK Suharekë,i lindur më 25.maj.1961 me kombësi shqiptar - shtetas i RSFJ,me profesion student,i pa martuar,din shkrim dhe lexim,ka të kryer shkollën e mesme,shërbimin ushtarak të rregulluar më Koprivnicë në vitin 1981,mbahet pranë evidencën ushtarake pranë KK Suharekë,i gjendjes së mesme ekonomike,

2.Skender Bytyqit,nga i ati Tahir dhe e ëma Zylfije - e lind Basha,i lindur më 17.VI.1961 në fsh.Kostërc - KK Suharekë,ku edhe tani banon,me kombësi shqiptar-shtetas i RSFJ,me profesion student, i vitit të II-të të fakultetit të biologjisë,shërbimin ushtarak të rregulluar më 1981 në Panqevë ,mbahet në evidencën ushtarake pranë KK Suharekë,i gjendjes së mesme ekonomike,

Për shkak të dyshimi-t të themeltë:

Sepse gjatë vitit 1982 në Prishtinë,kryejnë vepër penale të drejtuar në thyerjen e vëllazërimit e të bashkimit,prishjen e barazisë së kombeve e të kombësive në RSFJ dhe në ndryshimin antikushtetues të rregullimit Federativ të RSFJ,në atë mënyrë që në muajin prill të vitit 1982 para konviktit të studentëve në Prishtinë marrin pjesë në demonstratat kontrarevolucionar,në të cilat përveç tjerash brohorisin parollat armiqësore:"Kosova Republikë" dhe "lironi shokët nga burgu",pastaj nga Xhevat Halili udhëheqës i grupit armiqësor të quajtur"FNÇ"-fronti nacional çlirimtar,marrin pamfletat armiqësore me titull:"populli do ua merr hakun",ë librin armiqësor të Enver Hoxhës me titull"Titistët", revistën "Zëri i Kosovës",të gjitha këto me përmbajtje armiqësore ku në mënyrë direkte sulmohet sistemi i RSFJ dhe i personaliteti i shokut Tito dhe Lidhja e komunistëve të Jugosllavisë,të cilat parolla si dhe librin"Titistët",pasi që i lexojnë ia japin të tjerëve për ti lexuar dhe shpërndar;

kësodore kishin me kryar veprën penale të cenimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ.

A r ë s y e t i m

Prokuroria publike e qarkut në Prizren ka parashtruar kërkesën për zbatimin e hetimeve dhe caktimin e paraburgimit kundër të dyshuarëve Skender Bashës,nga fsh.Vraniq dhe Skender Bytyqit, nga fsh.Kostërc,për shkak të dyshimit të themeltë që kanë kryer veprën penale të cenimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ.

Gjyqtari hetues i kësaj gjykate ka shqyrtuar shkresat e lëndës së bashku me kërkesën për zbatimin e hetimeve dhe ka gjetur:

kërkesa për zbatimin e hetimeve është e bazuar.

./.

Nga kallximi penal i Sekretarijatit për punë të brendëshme në Prizren dega e SHSSH me nr.214 të dt.24.II.1984,procesverbaleve mbi marrjen në pyetje të të pandehurëve pranë kësaj gjykate dhe provave tjera gjerë më tani informativisht të mbledhura,rezulton dyshimi i themelltë se të pandehuritë Skender Basha dhe Skender Bytyqi kanë kryer veprën penale të cenimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ,në kohë,vend dhe mënyrë të njejtë mëm afër të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u ths më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi konformë nenit 159 al.1 lidhur me nenin 157 al.1 të LPP

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN,Më 28.II.1984,Hep.nr.25/84

Gjyqtari hetues,

Ylejman Limani,d.v.

SHËNIM JURIDIK:pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 3 ditësh prej ditës së marrjes,Kolegjit penal të Gjykatës së qarkut në Prizren, e nëpërmes të gjyqtarit hetues të kësaj gjykate.

Hep.nr.25/84

Gjyqtari hetues i Gjykatës së qarkut në Prizren,në lëndën penale kundër Skender Bytyqit dhe Skender Bashës,nga fsh.Vraniq, për shkak të veprës penale nga neni 114 të LP të RSFJ,duke vendosur sipas kërkesës së PPQ-ës në Prizren PP.nr.26/84 të dt.29.II.1984, e në kuptim të nenit 162 al.4 të LPP,më datë 2.mars.1984,mësrr këtë

U R D H Ë R E S Ë

Vazhdimi i marrjes në pyetje të të pandehurëve Skender Bashës,nga fsh.Vraniq - KK Suharekë dhe Skender Bytyqit,nga fsh. Kostërc - KK Suharekë si dhe marrja në pyetje të dëshmitarëve të cilët do të zbulohen gjatë procedurës së hetimeve përkitazi me këtë lëndë,U BESOHEN Sekretarit krahinor për punë të brendëshme - shërbimit të sigurimit shtetëror në Prizren.

Ky organ do të ndërmerr edhe veprime tjera hetuese të cilat do ti zbuloi gjatë marrjes në pyetje të të pandehurëve e që do ti kontribojnë verifikime sa më të plotë të gjendjes faktike.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN,Hep.nr.25/84
Më 2.III.1984

Gjyqtari hetues,
Sylejman Limani

Kp.nr.33/84

Gjykata e qarkut në Prizren,në kolegjin penal të përbërë prej kryetarit të gjykatës Orhan Rekathati-kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve:Safet Goranit dhe Nikolla Vazurës,anëtar,me procesmbajtësin Sadri Rexhaj,praktikant i kësaj gjykate,në lëndën penale kundër të pandehurëve Skender Basha,nga fsh.Vraniq dhe Skender Bytyqit,nga fsh.Kostërc - KK Suharekë,për shkak të veprës penale të cenimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LPJ,duke vendosur sipas propozimit të gjyqtarit hetues të kësaj gjykate Hep.nr 25/84 të dt.22.III.1984,për vazhdimin e paraburgimit,në seancën jo publike të mbajtur më 22.III.1984,muarr këtë

A K T V E N D I M

VAZHDOHET paraburgimi kundër të pandehurëve Skender Bashës dhe Skender Bytyqit,nga Suhareka edhe për 1(një)muaj gjegjësishtë gjerë më 22.prill 1984.

A r ë s y e t i m

Gjyqtari hetues i kësaj gjykate ka bërë propozimin me shkrim Hep.nr.25/84 të dt.22.III.1984 kundër të pand.Skender Bashës, nga fsh.Vraniq dhe Skender Bytyqit,nga fsh.Kostërc - KK Suharekë, për shkak të veprës penale të cenimit kontrarevuliconar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LPJM, që ti vazhdohet paraburgimi edhe për një muaj.

Kolegji penal i kësaj gjykate e shqyrtoi propozimin e gjyqtarit hetues së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe ka gjetur:

propozimi i gjyqtarit hetues është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh dyshimi i themeltë se të pandehuritë Skender Basha dhe Skender Bytyqi ,nga Suharekaë,kanë kryer veprën penale të cenimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LPJ.

Gjithashtu,nga shkresat e lëndës shifet se hetimet nuk janë kryer me qenësre disa veprime iu janë besuar organeve të sigurimit shtetëror.

Prandaj,kolegji penal i kësaj gjykate ka gjetur se ende egzistojnë arësyerat ligjore të parapara nga neni 191 al.2 p.2 të LPP sepse të pandehuritë sikurëse të kishin qenë në liri kishin me penguar zhvillimin normal të hetimeve.

Nga sa u tha më lartë u vendos sipas nenit 191 al.2 p.2 dhe 4 të LPP.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN,Kp.nr.33/84
Më 22.III.1984

Procesmbajtësi,
Sadri Rexhaj,d.v.

Kryetari kolegjit ,
Orhan Rekathati,d.v.

UDHËZIM JURIDIK:kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 3 ditëve prej ditës së marrjes të këtij aktvendimi -Gjykatës supreme të Kosovës në Prishtinë,nëpërmjet të kësaj gjykate.

Kp.nr. 33/84

Gjykata e qarkut në Prizren, në kolegjin penal të përbërë prej kryetarit të gjykatës Orhan Rekathatit - Kryetar i kolegjit dhe të gjyqtarëve Safet Goranit dhe Nikola Vazurës - anëtar me procesmbajtësen Fetije Ademaj, praktikante e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të pandehurve Skrender Bashës, nga fshati Vraniq dhe Skender Bytyqit, nga fshati Kostërc - KK Suharekë për shkak të veprës penale të cënimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ, duke vendosur sipas propozimit të gjyqtarit hetues të kësaj gjykate Hep.nr.25/84 të dt. 20.04.1984, për vazhdimin e paraburgimit në seancën jo publike të mbajtur më 20.04.1984, muarë këtë

A K T V E N D I M

VAZHDOHET paraburgimi kundër të pandehurve Skender Bashës nga fshati Vraniq dhe Skender Bytyqit, nga fshati Kostërc KK Suharekë edhe për 1 (një) muajë gjegjësisht gjerë më 20.05.1984.

A r ë s y e t i m

Gjyqtari hetues i kësaj gjykate ka bërë propozimin me shkrim Hep.nr. 25/84 të dt. 20.04.1984, që kundër të pandehurve Skender Bashës, nga fshati Vraniq dhe Skender Bytyqit, nga fshati Kostërc KK Suharekë, për shkak të veprës penale të cënimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ, që të iu vazhdohet paraburgimi edhe për një muaj.

Kolegji penal i kësaj gjykate shqyrtoi propozimin e gjyqtarit hetues së bashku me shkresat e tjera të lëndës dhe ka gjetur se:

Propozimi i gjyqtarit hetues është i bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedhë dyshimi i bazuar se të pandehurit Skender Basha nga fshati Vraniq dhe Skender Bytyqi, nga fshati Kostërc - KK Suharekë, kanë kryer veprën penale të cënimit kontra revolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ.

Gjithashtu nga shkresat e lëndës shifet se hetimet nuk janë kryer meqenëse disa veprime hetuese i janë besuar organeve të sigurimit shtetrorë, andaj, kolegji penal i kësaj gjykate ka gjetur se ende egzistojnëarësyerat ligjore për vazhdimin e paraburgimit të të pandehurve konformë nenit 191 al.2 p.2 dhe 4 të LPP.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

v/...

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN
KP.nr 33/84 dt. 20.04.1984

Prodesmbajtësja
Fetije Ademaj,d.v.

Kryetari i Kolegjit
Orhan Rekathati,d.v.

UDHËZIME JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 3 ditëve nga dita e marrjes së aktvendimit, Gjykatës Supremetë Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN
OKRUŽNI SUD U PRIZRENU

P. nr. 69/84
K. br.
17-V-1984 god.
Prizren

TË PANDEHURIT
OKRIVLJENOM

Skender Bashca

Me këtë lajmëroheni së Prokuroria e Qarkut në Prizren nën PP. nr. 26/84/ datë 17-V-1984, ka ngritë aktakuzën kundër Juve për veprën penale të cekur në aktakuzë.

Sa ovim se obaveštavate da je Okružno javno tužilaštvo u Prizrenu pod KT. br. ——/—— od —— 19—— godine podigno optužnicu protivu Vas za Krivično delo navedeno u optužnici.

Kundër aktakuzës keni të drejtë të parashtroni kundërshtim në afat prej 8 ditësh prej ditës së marrjes së aktakuzës, nëse konsideroni se aktakuza është pa argumente të mjaftuara ose se kjo gjykatë nuk është kompetente për të gjykuar.

Na optužnicu imate pravo da uložite prigovor u roku od 8 dana od dana prijema optužnice, ako smatrate da je optužnica sa nedovoljnim dokazima ili da ovaj sud nije nadležan za presuđenje.

Kundërshtimin, nëse e parashtron, duhet t'ia dërgoni kësaj gjykate në dy ekzemplarë dhe në të njëjtin afat të lajmëroni këtë gjykatë se kë e keni angazhuar për mbrojtës.

Prigovor treba, ukoliko uložite, da podnesete ovom sudu u dva primerka, i u istom roku obavestite sud koga ste angažovali za branioca.

KRYETARI I GJYKATËS,
PREDSEDNIK SUDA,

Per saktësinë e dërgesës —
Referent i drejt. penal.

Za tačnost otpravka —
Referent kriv. odeljenja,

PROKURORIA PUBLIKE E QARKUT
PP. nr. 26/84
Prizren, 17. o5. 1984

Republika Socialiste e Serbisë - K.S.A. e Kosovës
Социјалистичка Република Србија - С.А.П. Косово
GJYKATA E QARKUT - ОКРУЖНИ СУД
Nr. _____
Бр. 17-V-1984 год.
PRIZREN - ПРИЗРЕН

SM/SM

GJYKATËS SË QARKUT

P R I Z R E N

Në bazë të nenit 45. al. 2 pika 3 të LPP, parashtroj

A K T A K U Z Ë N

Kundër:

SKENDER BASHËS, i lindur më 25. o5. 1961 në fshatin Vraniq, Komuna e Suharekës ku edhe banon nga i ati Ibrahim e ëma Feride e lindur Alijaj, i pamartuar, student, Shqiptar - shtetas i RSFJ, gjindet në paraburgim që nga data 22. o2. 1984;

SKENDER BYTYQIT, i lindur më 17. o6. 1961 nga i ati Tahir, e ëma Zylfije e lindur Basha, në fshatin Kostërc - Komuna e Suharekës, i pamartuar, student, Shqiptar - shtetas i RSFJ, gjindet në paraburgim që nga data 22. o2. 1984;

S E P S E

Gjatë vitit 1982 në Prishtinë, kryejnë veprën penale të drejtuar në thyerjen e vllazërimit e të bashkimit, prishjen e barazisë së kombeve e të kombësive në RSFJ dhe në ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të RSFJ në atë mënyrë që më 1 prill të vitit 1982 para Konviktit të studentëve në Prishtinë marrin pjesë në demostratat kontrarevolucionare në të cilat përveç tjerash brohorisin parollat armiqësore: "Kosova Republikë" dhe "Lironi shokët nga burgu" pastaj nga Xhevat Halili dhe Shemsi Veliu udhëheqës të grupit armiqësor të quajtur "FNÇ" -"Fronti Nacional Çlirimtar" marrin pamfletat armiqësore dhe atë librin armiqësor të Enver Hoxhës me titull "Titistët", revistën "Zëri i Kosovës dhe i akuzuari Skender Basha sjellë edhe pamfletin armiqësor me titull "Populli do ua merrë hakun", të gjitha këto me përmbajtje armiqësore ku në mënyrë direkte sulmohet Sistemi i RSFJ dhe personaliteti i shokut Tito dhe i Lidhjes së komunistave të Jugosllavisë

të cilat pamfleta si dhe librin "Titistët" pasiqë i lexojnë i japin të tjerëve për ti lexuar dhe shpërndarë,-

- kësodore kryejnë veprën penale të cenimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ.

Prandaj:

P R O P O Z O J

Që pran asaj gjykate të caktohet dhe të mbahet seanca kryesore publike e në të cilën duhet ftuar:

- Prokurorin publik të qarkut në Prizren,
- Të akuzuarit Skender Bashën dhe Skender Bytyqin

të cilët gjinden në Burgun e qarkut në Prizren.

Që kundër të akuzuarve Skender Bashkës dheSkender Bytyqit konform nenit 265 al. 1 të LPP të vazhdohet paraburgimi.

A r ë s y e t i m

Pas mbarimit të hetimeve në lëndën penale të të akuzuarve Skender Bashës dhe Skender Bytyqit për shkak të veprës penale të cenimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ është vërtetuar kjo gjendje faktike:

se në këtë çështje penale nuk është kontestuese fakti se këtu të akuzuarit Skender Basha dhe Skender Bytyqi që të dy janë student dhe se gjatë vitit 1982 në Prishtinë kryejnë veprën penale të drejtuar në thyerjen e vllazërimit e të bashkimit prishjen e barazisë së kombeve e të kombësive në RSFJ dhe në ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ në RSFJ në mënyrë që më datën 1 prill 1982 për hirë të përvjetorit të demostratave kontrarevolucionare në Kosovë marrin pjesë në demostratat e organizuara në Prishtinë dhe atë para Konviktit të studentëve ku në këto demostrata këta të dy të akuzuar dhe atë i akuzuari Skender Basha dhe Skender Bytyqi brohorisin parollat armiqësore "Kosova Republikë" dhe "Lironi shokët nga burgu". Pastaj veprimtarin e tyre armiqësore kundër RSFJ e vazhdojnë në mënyrë që nga Xhevat Halili dhe Shemsi Veliu udhëheqës të grupit armiqësor "Fronti Nacional Çlirimtar" marrin pamfletat armiqësore dhe atë librin armiqësor të Enver Hoxhës "Titistët" dhe revistën "Zëri i Kosovës" ndërsa i akuzuari Skender Basha nga fshati i tij Vraniq sjellë edhe pamfletin armiqësor me titull "Populli do ua merrë hakun" të cilat libra revista dhe pamflete që të gjithë këta i lexojnë dhe ia japin njëri tjetrit për ti shpërndarë.

Kjo gjendje e këtillë faktike vërtetohet me pranimin e të akuzuarve Skender Bashës dhe Skender Bytyqit.

Nga mprojtja e të akuzuarit Skender Bashës përveç tjerash vërtetohet fakti se me të vërtetë ai më datën 1 prill 1982 merrë pjesë në demostratat kontrarevolucionare në Prishtinë para Konviktit të studentëve dhe atë më datën 1 prill 1984 ku edhe ky brohorit parollat armiqësore "Kosova Republikë" dhe "Lironi shokët nga burgu", poashtu vërtetohet fakti se duke ecur nëpër fshat në një shtyllë e gjenë pamfletin me titull "Populli do ua merrë hakun"të cilën e sjellë në Prishtinë në banesë ku ia jep të akuzuarit të dytë për ta lexuar si dhe nga ai e merrë edhe librin armiqësor me titull "Titistët" të cilën e lexon dhe revistën "Zëri i Kosovës" të cilën ponjashtu e lexon.

Nga mprojtja e të akuzuarit Skender Bytyqi vërtetohet fakti se edhe ai më datën 1 prill 1982 merrë pjesë në demostratat armiqësore në Prishtinë para Konviktit të studentëve ku brohoritë parollat armiqësore "Kosova Republikë" dhe"Lironi shokët nga burgu" pastaj pasiqë lidhet me udhëheqësin e grupit të ashtuqëajtur "Fronti Nacional Çlirimtar" Xhevat Halili dhe Shemsi Veliu merrë librin "Titistët dhe revistën "Zëri i Kosovës" të cilat i lexon së bashku me pamfletin që e merrë nga i akuzuari Skender Basha "Populli do ua merrë hakun" dhe pas leximit ia jep të tjerëve për ti shpërndarë.

Andaj në veprimet e këtu të dy të akuzuarve pa mëdyshje vërtetohet të gjitha elementet qenësore të veprës penale të cenimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ për të cilën vepër të njëjtit janë juridiko-penalisht përgjegjës.

Propozimi mbi vazhdimin e paraburgimit ndaj të akuzuarve është i arsyeshëm nga shkaku se vepra penale për të cilën ata akuzohen për të njëjtën mund të shqiptohet dënimi me burg prej 10 a më shum vjetëve andaj duke patur parasyesh se me qëndrimin e tyre në liri mund të vijë gjer ke shqetësimi i qytetarëve në masë të konsiderueshme u desht që të bëhet ky propozim e konform nenit 191 al. 2 pika 4 të LPP.

Andaj aktakuza e jonë është e provuar dhe në Ligjë e bazuar.

PROKURORI PUBLIK

Skender Morina

KP.nr.79/84

Gjykata e qarkut në Prizren, sipas kolegjit penal në përbërje prej gjyqëtarëve: Safet Gorani Kryetar, Nikolla Vazura dhe Vejsel Abazi - anëtarë, me procesmbajtësen Luljeta Kolloni, punëtore e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarve Skënder Basha nga fsh. Vraniqë dhe Skënder Bytyqi nga fshati Kostërc, për shkak të veprës penale të cenimit kontrarevulucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ, duke vendosur sipas propozimit mbi vazhdimin e paraburgimit të parashtruar në aktakuzë të PPQ në Prizren PP. nr.26/84 të datës 17.V.1984, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 18.V.1984, muarr këtë

A K T V E N D I M

VAZHDOHET paraburgimi kundër të akuzuarve Skender Basha nga fsh. Vraniqë dhe Skender Bytyqi nga fshati Kostërc, për shkak të veprës penale nga neni 114 të LP të RSFJ edhe për 2 (dy) muaj përfundimisht gjerë më datë 18.korrik 1984.

A r ë s y e t i m

Prokuroria publike e qarkut në Prizren, parashtroj aktakuzën PP.nr.26/84 të datës 17.V.1984 kundër të akuzuarve Skender Bashës nga fshati Vraniqë dhe Skender Bytyqit nga fshati Kostërc, për shkak të veprës penale të cenimit kontrarevulucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ. Një herit propozoj që kundër të akuzuarve konforma nenit 265 al.1 të LPP të vazhdohet paraburgimi.

Kolegji penal i kësaj gjykate pasi e shqyrtoj propozimin e PPQ si dhe shkresat e kësaj lënde penale, gjeti se:

Propozimi është i bazuar.

Në fakt, pasi që të akuzuarve sipas aktakuzës u vehet në barë vepra penale për të cilën sipas ligjit mund t'i ipet dënimi prej lo (dhjetë) vjetë burgim ose dënimi më i rëndë , e duke marrë parasyshë mënyrën e kryerjes së veprës penale, pasojat rrjedhëse dhe rrethanat të tjera rënduese, andaj me qëndrimin eventual të të akuzuarve në liri egziston droja me bazë se kishte mundë të pritej shqetësimi i atillë i qytetarëve, që e bëri të domosdoshëm vazhdimin e paraburgimit edhe për 2 (dy) muaj përfundimisht gjerë më datën 18.korrik 1984.

Me sa u tha më lartë, u vendos sikurse në pjesën urdhënuese të aktvendimit konforma nenit 265 al.1 të LPP lidhur me nenin 191 al.2 p.4 të LPP.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN, P.nr.69/84
Më.18.V.1984.

Procesmbajtësja,
Luljeta Kolloni. d.v.

Kryetari i kolegj
penal-Safet Gorani,d

./.

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesa në afat prej 3 (tre) ditëve , prej ditës së marrjes Kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës në rrishtinë , përmjet të kësaj gjykate.

Kp.nr.66/84

Gjykata e qarkut në Prizren, sipas kolegjit penal në përbërje prej gjyqtarëve Safet Gorani kryetar, Nikolla Vazura dhe Vejsel Abazi, anëtarë, me procesmbajtësen Sheqere Braha, punëtore e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit Skender Basha, nga fshati Vraniq, për shkak të veprës penale të cenimit kundërrrevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP RSFJ, duke vendosur sipas kundërshtimit të të akuzuarit parashtruar kundër aktakuzës së PPQ në Prizren PP.nr.26/84 të dt. 17.05.1984, në seancën e kolegjit më dt.20.06.1984, muarr këtë

A K T V E N D I M

REFUZOHET kundërshtimi i të akutuarit Skender Basha nga fsh. Vraniq, parashtruar kundër aktakuzës të PPQ në Prizren PP.nr.26/84 të dt.17.05.1984 si i pabazuar.

A r ë s y e t i m

Me aktakuzën e PPQ në Prizren PP.nr.26/84 të dt.17.05.1984, të akuzuarit Skender Bashës, nga fshati Vraniq, i vehet në barrë vepra penale e cenimit kundërrrevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP RSFJ.

Kundër aktakuzës s ë përmendur i akuzuari Skender Basha në afat ligjor ka parashtruar ankesën në formë të kundërshtimit me të cilin pos tjerash ka cekur se revistën "Zëri i Kosovës" për të cilën pretendon aktakuza nuk e ka lexuar sepse nuk ka patur në posedim, gjerësa pamfletin "Titistët" e ka patur në dorë por me afat kohe shum të shkurtër për të cilin ka pasë kohë vetëm për ta shfletuar.

Pas vlerësimit të shkresave të kësaj lënde penale, kundërshtimin e të akuzuarit si dhe mendimin e PPQ, kolegji penal gjeti se:

kundërshtimi nuk është i bazuar.

Kundërshtimin e parashtruar i akuzuari kryesisht e përsërit mbrojtjen e vet dhënë gjatë procedurës hetimore se nuk ka patur në dorë revistën "Zëri i Kosovës" përkatësisht për kohë të shkurt vetëm e ka shfletuar pamfletin "Titistët".

Mirëpo, provat dhe faktet të administruara në hetuesi sipas konsiderimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme për paraqitjen e aktakuzës dhe me që kemi të bëjmë mbi provat të cilat në një masë janë njera me tjetrën kontraverze, gjykata pra këto prova ekskluzivisht do ti vlerësoi në seancën kryesore, ndaj kundërshtimi i të akuzuarit u konsiderua si i pabazuar.

./.

Ne sa u tha më lartë, u vendos sikurëse në pjesën urdhënuese
të aktvendimit konform nenit 273 al.1. të LPP.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN
Më 20.06.1984 K.nr.69/84

Procesmbajtësja
Shegere Brahë,d.v.

Kryetar i kolegjit
Sulet Urshi,d.v.

d.
c. p.

Për vërtetësin e dërgesës
За тачност отправка
Shefi i regjistraturës së gjykatës
Управник суд. писарнице,

ГРАДСКИ СУД ПРИЗРЕН

Gjykata e qarkut në Prizren
Okružni sud u Prizrenu

Form. — Obr. 15

20.06.1984 19— godine — vit.

Nr. af. / Posl. br. P.nr.69/84 — 19—

FTESË PËR GJYKIM KRYESOR — POZIV ZA GLAVNI PRETRES

Skender Basha

nga / iz fsh.Vraniq ftohet si / poziva se kao i akuzuar të vijë / da dođe

më datën / dana 2.VII.1984 197— vit. / god. në orë / u 10 — čas. u ovaj sud, soba br. 21

në gjykim kryesor sipas lëndës penale / na glavni pretres po krivičnom predmetu Jush

nga / iz — për shkak të veprës penale / zbog krivičnog dela

111 të LP RSFJ.

Gjykatësi — Sudija,

P.nr.69/84

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e qarkut në Prizren, sipas trupit gjykues në përbërje prej gjykatësit Safet Gorani kryetar,të gjyqtarëve së deleguar Shyhrete Topallit dhe të gjyqtarëve porotë Share Brika, Tahir Hameli dhe Fehredin Sherovi, sekretarë, me procesmbajtësen Sheqere Braha, punëtoren e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarëve Skender Basha nga fshati Vraniç dhe Skender Bytyçi nga fshati Kostërc, për shkak të veprës penale të cenimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP RSFJ duke vendosur sipas aktakuzës së PPQ në Prizren PP.nr.26/84 datë 17.05.1984, në seancën e mbajtur kryesore më datë 2.07.1984, në prezencën e të akuzuarëve, të prokurorit publik Shaban Berisha, të mbrojtësve Hylki Kërtaj dhe Salih Duja avokat nga Prizreni, në të njajtën ditë botërisht e shpalli këtë

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. SKENDER BASHA, student nga fshati Vraniç, i lindur më 1961 nga i ati Ibrahim dhe e ëma Deride - e lindur Alijaj, shqiptar - shtetas i RSFJ, i pa martuar, detyrimin ushtarak e ka kryer, nga gjendja e mesme ekonomike, i pa denuar, ndodhet në paraburgim prej datës 22.02.1984.

2. SKENDER BYTYÇI, student nga fshati Kostërc, i lindur më 1961, nga i ati Tahir dhe e ëma Zylfije - e lindur Basha, shqiptar - shtetas i RSFJ, i pa martuar, detyrimin ushtarak e ka kryer, nga gjendja e mesme ekonomike, i pa denuar, ndodhet në paraburgim prej datës 22.02.1984.

JANË FAJTOR

Gjatë vitit 1982 në Prishtinë kryejnë veprën penale të drejtuar në thyerjen e vëllazërimit e të bashkimit, prishjen e barazisë së kombeve e të kombësive në RSFJ dhe në ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të RSFJ në atë mënyrë që me 1.prill.të vitit 1982 para konviktit të studentëve në Prishtinë marrin pjesë në demostratat kontrarevolucionare në të cilat përveç tjerash brohorasin parullat armiqësore "Kosova republikë", dhe "Lironi shokët nga burgu" pastaj nga Xhevat Halili dhe Shemsi Veliu udhëheqës të grupit armiqësor të quajtur "FNÇ-Fronti nacional çlirimtar" marrin pamfletat armiqësore dhe

./.

atë librin armiqësor të Enver Hoxhës me titull "Titistët", revistën "Zëri i Kosovës" gjerësa i akuzuari Skender Bashë njëllë dhe pamfletin armiqësorë me titull "Populli do ua marr hakun" të gjitha këto me përmbajtje armiqësore ku në mënyrë direkte sulmohet sistemi i RSFJ dhe personaliteti i shokut Tito si dhe i Lidhjes së komunistave të Jugosllavisë, të cilat pamflete si dhe librin "Titistët" pasi që i lexojnë i japin njeri tjetrit për ti lexuar,

-kësो dore kryejnë veprën penale të cenimit kontrarevolucionar të rrëgullimit shoqëror nga neni 114 të LP RSFJ.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 5 al.2, 11,35, 38, 41, 50, al.1. të LP RSFJ dhe të nenit 114 të LP RSFJ, i

G J Y K O J

Të akuzuarin SKENDER BASHËN me denim burgu prej 1 (një) vjetë e 3 (tre) muaje, në të cilin denim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 22.02.1984, gjerësa ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Të akuzuarin SKENDER BYTYÇIN, me denim burgu prej 1 (një) vjetë e 6 (gjashtë) muaje, në të cilin denim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 22.02.1984 gjerësa ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Të akuzuarit obligohen që në mënyrë solidare ti pagojnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së kësaj gjykate si dhëndo njeri ti pagoi paushalin gjyqësor nga nga 500 dinarë, në afatin prej 15 dite, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

A r ë s y e t i m

Prokuroria publike e qarkut në Prizren parashtroi aktakuzën PP.nr.26/84 të datës 17.05.1984, kundër të akuzuarëve Skender Bashës nga fshati Vranig dhe Skender Bytyçit nga fshati Kostarc për shkaktë vepres penale të cenimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP RSFJ.

Në fjalën e fundit zëvendës prokurori publik Shaban Berisha e bëri ndryshimin e rreshtit të fundit të pjesës urdhëruese të aktakuzës duke e hjekur nga e njajta vetëm fjalën "duke e shpërndarë". Përndryshe, ngeli pranë aktakuzës propozoi që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të denohen sipas ligjës duke propozuar që si rrethanë randuese të aplikohet mospendimi

ОПШТИНСКИ СУД ПРИЗРЕН

i të akuzuarëve gjerësa si rrethanë lehtësuese sinqeritetin e tyre gjatë seancës kryesore.

Pas përfundimit të seancës kryesore, gjykata vërtetoi:

i akuzuari Skender Basha pas mbarimit të shkollës së mesme të arsimit të mesëm të orientuar në Suharekë, në vitin shkollor 1980/81 regjistrohet në fakultetin teknik në Prishtinë. Mirëpo, për shkak të kushteve të vështira ekonomike detyrohet që të regjistrohet me korespodencë në fakultetin natyrore-matematikore - dega e biologjisë. Pillimisht ka jetuar në një banesë private ku ka qenë bashkë me të akuzuarin Skender Bytyçin poashtu student i fakultetit të biologjisë. Gjatë asaj kohe njëpërmjet të akuzuarit Skender Bytyçit njifet me Xhevat Halilin poashtu student i të njajtit fakultet me të cilin gjatë një bisede ky i fundit të akuzuarit Skender Bashës propozon që të inkuadrohet si emëtar i grupit "Fronti nacional çlirimtar" mirëpo, i akuzuari refuzon një propozim të këtillë, sikurëse edhe i akuzuari Skender Bytyçi. Ndërkaq, edhe i akuzuari Skender Bytyçi ka patur lidhje të ngushta si shok me Xhevat Halilin dhe me Shemsi Veselin prej të cilit një ditë përpara ndëgjon se me 1.prill.1982 do ë të organizohen demostratat para konviktove të studentëve në Prishtinë.Në këto rrethana i akuzuari Skender Bytyçi për rastin e njofton të akuzuarin Skender Bashën dhe shokët e tjerë të cilët pastaj bashkarisht më datë 1.prill. 1982 bashkohen demostratave të organizuara armiqësore ku të akuzuarit disa herë bëchorasin parullat "Kosova republikë" dhe "Lëroni shokët nga burgu".

Ndërkaq, i akuzuari Skender Basha pamfletin "Populli do ua marr hakun" e cili ka karakter armiqësor dhe botohet në shtetet e jashtëme, pasi që e lexon e shpërndanë duke i dorëzuar për ti lexuar shokët e vet këtu të akuzuarit Skender Bytyçi. Njëherit i akuzuari Skender Bytyçi në muajin prill 1982 përkatësisht në muajin qërshor 1982 nga Xhevat Halili dhe Shemsi Veseli merrë librin "Titistët" të autorit Enver Hoxha dhe revistën "Zëri i Kosovës" këto të dytë me karakter armiqësore dhe pasi që i lexon ia dorëzon poashtu për ti lexuar kto të akuzuarit Skender Bashës në atë mënyrë që librin në pyetje pas 3-4 dite ia rikëthen në poredim të akuzuarit Skender Bytyçit dhe ky pastaj pas rrethë lo dite ia dorëzon Xhevat Halilit dhe Shemsi Velut respektivisht revistën "Zëri i Kosovës" edhe në prezencën e të akuzuarit Skender Bashës paraprakisht i lexojnë dhe pastaj ia këthejnë Xhevat Kalilit dhe Shemsi Vejselit.

Kjo gjendje faktike u vërtetua në bazë të pohimit të të akuzuarëve në procedurën hetimore.

I akuzuari Skender Basha në mbrojtjen e vet në seancën kryesore kryesisht deklaroi se në muajin prill 1982

rastësisht duke u gjendur para konviktit të studentëve në Prishtinë, takohet me të akuzuarin Skender Bytyçin dhe me shokët e tjerë i bashkangjiten grumbullit të studentëve dhe duke ndëgjuar brohoritje parullash edhe ky me atë rast brohorit parullat "Kosova republikë" për të cilin nënkupton se Kosovës duhet ti ipet statusi i republikës në kuadër të Federatës Jugosllave duke konsideruar se vetëm atëherë populli shqiptar do ta ketë të drejtat e barabarta me popujt e tjerë në Jugosllavi. Ndërkaq, pamfletin "Populli do ua marr hakun" pasi rastësisht e gjen në një shtyllë afër fshatit e merrë dhe pastaj ia dorëzon për ta lexuar të akuzuarit Skender Bytyçit të cilin pamflet ky i fundit nuk ia rikëthen. Pohon se nga i akuzuari Skender Bytyçi merrë librin "Titistët" të cilin pasi e shfleton pjesërisht duke e pa edhe fotografinë e autorërit të librit dhe duke e mos kuptuar përmbajtjen eepse e ka mbajtur rreth 5 minuta ia rikëthen të akuzuarit Skender Bytyçit.Njëherit mohoi që të ketë marrë revistën "Zëri i Kosovës".

I akuzuari Skender Bytyçi në mbrojtjen e vet në seancën kryesore kryesisht dekkaroi se rastësisht duke dalur prej ushtrimeve mëmëzore dhe duke kaluar para konviktit të studentëve has në grumbullin e studentëve në demostrata ndëgjon brohoritjen e parullave, bashkangjitet grumbullit dhe brohorit parullat "Kosova republikë", për të cilën nënkupton se è njajta rrjedhë nga gjiri i popullit shqipëar si dhe brohorit parullën "Lironi shokët nga burgu". Pohon se nga Shemsi Veliu pasi e merrë librin "Titistët" nuk e lexon përmbajtjen për shkak të faktit se e ka mbajtur me kohë të shkurtë, e shpërndanë duke i dhanë të akuzuarit Skender Bashës por nga i cili në të njajtën ditë e merrë librin dhe ia rikëthen në posedim Shemsi Veliut. Mohon që pamfletin "Zëri i Kosovës" ta ketë dhanë për ta lexuar të akuzuarit Skender Bashës. Ndërkaq, pohon se prej të akuzuarit Skender Bashkës e ka marrë pamfletin "Populli do ua marr hakun" të cilin në fakt nuk ia rikëthen të akuzuarit Skender Bashës sepse të njajtin pamflet pa dijen e tij e merr Shemsi Veliu.

Gjykata pasi è vlerësoi mbrojtjet e të akuzuarëve në seancën kryesore dhe ato veç e veç dhe në përgjithësi erdhi në konkludim se disa nga mohimet e tyre të pjesërishme në seancën kryesore për rrekhanët esenciale në këtë çështje penale në fakt janë të drejtuara me qëllim që ti zvogëlojnë përgjegjësinë e tyre penale-juridike. Deponimet e tyre në hetuesi sipas konkludimit të kësaj gjykate janë plotësisht identike dhe si të tilla të legjikeshme, prandaj gjykata aktgjykimin e saj è themeloi në mbështetje të këtyre provave të administruara në procedurën hetimore, sepse në procedurën e përmendur të akuzuarit nuk kanë pasë arësye që para gjyqtarit hetues të ngarkojnë vehten për diçka që nuk i përgjigjet të vërtetës sepse në punën e gjyqtarit hetues nuk kanëpatur

АГ ГЈИКА ПРИЗРЕН • ПРИЗРЕН ПАО КОСОВО

asnjë vërejtje.

Gjykata ndaj nuk e miratoi propozimet e mbrojtësve Rylki Kurtaj dheSalih Duja dhe ato sipas të parit në veprimet e të akuzuarit Skender Bashës egzistojnë vetëm tiparet e veprës penale të propagandës armiqësore nga neni 133 al.4 të LP RSFJ, përkatësisht sipas të dytit se në veprimet e të akuzuarit Skender Bytyçit mund të egzistojnë vetëm tiparet e veprës penale të propagandës armiqësore nga neni 133 al.4.ose al.1. të LP RSFJ. Duke vlerësuer trajtimet juridike e mbrojtësve të përmendur me provat e nxjerrura që rrezulltojnë nga deponimet e të akuzuarëve veçanrisht në hetuesi rrezullton fakti pamohesh se se të akuzuarit me dashje kanë marrë pjesë në demostrata armiqësore të datës 1.prill.1982, të organizuara në Prishtinë, me q'rast kanë brohoritur parullat "Kosova republikë" dhe "Lironi shokët nga burgu". Pra, kjo pjesëmarrje e tyre në këto demostrata të cilat për shkak të brohoritjes së parullës "Kosova republikë" që në fakt ka karakterin armiqësor sepse qëllimi është që të bëhet ndryshimi antikushtetues të rregullimit Federativ të RSFJ dhe krahas me te marrja dhe shpërndarja njeri tjetrit të librit "Titistët" të revistës "Do na marrin bakun" dhe të "Zërit të Kosovës" tregon kjartas se në veprimet e të akuzuarëve kemi të bëjmë me të gjitha tiparet qenjësore të veprës penale nga neni 114 të LP RSFJ për kryerjen e së dënës është e mjaftueshme se me veprimin e egzekutimit të të akuzuarëve ka mund që të shkaktohet rrezikshmëria konkrete të objektit të mbrojtjes.Prandaj, gjykata pesi gjeti se në veprimet e të akuzuarëve Skender Bashës dhe Skender Bytyçit egziston përgjegjëshmëria penale të njajtit i shpalli fajtor dhe i gjykoi të akuzuarin Skender Bashën me denim burgu proj 1 vjetë e 3 muajë me të cilin denim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim proj datës 22.o2.1984 si dhe të akuzuarin Skender Bytyçin e gjykoi me denim burgu proj 1 vjetë e 6 muajë në të cilin denim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim proj datës 22.o2.1984, gjerësa ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Gjatë marjes së denimit gjykata pati të gjitha rrethanat në konsiderim të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit sipas nenit 41 LP RSFJ dhe si rrethanë raduese gjeti shkëllën e rrezikshmërisë shoqërore të të akuzuarëve dhe mospendimin e tyre, gjerësa si rrethana lehtësuese muarrr padenueshmërinë e tyre, moshën e tyre relativisht të re,mbajtjen e tyre korekte gjatë seancës kryesore, pohimin e pjesërishëm të veprës penale andaj, e gjykoi me denime të meritusara duke u bindur se edhe me këto denime do të arrihet preventiva speciale dhe ajo gjenerale që parashifet sipas dispozitës së nenit 33 të LP RSFJ.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konformë nenit 98 të LPP.

GJYKATA [illegible] NË PRIZREN
Më dt[illegible] Nr.69/84

Procesmbajtësja
Shoqëro Braha,d.v.

[illegible]retar i trupit gjykues
[illegible]afet Gorani,d.v.

[illegible] Republika e Kosovës
GJYKATA E QARKUT - OKРУЖНИ СУД
PRIZREN - ПРИЗРЕН

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi palaë e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 dite, prej ditës së marrjes - Kolegjit penal të Gjykatës supreme të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

P.nr.69/84

Gjykata e qarkut në Prizren, sipas trupit gjykues në përbërje prej gjykatësit Safet Gorani kryetar, të gjyqtares së deleguar Shyhrete Topalli dhe të gjyqtarëve porotë: Sehare Brika, Tahir Hameli dhe Fahredin Sharovi anëtarë, me procesmbajtësen Sheqere Braha, punëtoren e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarëve Skender Basha nga fshati Vraniq dhe Skender Bytyqi nga fshati Kosterc, për shkak të veprës penale nga neni 114 të LP RSFJ, dukevendosur sipas propozimit të mbrojtësve Salih Duja dhe Hylki Kurtaj mbi ndërprerjen e paraburgimit në të njajtën ditë muarr këtë

A K T V E N D I M

VAZHDOHET paraburgimi kundër të akuzuarëve Skender Basha dhe Skender Bytyqit, për shkak të veprës penale nga neni 114 të LP RSFJ, gjerësa ky aktgjykim të merr formën e prerë.

A r ë s y e t i m

Në seancën e mbajtur kryesore më dt.2.07.1984, kundër të akuzuarëve Skender Basha dhe Skender Bytyqi mbrojtësit e tyre propozuan që kundër të akuzuarëve tu ndërprehet paraburgimi me që kanë pushuar arësyerat për të cilat më parë është caktuar paraburgimi.

Ndaj, trupi gjykues pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës si dhe propozimet e mbrojtëve gjeti se:

propozimet nuk janë të bazuar.

Në fakt, të akuzuarëve u vehet në barrë vepra penale për të cilën sipas ligjës mund ti ipet denimi prej lo vjetë burgim ose denimi më i rendë e duke marrë parasysh pasojat e randa rrjedhëse, rrethanat e tjera si dhe mënyrën e kryerjes së tij ndaj me qëndrimin eventual në liri të të akuzuarëve egziston droja me bazë se do të mund të shkaktohet shqetësimi i atillë i qytetarëve sa që ishte i domosdoshëm që paraburgimi të vazhdohet gjerësa ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Me sa u tha më lartë, është vendosur sikurëse në pjesën urdhënuese të aktvendimit konformë nenit 353 al.6. të LPP lidhur me nenin 191 al.2. p.4. të LPP.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN
Më dt.2.07.1984.P.nr.69/84

Procesmbajtësja
Sheqere Braha,d.v.

Kryetar i trupit gjykues
Safet Gorani,d.v.

UDHËZIME JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi pala e paknaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 3 dite, prej ditës së marrjes, Kolegjit penal të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

PROKURORIA PUBLIKE E QARKUT
PP. nr. 26/84
Prizren, 25. o7. 1984

Republika Socialiste e Serbisë - R.S.S. Kosovë
Социјалистичка Република Србија - С.А.П. Косово
GJYKATA E QARKUT - ОКРУЖНИ СУД
Nr. 69/84
Бр.
25.VII 1984 god.
PRIZREN - ПРИЗРЕН

SHB/SM

GJYKATËS SË QARKUT

P R I Z R E N

P Ë R

GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS

P R I S H T I NË

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së qarkut në Prizren P. nr. 69/84 të datës 2. o7. 1984, me kohë parashtroj

A N K E S Ë N

- Për shkak të vendimit abi dënim - neni 363 pika 4 lidhur me nenin 367 al. 1 të LPP.

A r ë s y e r a t

Me aktakuzën e kësaj prokurorie PP. nr. 26/84 të datës 17 maj 1984 të akuzuarve Skender Bashës dhe Skender Bytyqit i vihet në barë kryerja e veprës penale të cenimit kontrarevolucionar të rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ.

Me aktgjykimin e sulmuar të Gjykatës së qarkut në Prizren të akuzuarit Skender Basha dhe Skender Bytyqi shpallen fajtor për veprën e përmendur penale dhe gjykohen dhe atë i akuzuari Skender Basha me dënim burgimi prej 1 vjeti e 3 muaj ndërsa i akuzuari Skender Bytyqi gjithashtu me dënim burgimi prej 1 vjeti e 6 muaj.

Në gjështjen e përmendur penale gjykata e parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike por gjatë matjes së dënimit nuk i ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtuqë të akuzuarve Skender Basha dhe Skender Bytyqi ~~ë~~i shqipton dënimet e buta me të cilat nuk mund të pritet arijtja e qëllimit të dënimit parasparë sipas dispozitave të Ligjës Penale të RSFJ.

./.

Të akuzuarit Skender Basha dhe Skender Bytyqi gjatë gjithë procedurës nuk pendohen fare për kryerjen e veprës penale por përkundrazi mburen me veprimtarin armiqësore të cilën e kanë kryer kundër RSFJ duke përsëritur disa herë në seancën kryesore se Kosovës duhet ti pranohet Statusi i Republikës, prandaj nuk egziston as rethëna lehtësuese në anën e të akuzuarve të cilën e merrë gjykata e parë - mbajtjen e tyre korekte gjatë seancës kryesore. Sipas mendimit tonë qëndrimi kategorik i të akuzuarve, respektivisht mospendimi i tyre në mënyrë të haptë për veprën e kryer penale paraqet rrethënë rënduese të cilën gjykata e parë vetëm e përmendë në kryereshtin e fundit të aktgjykimit të sulmuar.

Nga vet veprimtaria e tyre armiqësore, se të akuzuarit kanë marrë pjesë në demostratat kontrarevolucionare më 1 prill 1982 para konviktit të studentëve, duke broshoritur parollat e përmendura armiqësore e pastaj sjellin pamfletat dhe librin armiqësor "Titistët" tregon në shkallën e rrezikshmërisë të shtuar shoqërore.

Sikur gjykata e parë të mirrte për bazë rrethënat e përmendura rënduese atëherë me siguri kundër të akuzuarve do të shqiptonte dënimet më të ashpra.

Prandaj,

P R O P O Z O J

Që Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë TA NDRYSHOI aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren P. nr. 69/84 të datës 2 korik 1984 vetëm përkitazi me vendimin mbi dënimin, ashtuqë të akuzuarve Skender Basha dhe Skender Bytyqi ti shqiptoi dënimin e llojit të njëjtë por me kohëzgjatje më të gjatë.

ZËVENDËS PROKUROFI

Shaban Barisha

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN
ОКРУЖНИ СУД У ПРИЗРЕНУ

Gjyqi ..... në ..... Libër evidence nr. Kp-1/85
Kontrolnik

Numri P -69/84 /197 ..... sud u
Broj K
më 3-I- /1985
dana

SKENDER BASHA

(mbiemri e emri ose titulli) — (prezime i ime odnosno naziv) në f.Vraniq

Në bazë t'aktgjykimit të plotfuqishëm të këtij gjyqi më 2-VII-1984
Na osnovu pravnosnažne presude ovog suda od

numër P-nr.69/84 ftoheni që n'afatin 15 ditësh të pagueni për:
broj pozivate se da u roku od dana platite na ime:

1. dënim me të holla — novčane kazne ..... din. r. — n. din. .....
2. shpenzimet të procedurës penale din. r. — n. din. 4.675.-
troškova krivičnog postupka
3. shumë paushall — paušalnog iznosa ..... din. r. — n. din. 500.-
4. sekuestrimi i dobisë pronsore ..... din. r. — n. din. .....
oduzete imovinske koristi

Svega n. din. — Gjithsejt din. r. 5.175

Këtë shumë pagueni simbas çekut të bashkangjitur në cilëndo postë ose dorzoni po n'at afat te ky gjyq me ftesën për vërejtje.

Nëse nuk e pagueni shumën e sipërme n'afatin e përmendun, inkasimi do të bahet me detyrim.

Në rasë mosinkasimi të dënimit me të holla, ky dënim do të zëvendësohet me dënim burgimi.

Ovaj iznos uplatite po priloženoj čekovnoj uplatnici bilo na kojoj pošti ili položiti u istom roku kod ovog suda s pozivom na ovu opomenu.

Ako gornji iznos ne platite u navedenom roku, naplata će se izvršiti prinudnim putem.

U slučaju neplativosti novčane kazne, ova kazna biće zamenjena kaznom zatvora.

Kryetari i trupit gjykues — gjykatsi
Predsednik veća — sudija

Formulari RPGJ nr. 86 (n. 277 al. 3 RPGJ) —
Poziv za plaćanje novčane kazne.
Ftesë për pagimin e dënimit me të holla
Obrazac SP br. 86 (čl. 277. st. 3 SP) —

Ap-kzh-nr.332/84

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Dushan Cvetkoviq, kryetar, Tadej Rodiqi, Aqif Tuhina, Shefqet Bytyçi e Halil Halilaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Osman Arifi, procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarve Skënder Basha dhe Skënder Bytyçi, për shkak të veprës penale cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ, duke vendosur sipas ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve av. Hylki Kurtaj dhe Salih Duja, nga Prizreni si dhe të asaj të prokurorit publik të qarkut, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren P-nr.69/84 datë 2 korrik 1984, më 31 tetor 1984, mori këtë

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesërishëm të ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve Skënder Basha dhe Skënder Bytyçi, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren P-nr.69/84 datë 2 korrik 1984, vetëm përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale, ashtu që kjo gjykatë gjen se në veprimet e të akuzuarve, të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, qëndrojnë elementet e veprës penale, propaganda armiqësore nga neni 133 par. 1 të LP të RSFJ.

Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pandryshuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e kundërshtuar, të Gjykatës së Qarkut në Prizren të akuzuarit Skënder Basha dhe Skënder Bytyçi janë shpallur fajtorë për shkak të veprës penale, cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ dhe janë gjykuar, Skënder Basha me dënim burgimi prej një viti e tre muaj, kurse Skënder Bytyçi me dënim burgimi prej një viti e gjashtë muaj, në të cilin dënim janë shtuar llogaritur koha e

./.

kaluarë në paraburgim prej 22 shkurt 1984. Me të njejtin aktgjykim të akuzuarit janë obligua që solidarisht t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe çdonjëri prej tyre paushalin gjyqësor në shumë prej 5oo dinarësh.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor kanë paraqitur ankesa:

- prokurori publik i qarkut për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarve t'u shqiptohen dënime më të ashpra,

- mbrojtësi i të akuzuarit Skënder Basha, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal e vendimit për dënimin me propozim që aktgjykimi të ndryshohet dhe të konstatohet se në veprimin e këtij të akuzuari qëndrojnë elementet e veprës penale, propaganda armiqësore nga neni 133 par. 4 të LP të RSFJ, për të cilën t'i shqiptohet një dënim më i butë, ose të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim,

- mbrojtësi i të akuzuarit Skënder Bytyçi, për shkak të vërtetimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimi të ndryshohet ashtu që të konstatohet se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elementet e veprës penale propaganda armiqësore nga neni 133 par. 4 të LP të RSFJ, eventualisht nga neni 133 par. 1 të LP RSFJ dhe për këtë vepër t'i shqiptohet një dënim më i butë.

Gjykata Supreme shqyrtoi shkresat e lëndës, studoi aktgjykimin në kuptim të nenit 376 par. 1 të LPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore konstatoi:

Ankesat e mbrojtëse të të akuzuarve Skënder Bahha dhe Skënder Bytyçi janë pjesërisht të bazuara ndërkaq, ajo e prokurorit publik të qarkut nuk është e bazuar.

Edhe pse mbrojtësit e të akuzuarve Skënder Basha dhe Skënder Bytyçi aktgjykimin e shkallës së parë e kundërshtojnë për shkak të vërtetimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike, në fakt as ata në ankesat e paraqitura nuk e mohojnë faktin se të akuzuarit, me 1 prill 1982, para konvikteve të studentëve në Prishtinë, kanë marrë pjesë në demonstratat armiqësore në të cilat janë brohoritur parullat "Kosova Republikë" dhe "Lironi shokët nga burgu", e krejt kësaj me qëllim të shënimit të përvjetorit të demonstratave armiqësore të mbajtura në mars dhe prill të vitit 1981 në Prishtinë e Kosovë.

./.

Poashtu, nuk kontestohet fakti se këta të akuzuar nga Xhevat Halili dhe Shemsi Veseli, udhëheqës të grupit "Fronti Nacional Çlirimtar" kanë marrë pamfletin - librin "Titistët" të Enver Hoxhës dhe se i akuzuari Skënder Basha ka sjellë pamfletin të titulluar "Populli do t'ua merr hakun", krejt këto me përmbajtje armiqësore propaganduese, të cilat i kanë lexuar dhe ia kanë dhënë njëri-tjetrit për lexim. Mbrojtësi avokat Hylki Kurtaj në ankesën e paraqitur përsëritë mbrojtjen e të akuzuarit Skënder Basha se Skënderi revistën armiqësore propagandistike "Zëri i Kosovës" fare nuk e ka pasë në dorë as që e ka lexuar, mirëpo në këtë pjesë gjykata e shkallës së parë i ka besuar të akuzuarit të dytë Skënder Bytyçit i cili në procesverbalin e hetuesisë, datë 27 shkurt 1984, para gjyqtarit hetues ka deklaruar se revistën "Zëri i Kosovës" në banesën e tij e kanë sjellur Xhevat Halili dhe Shemsi Veseli dhe se revista është lexuar në prezencën edhe të akuzuarit Skënder Basha. Për këtë arsye pretendimet në ankesa, përsa i përket bazave ankimore, shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, nuk janë të bazuara.

Mirëpo, duke patur parasysh gjendjen e vërtetuar faktike nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata Supreme konsideron se në rastin konkret gabimisht është aplikuar ligji penal, neni 114 të LP të RSFJ, për çka aktgjykimin e shkallës së parë e ndryshoi duke gjetur se në veprimin e të akuzuarve, më afër të përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, qëndrojnë vetëm elementet e veprës penale propaganda armiqësore nga neni 133 par. 1 të LPK. Respektivisht, vepra penale cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114 të LP të RSFJ, ka karakter subsidiar që do të thotë se aplikimi i kësaj norme mund të bëhet vetëm pasi që vepra e kryer nuk mund të inkorporohet në asnjë përshkrim tjetër ligjor të veprave penale nga kreu XV i LP RSFJ. Në rastin konkret, të akuzuarit Skënder Basha e Skënder Bytyçi, me qëllim të shënimit të njëvjetorit të demonstratave armiqësore në Kosovë, më 1 prill 1982, kanë dalë para konvikteve të studentëve në Prishtinë dhe në atë mënyrë thirrën dhe nxitën për rrëzimin e pushtetit të klasës punëtore dhe të punonjësve, për ndryshimin antikushtetues të rregullimit shoqëror socialist vetëqeverisës dhe për thyerjen e vëllazërimit e të bashkimit dhe të barazisë së kombeve dhe të kombësive në vend. Ata poashtu lexuan dhe shkëmbyen në mes vëdi material armiqësor propagandistik, - "Titistët" të Enver Hoxhës, "Zëri i Kosovës" dhe pamfletin "Shokët do t'ua marrin hakun", të botuara në vend dhe jashtë atdheut nga pjesëtarët e grupeve ekstremiste armiqësore. Për këtë arsye Gjykata Supreme konkludoi se në veprimet e të akuzuarve, si u cek edhe më sipër, qëndrojnë elementet e veprës penale propaganda armiqësore nga neni 133 par. 1 të LP të RSFJ.

Duke kaluar në vlerësimin e vërtetimit për dënimin, Gjykata Supreme edhe pse bëri ndryshimin e titullit juridik dhe të akuzuarit i shpalli fajtorë për veprën penale më të lehtë, konkludoi

RSFJ Krahina Socialiste Autonome e Kosovës Gjykata Supreme PRISHTINË

./.

se dënimet e shqiptuara janë në përpjestim me veprën penale të kryer dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve.
Në ankesat e paraqitura, as prokurori publik i qarkut e as mbrojtësi i të akuzuarit, nuk prezentojnë rrethana të reja që eventualisht kishin me ndikuar në shqiptimin e dënimit më të ashpër apo më të butë. Si del nga shkresat e lëndës demonstratat e përmendura kanë zgjat një kohë relativisht të shkurtër dhe me intervenimin e profesorëve të universitetit demonstracesit janë shpërndaë. Duhet cek se të dy të akuzuarit kanë qenë të thirrur nga Xhevat Halili dhe Shemsi Veseli, udhëheqës të grupit "FNÇ", që të anëtarësohen si pjesëtar të atij grupi armiqësor, mirëpo si njëri ashtu edhe tjetri atë ofertë e kanë refuzuar. Poashtu duhet cek se, prej qershorit të vitit 1982 kur iu ka ra në duar pamfleti "Titistët" dhe materiali tjetër armiqësor propagandistik e deri me paraburgosjen më 22 shkurt 1984, të akuzuarit nuk janë marrë me kurrfarë veprimtarie armiqësore. Ndërkaq, nuk ka vend as për zbutjen e dënimeve si pretendojnë mbrojtësit në ankesat e paraqitura. Në kohën kur pas demonstratave armiqësore të vitit 1981 të mbajtura në Kosovë, e tërë shoqëria është ngazhuar në qetësimin e situatës dhe në menjanimin e pasojave të rënda që ato i shkaktuan në vend e posaçërisht në Kosovë, të akuzuarit si student i ndërmorën veprimet armiqësore. Prandaj dënimet e shqiptuara, të akuzuarit Skënder Basha një vit e tre muaj, kurse Skënder Bkyçi një vit e gjashtë muaj, janë, si u tha edhe më sipër, në përpjestim me peshën e veprës penale të kryer dhe janë të mjaftueshëm që të realizohet qëllimi i dënimit i paraphikuar me nenin 35 të LP të RSFJ.

Nga çka u tha më sipër e në bazë të nenit 387 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË,
Më 31 tetor 1984, Ap-kzh-nr.332/84

Procesmbajtës,
Osman Arifi

Kryetar i kolegjit,
Dushan Cvetkoviq

SOCIALISTIKE SOCIALISTE SOCIALISTE SOCIALIST

RS.S E R B I S Ë
KSA-K O S O V Ë S
SHTËPIA NDËSHKIMORE KORREKTUESE
Nr.
Me 10.12. 1984 vit.
SMREKONICË-VUÇITRNË

Në bazë të nenit 117 të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale Drejtori i SHNK-ës personit të denuar në harmoni me nevojat e riedukimit të tij,disiplinës dhe mundësivë që ekzistojnë në Institucion u cakton llojin e punëve sipas aftësive të tij psiko-fizike dhe shendetësore me ketë :

A K T V E N D I M

I denuari Skender Basha i lindur me 19 61 vit
në Vraniq KK Suharekë vepra P.armiqësore i denuar
15.muaj ~~vjet~~,muajë.
Skandimi i dënimit 19 perqaditja shkollore
Student i biologjisë viti dytë kualifikimi .
Arritur në shkollim të rregullt-korrespodencë(nenvizo)
Caktohët në punë dhe vendin e punës Zdrukthtari

Verifikimi
Vërejtje :

AKTVENDIMI I DORËZOHET :

1x Personit të denuar
1x Në lënden e të denuarit,
1x Njisisë ekonomike,
1x Ref.punë dhe mar.pune.

Drejtori,
Fahri Çuçinca

RS e SËRBISË — KSA e KOSOVËS — CR SRBIJA — SAP KOSOVO
SHTËPIA NDËSHKIMORE-KORREKTUESE - KAZNENO-POPRAVNI DOM
SMREKONICË — SMREKOVNICA
Nr. Br. 395/84
09.05. 1985 viti. god.
Smrekonicë, KK. Vuçitërnë - Smrekovnica, SO. Vučitrn

Në bazë të Nenit 79 të Rregullores mbi ekzekutimin.
Na osnovu Člana 79 o izvršenju kazne i lišenja slob.

Me evidencën me të cilën posedon drejtoria e SHNK-së
Evidencom kojom raspolaže uprava KPD-a izdaje sledeće:
ipet ky:

VËRTETIM - POTVRDA

Me të dilin vërtetohet se i denuari SKENDER BASHA
Kojom se potvrđuje da je osudjenik

nga babai Ibrahim prej Vraniç KK
od otca iz SO

Suharekë Ka qenë në vuajtjen e denimit
Bio je na izdržavanje kazne pri

pranë këtij Institucioni prej 22.02.2. 1984 gjer 09.05.
ovoj Ustanovi od do

1985.

Është i denuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Qarkut
Osudjen po presudi suda u

në Prizren P.nr. 69/84 prej 02.07. 1984
K.br. od

Për këtë Vërtetim nuk paguhen taksa.
Za ovu Potvrdu ne plača se taksa.

Ref. për ekz. e denimeve,
Ref. za izvršenje kazne,

RS SERBISË — SR SRBIJA
KSA E KOSOVËS
SAP KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS — P R I Z R E N —
SKUPŠTINA OPŠTINE

DREJTORATI I SH S SH PRIZREN
(emërtimi i organit të punëve të brendshme) — (naziv organa unutrašnjih poslova)

Numër 1840
Broj

Më 24. 11. 19 85 god.
Datum

Në bazë të nenit 196 alinea 1 e Ligjit mbi procedurën penale — D SH S SH PRIZREN — merr
Na osnovu člana 196. stav 1. Zakona o krivičnom postupku (emërtimi i organit të punëve të brendshme) (naziv organa unutrašnjih poslova) donosi

Aktvendim — Rešenje

Kundër SKENDER Ibrahim BASHËS profesioni student me banesë në
Protiv po zanimanju sa stanom u

Vraniq, rruga numër i lindur më 25.05. 1961
, ulica broj rođenog godine

në Vraniq, KK Suharekë.
u

CAKTOHET PARABURGIM.
ODREĐUJE SE PRITVOR.

Paraburgimi do t'i llogaritet të emërtuarit prej datës 24. 11. 198 5 prej orës 15.00 kur i
Pritvor će se imenovanom računati od godine od časova, kada
është hequr lira.
je lišen slobode.

Kundër këtij aktvendimi i emëruari ka të drejtë ankese kolegjit të gjyqit — të Qarkut —
Protiv ovog rešenja imenovani ima pravo žalbe veću

në Prizren — në afat prej 24 orësh nga dorëzimi i aktvendimit. Ankesa nuk e ndalë zbatimin e aktvendimit.
suda u u roku od 24 časa od predaje rešenja. Žalba ne zadržava izvršenje rešenja.

ARSYETIM — OBRAZLOŽENJE

PARABURGIMI I CAKTOHET TE LARTEPERMENDURIT PASI SE DYSHOHET SE KA BERE VEPER PENALE NGA NENI 133 al.1. LPJ.

PERSONI I AUTORIZUAR ZYRTAR,
OVLAŠĆENO SLUŽBENO LICE,

Vesel Krasniqi

Formulari nr. 13
Obrazac broj 13

BURGU I QARKUT
OKRUŽNI ZATVOR
PRIZREN

Numri — Broj _____

Procesverbal — Zapisnik

Përpiluar me datën / Sastavljen na dan 24-11-1985 në zyren e Burgut të qarkut / 197— god. u kancelariji Okružnog zatvora u Prizren / u orën / u časova _____ sipas lëndës të marrjes së sendeve prej gjykuarit — paraburgosurit / po predmetu oduzimanja stvari od osuđenika — pritvorenika Skender Bashq. i cili me aktgjykimin përmbaruese / koji je izvršnom presudom të gjyqit _____ K nr. _____ suda K br. _____ të datës / od _____ është gjykuar në / osuđen na kaznu denim me burgim në zgjatje prej / zatvora u trajanju od _____, gjegjësisht sipas urdhërit të gjykatësit hetues respektivisht organit të autorizuar / ovlašćenog organa Nr. / Br. _____ të datës / od _____ vehet në paraburgim / stavlja u pritvor odgjegjësisht në burgim hetues. / nosno istražni zatvor.

Prej të gjykuarit, gjegjësisht paraburgosurit — burgosurit në hetim të shenuar më sipër, janë marrë / Od gore navedenog osuđenika, odnosno pritvorenika — istražnog zatvorenika oduzete su na čuvanje ni-
në ruajtje gjë sendet, paratë dhe gjë sendet me vlerë të shenua më posht si vijojnë: / že navedene stvari, novac i vrednosne stvari i to:

1.	146000 dinar tyjeter,	11.	
2.		12.	
3.		13.	
4.		14.	
5.		15.	
6.		16.	
7.		17.	
8.		18.	
9.		19.	
10.		20.	

Përfundimisht me numrin rendor _____ / Zaključeno sa rednim brojem

Nënshkrimi i personit të cilit i janë marrë gjë sendet, / Potpis lica kome su stvari oduzete,

Skender Bashq.

(V. V.)
(M. P.)

Nënshkrimi i organit të autorizuar i cili ka marrë gjë sendet / Potpis ovlašćenog organa koji je primio stvari

Vërtetoj që sot më / Potvrdjujem da sam danas _____ 197— god. primio odnosno kam marrë gjë-
gjësisht dorëzuar gjë sedet të cilët janë numërtuar në këtë procesverbal prej nr. _____ deri nr. _____ / predao stvari koje su pobrojane u ovom zapisnikr od br. _____ do br. _____

Sendet i dorëzoi nëpunësi përgjegjës, / Stvari predao odgovorni službenik,

(V. V.)
(M. P.)

Muerr gjë sendet burgosuri në hetime - paraburgosuri — gjykuari — osuđenik, / Primio stvari istraž. zatv. — pritvorenik

_____

Hepnr.137/85.

Gjyqtari hetues i Gjykatës së qarkut në Prizren, në lëndën e hetimeve kundër Skender Bashës, nga fsh.Vraniq -KK Suharekë, për shkak të veprës penale xxxxxxxx nga neni 136 al.2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ, duke vendosur sipas kërkesës së PPQ në Prizren, PP.nr. 161/85, i datës 27.XI.1985, për caktimin e paraburgimit më datën 27.XI. 1985, muarr këtë

A K T V E N D I M
MBI CAKTIMIN E PARABURGIMIT

Kundër:

SKENDER BASHËS, i lindur më vitin 1961 në fsh.Vraniq - KK Suharekë, nga i ati Ibrahim dhe e ëma Feride, i martuar, shërbimin ushtarak të rregullluar, student, Shqiptar - shtetas i RSFJ,

Për shkak të dyshimit të themeltë, se ka kryer veprën penale bashkim për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ.

Ndaj të njejtit caktohet paraburgimi për 1 (një) muaj, dhe i njejti do të llogaritet që nga data 24.XI.1985, kur është privuar nga liria sipas aktvendimit të drejtoratit të sigurimit shtetëror në Prizren me numër 184o/1 të datës 24.XI.1985.

A r ë s y e t i m

Nga kallëzimi penal i Drejtoratit të sigurimit shtetëror në Prizren me numër 1855 të datës 27.XI.1985, dhe korporadelikteve dhe provave gjerë më tani informativisht të mbledhura, rezullton dyshimi i themeltë se i paudehuri Skender Basha, ka kryer veprën penale bashkim për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ.

Gjyqtari hetues i kësaj gjykate, e ka shqyrtuar kërkesën për caktimin e paraburgimit së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe ka gjetur:

kërkesa është e bazuar.

Me që në pyetje është vepra penale bashkim për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ, për të cilën sipas ligjit është i parapar dënimi jo më pakë se 5 vjet, me qëndrimin e të paudehurit në liri ekziston friga se do të bëjë ndikim në dëshmitarë, në asgjasimin e gjurmave të veprës penale e cila i vehet në ngarkesë dhe për shkak të mënyrës së kryerjes së veprës penale, ekziston friga se do tëvjen deri te shqetësimi i qytetarëve, ashtu që jan plotësuar të tëra kushtet ligjore nga neni 191 al.2 pika 2,3 të LPP xxxxxx

Nga sa u tha më lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimit konform nenit 192 al.1 të LPP.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN, Hep.nr.137/85.
Më datën 27.XI.1985.

Gjyqtari hetues,
Sylejman Limaniq,v..

UDHËZIME JURIDIKE: pala e pakënaqur ka drejtë ankese prej 24 orëve, prej orës së marrjes, Kolegjit penal të Gjykatës së qarkut në Prizren, nëpërmes të gjyqtarit hetues të kësaj gjykate.

Rep.nr.137/85.

Gjyqtari hetues i Gjykatës së qarkut në Prizren, në lëndën e hetimeve kundër të pandehurit Skender Bashës nga fsh.Vraniq, për shkak të veprës penale bashkim për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ, duke vendosur sipas kërkesës të PPQ në Prizren, PP.nr.161/85, të datës 27.XI.1985, përzbatimin e hetimeve me datën 28.XI. 1985, mësrr këtë

A K T V E N D I M
MBI ZBATIMIN E HETIMEVE

Kundër:

Skender Bashës, i lindur më 25.V.1961, në fsh.Vraniq - KK Suharekë, nga i ati Ibrahim dhe e ëma Feride, me kombësi Shqiptar - shtetas i RSFJ, i martuar, me profesion student i fakullteti të biollogjis në Prishtinë, shërbimin ushtarak të rregulluar i dënuar me 1984, 1 vit e tre muaj, burg për shkak të veprimtarisë ë armiqësore ndodhet në paraburgim.-

Për shkak të dyshimit të themeltë.

Sepse që nga fillimi i vitit 1985, gjerë në muajin mëntor të vitit 1985, bëhet anëtar i grupit armiqësor të formuar nga të pandehurit Haki Gashi dhe Gafur Elshani të ashtuquajtur "Komiteti i RRethit për teritorin e Komunës së Suharekës" i cili grup i përket organizatës armiqësore "Organizatës marksiste - Leniniste të Kosovës", para të cilit grupi i paxdehuri Skender Basha e jep"Betimin" para flamurit kombëtar Shqiptar dhe fotografive të Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit dhe Enver Hoxhës, qëllimi i të cilit ka qenë formimi i grupeve tjera armiqësore me përfitimin e antarëve të rinjë e të gjithë këto me qëllim që Kosovës t`i jepet "Statusi i Republikës", pasi që bëhet anëtari i grupit më fjalë merrë pseudonimin e ashtuquajtur "Izet Smaka" dhe disa herë merrë pjesë në mbledhjet e mbajtura ilegale në banesën e Bashkim Mazrekut në Prishtinë si dhe në shtëpinë e Haki Gashit në fshatin Semetishtë Komuna e Suharekës, dhe me rastin e bastisjes në shtëpinë e tij gjinden materialet armiqësore me titull "Eurokomunizmi është antikomunizëm nga Enver Hoxha" dhe revistën armiqësore "Pararoja" organ i Komitetit organizativ të Marksit -Leninistëve të Kosovës, e të gjitha këto me qëllim të thyerjes së vëllazërimit e të bashkimit prishjen e barazisë së kombeve e të kombësive dhe për ndryshimin e antikushtetues të rregullimit federativ të shtetit,-

- Kësodore kryen veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ.

A r ë s y e t i m

Prokuroria publike e qarkut në Prizren, ka bërë kërkesën për zbatimin e hetimeve kundër të dyshuarit Skender Basha me aktin PP.nr 161/85, të datës 27.XI.1985, për shkak të dyshimit të themeltë se ka kryer veprën penale bashkim për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ.

Gjyqtari hetues i kësaj gjykate i ka shqyrtuar shkresat e lëndës së bashku me kërkesën për zbatimin e hetimeve dhe ka gjetur:

kërkesa është e bazuar.

Nga kallximi penal i Drejtoratit të sigurimit shtetëror në Prizren me numër 1855të datës 27.XI.1985, nga korporadeliktët - materijal propagandistik armiqësor "revista Pararoja", "Libri "Eurokomunizmi është antikomunizëm"si dhe procesverbali nga marrja në pyetje të pandehurit pranë kësaj gjykate, dhe provave tjera gjerë më tani informativisht të mbledhura, rezullton dyshimi i themeltë se i pandehuri Skender Basha,ka kryer veprën penale bashkim për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.2 lidhur me nenin

./.

114 të LP të RSFJ.

Nga sa u tha më larë u vendos si më dispozitiv të këtij aktvendimit konform nenit 159 al.1 lidhur me nenin 157 al.1 të LPP.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN, Hep.nr.137/85.
Më datën 28.XI.1985.

Gjykatësi hetues,
Sylejman Limani,d.v.

UDHËZIME JURIDIKE: pala e pakënaqur ka drejtë ankese ndaj këtij aktvendimit, Kolegjit penal të Gjykatës së qarkut në Prizren, nëpërmes të gjyqtarit hetues të kësaj gjykate.

Kp.nr.152/85

Gjykata e qarkut në Prizren, në kolegjin penal të përbërë nga kryetari i gjykatës Masar Pirana, kryetar i kolegjit,dhe gjyqtarëve: Nikolla Vazura dhe Safet Gorani, anëtarë, me procesmbajtsen Elvane Kaçamakun bashkëpunëtore profesionale e kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të pandehurëve Haki Gashit nga fsh.Semetisht dhe Skënder Bashkës nga fsh.Vraniq,për shkak të veprës penale bashkim për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 2 lidhur me al nenin 114 të LP teRSFJ, duke vendosur sipas propozimit me shkrim të gjykatësit hetues të kësaj gjykate mbi vazhdimin e paraburgimi Hep.nr.137/85 të dt.13.XII.1985, në seancën e kolegjit të mbajtur me 22.XII.1985,mori këtë

A K T V E N D I M

VAZHDOHET paraburgimi kundër të pandehurit Skënder Bashës nga fsh.Vraniq edhe për 1(një) muaj gjeggjësisht gjerë më 24 janar 1986.

A r ë s y e t i m

Prané gjykatës së qarkut në Prizren, janë duke u zbatuar hetimet kundër të pandehurëve Haki Bashit nga fsh.Semetisht dhe Skënder Bashkës nga fsh.Vraniq, për shkak të veprës penale bashkim për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ.

Gjykatësi hetues i kësaj gjykate me shkresën Hep.nr.137/85 të dt.13.XII.1985, kapropozuar që tëvazhdohet paraburgimi kundër të pandehurit Skënder Bashës nga fsh. Vzaniq edhe për një muaj, gjegjsisht gjerë më 24.janar 1986.

Kolegji penal i kësaj gjykate , pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlrësimit të propozimit të gjykatsit hetues të kësaj gjykate, ka gjetur se:

- propozimi është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës si dhe nga faktet e deponuara gjerë më tani rrjedhë dyshimi i bazuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale bashkim për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 2 lidhur me nenin 114 të LP RSFJ.

Me qenë se hetimet në këtë lëndë penale ende nuk kanë mund të kryhen, nga se nuk është ndëgjuar i pandehuri Gafur Elshani i cili si bashkëekzekutor e kakryer veprën penale me të pandehurit Haki Gashin dhe Skënder Bashën,e për shkak të mënyrë të kryerjes së veprës penale, pasojave dhe rrethanave të tjera në të cilat janë kryer ekzistojnë friga se me qëndrimin e të pandehuritnë liri do të përsrit vepra të njejta penale, si dhe se për këto vepra mund të shqiptohet dënimi me burg deri më lo vjetë e për shkak të zhvillimit normal të procedurës penale, kolegji i kësaj gjykate gjeti se ekzistojnë të gjitha arsyerat ligjore për vazëdimin e paraburgimit.

./.

Nga sa u tha më larta u vendos sikurse në shqiptim të këtij aktvendimi, në bazë të nenit 197 al. 2 të LPP lidhur me nenin 191 al. 2 pika 2 dhe 4 të LPP.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN, më dt.22.XII.1985

Kp.nr.152/85

Gjyqtari i kolegjit
Procesmbajtësja, Pirane,d.v.
Elvane Kaçamaku,d.v.

Shefi i regjistraturës
Sheft i registraturës se gjykatës

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, me afat prej 3 ditësh, pas marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

Kp.nr.11/86

Gjykata e qarkut në Prizren, sipas kolegjit penal në përbërje prej kryetarit të gjykatës Masar Piranës - kryetar dhe gjyqtarëve: Nikolla Vazura e Fadil Nushi, anëtarë, me procesmbajtësen Elvane Kaqamakun, bashkëpunëtore profesionale e kësaj gjykate, në lëndën penale të të pandehurit Skender Bashës, nga fshati Vraniq, për shkak të veprës penale bashkim për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.2. lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ, duke vendosur sipas propozimit me shkrim të gjyqtarit hetues të kësaj gjykate mbi vazhdimin e paraburgimit Hep.nr.137/85 të dt.22.01.1986, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22.01.1986, morri këtë

A K T V E N D I M

VAZHDOHET paraburgimi kundër të pandehurit Skender Bashës, nga fshati Vraniq edhe për 1 (një) muaj gjegjësisht gjerë më 24.02.1986.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e formës së prerë të Gjykatësit hetues të kësaj gjykate Hep.nr.137/85 të dt.28.XI.1985, janë duke u zbatuar hetimet kundër Skender Bashës, për shkak të veprës penale bashkim për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.2.lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ dhe ndaj të pandehurit i është caktuar paraburgimi në kuptim të nenit 191 al.2.p.2. dhe 4. të LPP.

Gjyqtari hetues me propozimin e tij ka cekur se hetimet në këtë lëndë nuk kanë mund të kryhen sepse nuk është marrë në pyetje i pandehuri Gafurr Elshani i cili ka kryer veprën penale si bashkegzekutor me të pandehurit Skender Bashën dhe Haki Gashin, dhenjëherit PPQ në Prizren ka propozuar që veprimet hetuese ti besohen Shërbimit të sigurimit shtetëror në Prizren për vazhdimin e marrjes në pyetje të të pandehurëve dhe dëshmitarëve tjerë, e që këto veprime gjyqtari hetues ia ka besuar Shërbimit të sigurimit shtetëror në Prizren të cilat ende nuk i ka kryar.

Kolegji penal i Gjykatës së qarkut në Prizren vlerësoi propozimin e gjyqtarit hetues, shkresat e lëndës dhe konkludoi se:

propozimi është i bazuar.

Në fakt, meqenëse gjerë më tani procedura hetimore ende nuk ka përfunduar, për arësye se ende nuk është marrë në pyetje i pandehuri Gafurr Elshani i cili ka kryer veprën penale si bashkegzekutor me të pandehurin Skender Bashën si dhe disa veprime u janë besuar Shërbimit të sigurimit shtetëror, egzistojnë akoma arësyerat për të cilat ka qenë i caktuar paraburgimi, respektivisht egziston friga se me qendrimin e të pandehurit në liri do të përsëris vepra të njejta penale, si dhe duke marrë parasysh faktin se për veprën penale në fjalë mund të parashifet denimi me burg në kohëzgjatje gjerë më 15 vjetë e duke marrë parasysh peshën e veprës penale, pasojat dhe rrethanat të tjera ndaj me qëndrimin në liri të të

./.

pandehurit objektivisht kishte mund të pritet shqetësimi i atillë i qytetarëve, e për shkak të zhvillimit normal të procedurës hetimore, kolegjiti i kësaj gjykate gjeti se egzistojnë të gjitha arsyerat lë-gjore për vazhdimin e paraburgimit.

Nga sa u tha më lartë u vendos sikurëse në shqiptim të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 197 al.2. të LPP, lidhur me nenin 191 al.2.p.2. dhe 4. të LPP.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN
Më 22.05.1986.Kp.nr.11/86

Procesmbajtësja
Elvane Kaçamaku,d.v.

Kryetar i kolegjit
Perparim Ademaj,d.v.

UDHËZIME PER ANKESË [illegible]
[illegible] mund
të ushtrohet ankesë në afat prej [illegible] ditësh [illegible] ditë nga marrja e këtij akt-
vendimi, nëpërmjet gë kësaj gjykate [illegible] Gjykatës Supreme [illegible] Kosovës në
Prishtinë.

Pn-Kr-nr.47/86

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - Kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Tadej Rodiqi, kryetar, Imer Gorani dhe Desanka-Lilakiçeviq-Millasheviq, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Shemsi Uka, procesmbajtës, në lëndën penale kundër të pandehurëve Haki Gashi dhe Skender Basha, për veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 2 lidhur me nenin 114 të Ligjit Penal të RSF të Jugosllavisë, duke vendosur për propozimin e gjyqtarit hetues të Gjykatës së Qarkut në Prizren Hep-nr.137/85 datë 12 shkurt 1986, në seancën e mbajtur më 14 shkurt 1986, mori këtë

A K T V E N D I M

Vazhdohet paraburgimi kundër të pandehurëve edhe për 1 (një) muaj, ashtu që sipas këtij aktvendimi mund t'iu zgjasë Haki Gashit deri më 15 mars 1986 dhe Skender Bashës deri më 24 mars 1986.

A r s y e t i m i

Gjyqtari hetues i Gjykatës së Qarkut në Prizren, ka propozuar që Gjykata Supreme t'ia vazhdojë paraburgimin të pandëhurëve edhe për 1 (një) muaj, duke theksuar se bazat për të cilat është caktuar paraburgimi ende ekzistojnë.

Gjykata Supreme shqyrtoi shkresat e kësaj lënde, vlerësoi thëniet e gjyqtarit hetues dhe konstatoi:

Propozimi është i bazuar.

Nga shkresat e kësaj lënde rezulton se kundër të pandehurëve janë duke u zhvilluar hetimet për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer vepër penale - bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ.

Megenëse në këtë çështje penale hetimet nuk kanë përfunduar ende, pasi që nuk kanë mundur të sigurohen provat materiale-përkatëse si dhe të dëgjohen edhe disa dëshmitarë, me lëshimin e tyre që të mbrohen në liri ekziston frika e bazuar

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë - R.S.F.J. - Socialistike Autonome e Kosovës - SR Serbia - S.A.K. Kosovës
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PRISHTINË

se mund t'i pengojë hetimet duke ndikuar në dëshmitarë. Përveç kësaj, pasi në rastin konkret kemi të bëjmë me veprën penale për të cilën sipas Ligjit mund të jepet dënimi me burgu prej 1o vjetësh ose dënim më i rëndë, e për shkak të mënyrës së kryerjes, pasojave dhe rrethanave tjera të veprës penale mund të vijë deri te një shqetësim i atillë i qytetarëve që për zhvillimin dhe përfundimin e papengesa të procedurës penale është i domosdoshëm vazhdimi i paraburgimit sipas dispozitave të nenit 191 al. 2 pika 2 dhe 4 të LPP, ashtu siç ka kërkuar edhe gjyqtari hetues me propozimin e përmendur.

Nga çka u tha më lart, e në bazë të nenit 197 al. 2 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Më 14 shkurt 1986, Pn-Kr-nr.47/86

Procesmbajtësi,
Shemsi Uka,d.v.

Kryetar i kolegjit,
Tadej Rodiqi,d.v.

Kosovës - CP SFRJ
VRHOVNI SUD KOSOVA
SUPREME COURT
ПРИШТИНА
PRISHTINE
1977

ГАЧИОСТ ОТПРАВКА
Shkrimtarce Gjyqësore

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN
OKRUŽNI SUD U PRIZRENU

P. nr. — 6/86
K. br.

28-II — 1986 g.
Prizren

TË PANDEHURIT Skender Basha.
OKRIVLJENOM

Me këtë lajmëroheni se Prokuroria e qarkut në Prizren nën PP. nr. 161/85 datë ——— 27-II — 1986, ka ngritur aktakuzën kundër Juve për veprën penale të cekur në aktakuzë.

Sa ovim se obaveštavate da je Okružno javno tužilaštvo u Prizrenu pod KT. br ———/——— od ——— 19—— godine podignuo optužnicu protivu Vas za Krivično delo navedeno u optužnici.

Këndër aktakuzës keni të drejtë të parashtroni kundërshtim ñë afat prej 8 ditësh prej ditës së marrjes së aktakuzës, nëse konsideroni se aktakuza është pa argumente të mjaftuara ose se kjo gjykatë nuk është kompetente për të gjykuar.

Na optužnicu imate pravo da uložite prigovor u roku od 8 dana od dana prijema optužnice, ako smatrate da je optužnica sa nedovoljnim dokazima ili da ovaj sud nije nadležan za presuđenje.

Kundërshtimin, nëse e parashtron, duhet t'ia dërgoni kësaj gjykate në dy ekzemplarë dhe në të njejtin afat të lajmëroni këtë gjykatë se kë e keni angazhuar për mbrojtës.

Prigovor treba, ukoliko uložite, da podnesete ovom sudu u dva primerka, i u istom roku obavestite sud koga ste angažovali za branioca.

KRYETARI I GJYKATËS
PREDSEDNIK SUDA,
Naser Prizaneqi, dr.

Për saktësinë e dërgesës —
Referenti i drejt. penal,
Za tačnost otpravka-
Referent kriv. odeljenja,
Hanvete Goranci

PROKURORIRA PUBLIKE EQARKUT
PP.nr. 161/85
Prizren, 27.02.1986

Republika Socialiste e Serbisë - K.S.A. e Kosovës
Социјалистичка Република Србија - С.А.П. Косово
GJYKATA E QARKUT - ОКРУЖНИ СУД
Nr. 9 / Бр. 6/86
28.02.1986 19 — год.
PRIZREN - ПРИЗРЕН

SHB/EH

GJYKATËS SË QARKUT

PRIZREN

Në bazë të nenit 45 par.2 pika 3 të LPP, parashtroj

A K T AK U Z Ë N

Kundër:

1. HAKI GASHIT, i lindur më 26 maj 1958 në fshatin Semetishtë-Komuna e Suharekës, nga i ati Bajram dhe e ëma Hanife, e lindur Bytyqi, shqiptar-shtetas i RSFJ, i arësimuar-apsolvent i mjekësisë, i pamartuar, obligimin ushtarak të parregulluar, mbahet në evidencën ushtarake pranë organit kompetent të KK Suharekë, i gjendjes së mesme ekonomike,ipadënuar , nuk ndiqet për veprat tjera penale, gjindet në paraburgim prej datës 15.11.1985, dhe

2. SKENDER BASHËS, i lindur më 25.05.1961 në fshatin Vrniqëxë, ku edhe jeton, nga i ati Ibrahim dhe e ëma Feride-e lindur Alijaj, shqiptar-shtetas i RSFJ, me profesion student, i pamartuar, pa fëmi, obligimin ushtarak të rregulluar në vitin 1981 në Koprivnicë, mbahet në evidencën ushtarake pranë KK Suharekë, i gjendjes së varfër ekonomike, i gjykuar në vitin 1984 për veprën penale të propagandës armiqësore nga neni 133 par.1 të LP të RSFJ dhe dënimin me burgim e ka vuajt, nuk ndiqet për veprat tjera penale gjindet në paraburgim prej datës 24.11.1985.

S E P S E

I. I akuzueri HAKI GASHI:

1. Më 11 mars 1982 në Prishtinë, në shenjë të solidarizimit të demostratave armiqësore në Kosovë, bojkoton mësimin -ligjëratat pranë fakultetit të mjekësisë në Prishtinë,prej datës 1 qërshor të vitit 1985 deri në fillim të muajit nëntor 1985 në Prishtinë, në fshatrat Reçanë dhe Semetishtë-Komuna e Suharekës, bashkë me të pandehurin Gafur Elshanin i cili gjindetnë arati, krijonë grupin armiqësor në formë të treshit i quajtur "Komiteti i rrethit" për teritorin e Komunës së Suharekës i cili grup i përket organizatës armiqësore "Marksiste Leniniste",në atë mënyrë që nëpërmjet Bashkim Mazrekut nga Prizreni formon grupin e përmendur ku ka qenë prezentë edhe i pandehuri Gafur Elsheni dhe ate në muajin qershor të vitit 1985 në banesën e Bashkim Mazrekut,

./.

ndërsa në muajin korrik të vitit të përmendur ku ka qenë ëdhe i akuzuari Skender Basha e në banesën e Bashkrim Mazrekut në Prishtinë i akuzuari Haki Gashi caktohet për sekretar ekzekutiv të grupit të përmendur ndërsa i pandehuri Gafur Elshani si sekretar politik e për këtë mbajnë edhe mbledhje ku i akuzuari Haki e ka mbajtë procesverbalin e në mesin e korrikut të vitit të njejtë në fshatin Reçanë i akuzuari Haki bashkë me të pandehurin Gafur Elshanin dhe të akuzuarin Skender Bashën betohen se e kanë formuar grupin e përmendur armiqësor me ç'rast e lexojnë planë programin dhe statutin e grupit dhe pamfletin armiqësor"pararoja" i shtypur nga organizata armiqësore "Marksiste Leniniste" të Kosovës dhe librin armiqësor të Enver Hoxhës "Eurokomunizmi është antikomunizëm", pastaj në kusdër të grupit mbanë edhe disa mbledhje në fshatin Reçanë dhe Semetishtë ku përveç materialit të përmendur armiqësor lexon revistën armiqësore "Zëri i Kosovës"; në çdo mbledhjetë mbajtur shqyrtohet çështja e aktivitetit armiqësor kundër RSFJ dhe atë formimi i grupeve tjera armiqësore, përpunimi i materialit propagandistik armiqësor me qëllim t ë thyerrjes së vllazërimit e të bashkimit, prishjen e barazisë së kombëve e të kombësive dhe për ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të RSFJ e cila shprehet me shpallejen e Kosovës Republikë dhe me bashkimin e të gjitha trevave të banuara me shqiptar,-

- kësodore kryen veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ.

II. I akuzuari SKENDER BASHA:

1. Në kohë,mënyrë dhe vend sikurse në shqiptimin nën I/1 të kësaj aktakuzë bëhet anëtar i grupit armiqësor në formë të troshit i quajtur "Komiteti i Krethit" për teritorin e Komunës së Suharekës i cili grup i përket organizatës armiqësore "Markiste Leniniste të Kosovës", në atëmënyrë që me ftesën e të akuzuarit Haki Gashit dhe të pandehurit Gafur Elshanit pranon të jetë anëtar i grupit të përmendur armiqësor, në atë mënyrë që sipas ftesës së tyremerrë pjesë në disa mbledhje të grupit të përmendur dhe atë në fshatrat Reçanë dhe Semetishtë si dhe në Prishtinë në banesën e Bashkrim Mazrekut, merrë pjesë në përpunimin e planë programit dhe të satutit të grupit të pëmrmendur, lexon materialin propagandistik armiqësor dhe atë pamfletin "Pararoja" i shtypur nga organizata armiqësore "Marksiste Leniniste të Kosovës",librin armiqësor të Enver Hoxhës "Eurokomunizmi është antikomunizëm"dhe revistën armiqësore "Zëri i Kosovës" i shtypur nga grupi i përmendur armiqësor të gjitha këto me qëllim të thyerrjes së vllazërimit e të bashkrimit, prishjen e barazisë së kombëve e të kombësive dhe për ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të RSFJ e cila shprehet me shpallejn e Kosovës Republikë dhe bashkrimin e të gjitha trevave të banuara me Shqiptar?.-

- kësodore kryen veprën penale bbashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 par.2 lidhur me nenin 114 të LP t ë RSFJ.

./.

Andaj: P R O P O Z O J

Pranë asaj gjykate të caktohet dhe të mbahet seanca kryesore publike në të cilën duhet ftuar:

- prokurorin publik të qarkut në Prizren,
- të akuzuarit Haki Gashin dhe Skender Bashën, që gjinden në paraburgim pranë burgut të qarkut në Prizren,
- kundër të akuzuarve Haki Gashit dhe Skender Bashës të vazhdohet paraburgimi konformë të nenit 191 par. 2 pika 4 të LPP.

Në procedurën e provave të bëhet shiqimi në pamfletin "Pararoja" dhe në librin Eurokomunizmi është Komunizëm.

A r s y e t i m

Pas përfundimit të hetimeve në lëndën penale të akuzuarve Haki Gashit dhe Skender Bashës, për shkak të veprës penale bashkim për veprimtari armiqësore nga neni 136 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ, është vërtetuar gjendja faktike e cila vijon:

i akuzuari Haki Gashi është njoftuar me të akuzuarin Skender Bashën nëpërmjet të pandehurit Gafur Elshanit, ndërsa me të pandehurin Gafur Elshanin është njohur edhe më parë nga se ka qenë shok i klasës në shkollën e mesme në Suharekë. Ideja për formimin e grupit armiqësore nga i akuzuari Haki Gashi është lindur në muajin prill kur i akuzuari Haki shkonte Bashkim Mazreku nga Prizreni i cili gjithashtu është anëtar i organizatës armiqësore "Marksiste Leniniste të Kosovës" dhe ndaj të cilit gjithashtu në zhvillimin e sipër është procedura penale pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë. Pasi që nga Bashkim Mazreku mëson për aktivitetin armiqësore të organizatës së përmendur për këtë e njofton edhe te pandehuri Gafur Elshanin. Që të dytë pranojnë të formojnë grupin e përmendur armiqësore në formë të treshit i quajtur "Komiteti i rrethit" për teritorin e Komunës së Suharekës. Pas kësaj e thirrin edhe të akuzuarin Skender Bashën i cili pranon të bëhet anëtar i grupit të përmendur dhe me një rast që të tretë shkojnë në Prishtinë mësojnë për planë programin dhe statutin e grupit e pastaj mbajnë disa mbledhje dhe atë në fshatin Reganë dhe Semetishtë ku nëmes tjerash japin betimin se e kanë formuar grupin e përmendur. Në këto mbledhje shqyrtojnë aktivitetin armiqësor të grupit, inkuadrimin e anëtarëve të rinjë dhe formimin e grupeve të tjera në formë të treshit, lexojnë materialin propagandistik dhe atë revistën "Pararoja" e shtypur nga grupi armiqësor (organi i lidhjes Marksiste Leniniste të Kosovës, librin e Enver Hoxhës "Eurokomunizmi është komunizëm" dhe revistën armiqësore "Zëri i Kosovës" i shtupur nga grupi i përmendur armiqësor. Qëllimi i grupit ka qenë që Kosovës ti njihet statusi i Republikës dhe bashkimi i të gjitha trojeve të banuara me shqiptarë. Në mbledhjen e parë me ç rast e kanë dhënë betimin i akuzuari Haki Gashi caktohet për sekretar ekzekutiv i komitetit të rrethit ndërsa i pandehuri Gafur Elshani si sekretar politik i komitetit të përmendur.

./.

Gjendja e këtillë faktike vërtetohet me prenimin e tërësishëm të të akuzuarve .

Të akuzuarit prenjësë e kanë formuar grupin e përmendurarmiqësor dhe ate i akuzuari Heki Gashi ndërsa i akuzuari Skender Basha është bërë anëtar i grupit të përmendur me ftesën e të akuzuarit Heki. Shtojnë se kanë mbajtur disa mbledhje dhe në njenën prej tyre,respektivisht në mbledhjen e parë kanë dhënë betimin me ç`rast i akuzuari Heki është caktuar si sekretar ekzekutiv i grupit të përmendur ndërsa i pandehuri Gafur si sekretar politik i grupit të përmendur ndërsa i akuzuari Skender Basha ka mbajtur procesverbalin nga mbledhja dhe se në mbledhjet tjera kanë shqyrtuar aktivitetin armiqësor kundër RSFJ përkitazi me prenimin e anëtarëve të rinjë dhe formimin e grupeve të tjera në formë të treshit. Në këto mbledhje kanë përpunuar planë programin dhe statutin e grupit dhe kanë lexuar materialin e përmendur propagandistik armiqësor dhe se qëllimi i tyre ka qenë që Kosova të shpallet Republikë dhe bashkimi i të gjitha trojeve që janë të banuara me shqiptar.

Nga kjo del kjartë se të akuzuarit kanë patur për qëllim thyerrjen e vllazërimit e të bashkrimit,prishjen e barazisë së kombeve e të kombësive dhe për ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të RSFJ.

Prandaj, në veprimet e të akuzuarve dhe atë të akuzuarit Heki Gashit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ ndërsa në veprimet e të akuzuarit Skender Bashës elementet qenësore të veprës penale nga neni 136 par.2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ.

Propozimi për vazhdimin e paraburgimit është i arësyeshëm nga se kemi të bëjmë me veprën penale për të cilën sipas Ligjës mund të ipet dënimi i burgimit prej lo vjet dhe dënimi më i rëndë dhe nga mënyra e kryerjes, të pasojavetë veprës dhe rrethanave të tjera ka ardhur deri te shqetësimi i atillë i qytetarëve ashtu që për zhvillimin e papenguar të procedurës penale dhe për sigurinë e njerëzve paraburgimi është i pat~~tje~~jër, konformë ~~me~~ nenit 191 par.2 pika 4 të LPP.

Nga sa u tha më lartë, aktakuza është e provuar dhe në Ligj e bazuar.

për PROKURORI PUBLIK
Skender Morina

Gjykata e qarkut në Prizren, në kolegjin penal të përbërë nga kryetari i gjyqtës Masar Pirana, si kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve: Fadil Nushit e Nikolla Vazurës, anëtarë të kolegjit, me proçesmbajtësen Shegere Braha, punëtoren e kësaj gjykate, në lëndën penale e të akuzuarit Haki Gashit, nga fshati Semetisht - KK Suharekës, për shkak të veprës penale të bashkimit për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.1.lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ dhe të akuzuarit Skender Basha, nga fshati Vraniq - KK Suharekë, për shkak të veprës penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.2.lidhur me nenin 114 të LPtë RSFJ, duke shqyrtuar propozimin e PPQ në Prizren për vazhdimin e paraburgimit kundër të akuzuarëve si dhe duke shqyrtuar arësyen ligjore për vazhdimin e paraburgimit ndaj të akuzuarëve, me datën 1.05.1986, morri këtë

A K T V E N D I M

Kundër të akuzuarëve Haki Gashit dhe Skender Bashës, VAZHDOHET paraburgimi i caktuar me aktvendimin e gjyqtarit hetues të kësaj gjykate Hep.nr.137/85 të datës 27.XI.1985 si dhe të aktvendimit Hep.nr.137/85 të datës 18.XI.1985, edhe për 2 (dy) muajë, ashtuqë të akuzuarit Skender Bashës i vazhdohet paraburgimi deri më 1.05.1986, ndërsa ndaj të akuzuarit Haki Gashit poashtu edhe për 2 (dy) muajë, deri më 1.05.1986.

A r s y e t i m i

Kundër të akuzuarit Haki Gashit i cili gjindet në paraburgim prokurori publik i qarkut ka bërë aktakuzë për shkak të veprës penale të bashkimit për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.1.lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ. Poashtu aktakuza është ngrit edhe kundër të akuzuarit Skender Bashës i cili poashtu gjindet në paraburgim për shkak të veprës penale të bashkimit për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.2.lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ.

Në aktakuzën e prokurorit publik të qarkut është vuar propozimi që kundër të akuzuarëve Haki Gashit dhe Skender Bashës të vazhdohet paraburgimi në kuptim të nenit 191 al.2.p.4.të LPP.

Gjykata e qarkut i shqyrtoi shkresat e kësaj lënde penale, vlerësoi propozimin në aktakuzë të PPQ në Prizren për vazhdimin e paraburgimit dhe konstatoi:

propozimi është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrezullton se kundër të akuzuarëve është ngrit aktakuza për shkak të veprës penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.1. e 2. lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ.

Pasi është fjala për veprën penale të natyrës së rëndë, me lëshimin e të akuzuarëve në liri egziston friga e bazuar se mund ti pengojnë hetimet nga arësyeja se mund të vjen deri te shqetësimi i qytetarëve, pasi në rastin konkret kemi të bëjmë me veprën penale për të cilën sipas ligjit mund të ipet denimi me

./.

burgim prej lo vjetësh ose denimi më i rëndë, e për shkak të mënyrës së kryerjes, pasojave dhe rrethanave tjera të veprës penale mund të vijë deri te një shqetësim i atillë i qytetarëve sa që për zhvillimin dhe përfundimin pa pengesa të procedurës penale është i domosdoshëm vazhdimi i pareburgimit kundër të akuzuarëve e në bazë të nenit 191 al.2.p.4. të LPP, ashtu sikurse ka propozuar edhe prokurori publik i qarkut.

Në bazë të asaj që u tha më lartë u vendos sikurse në dispozitivin e këtij aktvendimi e në pajtim me nenin 265 al.1. lidhur me nenin 191 al.2.p.4. të LPP.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN,
Më 1.05.1986, P.nr.46/86

Procesmbajtësja
Sheqere Braha,d.v.

Kryetar i kolegjit
Hasan Piranad.v.

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej 3 ditëve, Gjykatës Suprreme të Kosovës, Prishtinë, pas marrjes të këtij aktvendimi, përmjet të kësaj gjykate.

За чистост отправка
Секретар

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN
OKRUŽNI SUD U PRIZRENU

P.nr.6/86

VI- Agj. nr.
SU. br. ——————/——

më
dana ——3.03.—————— 19-86 g.
Prizren

Gjykata e Qarkut në Prizren në lëndën penale kundër
Okružni sud u Prizrenu, u krivičnom predmetu protiv Skender Bashë, fsh. Vraniq

nga
iz —————— për vepër penale 136/2 -114 të LP nga neni RSFJ al. KP, merr këtë
zbog krivičnog dela ——————— iz člana ——— st. —— KZ, donosi sledeće

AKTVENDIM — REŠENJE

Konformë nenit 70 të KPP të pandehurit i caktohet për mbrojtës sipas detyrës zyrtare
U smislu člana 70 ZKP okrivljenom se postavlja za branioca po službenoj dužnosti

avokati
advokat HYLKI KURTAJ nga
iz Prizreni

pasi që i pandehuri nuk e ka angazhuar avokatin, kurse fjala është për vepër penale ———— nga
neni 136/2 - 114 të LP RSFJ al. ——— KP, për ça i pandehuri pranë Gjykatës së Qarkut medoemos duhet të ketë mbrojtës.

pošto okrivljeni nije uzeo branioca, a u pitanju je kriv. delo ———— iz čl. ——— st. ——— KZ
za koje okrivljeni pred Okružnim sudom mora imati branioca.

Nëse i pandehuri rishtas e angazhon mbrojtësin tjetër, është i obliguar që mbi atë ta lajmërojë gjykatën, e cila mbrojtësin e emëruar ka për ta shkarkuar prej detyrës së mbrojtjes.

Ukoliko okrivljeni naknadno uzme sebi drugog branioca, dužan je o tome obavestiti sud koji će postavljenog branioca razrešiti branilačke dužnosti.

KRYETARI I GJYKATËS,
PREDSEDNIK SUDA,
Masar Piraha

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN
OKRUŽNI SUD U PRIZRENU

Form. — Obr. 15

31.03.1986 19—— godine

Nr. af. P.nr.9/86
Posl. br. —— 19——

FTESË PËR GJYKIM KRYESOR — POZIV ZA GLAVNI PRETRES

Skender Basha

nga fsh.Vraniq ftohet si i akuzuar të vijë
iz ——— poziva se kao ——— da dođe

me datën 8.04.1986 në ora 10 në këtë gjykatë, dhoma nr. 20
dana ——— 198— god. u ——— čas. u ovaj sud, soba br. ———

në gjykim kryesor sipas lëndës penale Jusha
na glavni pretres po krivičnom predmetu

nga ——— për shkak të veprës penale
iz ——— zbog krivičnog dela

136/1,2-114 LPJ

Gjykatësi — Sudija,

P.nr. 6/86

Gjykata e qarkut në Prizren, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqëtari Fadil Nushi, kryetar i trupit gjykues, gjyqëtarit të deleguar Durak Fandaj dhe gjyqëtarëve porotë Bllagoje Todosiq, Tahir Hameli dhe Nuhi Hoxha, anëtarë të trupit, me proçesmbajtsen Brita Çakallin, puntore e kësaj gjykate, në lendën penale e të akuzuarit Haki Gashit, nga fshati Semetisht - KK e Suharekës, për shkak të veprës penale Bashkimi pr veprimtari armiqësore nga neni 136 sl.1 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ, dhe të akuzuarëve Skender Basha dhe Sadik Halitjaha, për shkak të veprës penale të bashkimit për veprimtari armiqësore nga neni 136 sl. 2 lidhur me enenin 114 të LP të RSFJ, sipas aktakuzës të Prokurorit publik të qarkut PP.nr. 161/85 të dt. 27.II.1986 dhe 14/86 të dt. 4.III.1986, pas mbajtjes të seancës kryesore me datën 9 prill 1986 morri këtë

A K T V E N D I M

I. Kundër të akuzuarëve Haki Gashit, nga fshati Semetisht - KK e Suharekës dhe të akuzuarit Skender Basha, nga fshati Vreniq - KK e Suharekës VAZHDOHET paraburgimi i caktuar në bazë të aktvendimit të gjyqëtarit hetues Hep.nr. 137/85 të datës 15.XI.1985 dhe të aktvendimit Hep.nr. 137/85 të dt. 27. nëntor 1985, deri më plotëfuqishmerinë e aktgjykimit të kësaj gjykate P.nr. 6/86.

II. Ndaj të akuzuarit ~~Skender Bashës~~ Sadik Halitjahës nga fshati Mushtishtë -KK e Suharekës NDËRPRESHET paraburgimi i caktuar në bazë të aktvendimit të gjyqtarit hetues të kësaj gjykte Hep.nr. 15/86 të dt. 24.I.1986 dhe i përmekduri duhet të lëshohet menjëherë në liri.

A r s y e t i m i

Gjykata e qarkut në Prizren duke vendosur sipas aktakuzave të lartëpërmendura të PP-në Prizren me datën 8 dhe 9. prill 1986 e kam mbajtë seancën kryesore lidhur me përgjegjësinë penale e të akuzuarëve Haki Gashit, Skender Bashës dhe Sadik Halitjahës.

Pas mbajtjes të seancës kryesoere Gjykata e qarkut në Prizren të akuzuarin Haki Gashin e shpalli fajtor për shkak të veprës penale të bashkimit për veprimtari armiqësore nga neni 136 sl.1 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ ndërsa të akuzuarin Skender Bashën e shpalli fajtor për shkak të veprës penale të bashkimit për veprimtari armiqsore nga neni 136 sl. 2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ.

Të akuz. Sadik Halitjahën gjykata e liroi nga akuza në mungesë të provave.

Në bazë të nenit 353 sl.1 të LPP gjykata nëse të akuzuarin e gjykon me denim burgimi prej 5 vjetëve ose me një denim më të rëndë patjetër duhet t'ia cakton paraburgimin,

Të akuz. Skender Bashës gjykata ia vazhdoi paraburgimin në bazë të nenit 353 al. 2 lidhur me nenin 291 al. 3 dhe 4 të LPP sepse me ngeljen e të akuzuarit në liri ekziston droja se do ti përsërit veprat penale gjegjësisht veprën penale për të cilën është shpallur fajtor. Nga ana tjetër në rastin konkret është fjala për veprën penale për të cilën mund të shqiptohet denimi me burg në kohëzgjatje prej 1.- deri në 15 vjet, e me ngeljen e të akuzuarit në liri mund të vjen deri te shqetësimi i qytetarëve andaj u tregua e nevojshme që edhe ndaj tij të vazhdohet paraburgimi deri në plotëfuqishmerinë e këtij aktgjykimi.

Të akuz. Sadik Halitjahës gjykata ia ndërpreu paraburgimin në bazë të nenit 353 al. 3 të LPP sepse i akuzuari Sadik Halitjaha është liruar nga akuza.

Andaj në bazë të asaj që u tha më lartë u vendos sikurse në shqiptimin e këtij aktvendimi.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN; P.nr. 6/86
më 9.prill 1986.

Procesmbajtëse,
Drita Çakalli,d.v.

Kryetari i trupit gjykues,
Fadil Nushi,d.v.

UDHËZIMI MBI TË DREJTËN E ANKESËS;

Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej 3 ditësh Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, pas marrjes të aktvendimit, nëpërmjet të kësajgjykate.

marrë me 27.11.1986.
Sarajevë.

Ap.nr.226/86

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës - kolegji i përbërë nga gjyqëtarët: Durmish Koçinaj, kryetar, Riza Loci, Ognjan Todiq, Miftar Jasiqi dhe Suad Crnovërshanin, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores Sadije Njekiqi, procesmbajtëse, në çështjen penale të të akuzuarëve: Haki Gashi, nga fsh.Semetisht, për shkak të veprës penale, bashkimi për veprimtari armiqësore, parashikuar nga neni 136 par.1 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ, Skendër Basha nga f. Vraniq, dhe Sadik Halitjaha, nga f. Mushitisht, për shkak të veprës penale, bashkimi për veprimtari armiqësore parashikuar nga neni 136 par.2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ, duke vendosur lidhur me ankesat: e Prokurorit Publik të Qarkut në Prizren, të të akuzuarve Haki Gashi dhe Skender Basha si dhe atyre të mbrojtësve të tyrë, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së qarkut në Prizren, P.nr.6/86 datë 9.prill.1986, në seancën e mbajtur në pajtim me dispozitën e nenit 371 të LPP, më datë 17 shtator 1986, mori këtë

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit Skender Basha si dhe ajo e mbrojtësit të tij, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së qarkut në Prizren, P.nr.6/86 datë 9.prill.1986, në pjesën që ka të bëjë me këtë të të akuzuar vërtetohet.

II. Me aprovimin e pjesëshëm të ankesave të të akuzuarit Haki Gashi dhe atyre të mbrojtësve të tij, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.6/86 datë 9.prill.1986, vetëm përkitazi me vendimin për dënimin ashtu që të akuzuarit Haki Gashi, për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, Gjykata Supreme e gjykon me 5 (pesë) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj burgimi, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej 15 nëntor 1985 e tutje si dhe dënimi i vuajtur në kohëzgjatje prej 60 ditësh sipas aktvendimit të gjykatës Komunale për kundërvajtje në Prishtinë nr.reg.867/82 datë 10 maj 1982.

III. Me aprovimin e ankesës së Prokurorit publik të Qarkut në Prizren, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr.6/86 datë 9.prill.1986, në pjesën që ka të bëjë me të akuzuarin Sadik Hlitjaha, prishet dhe çështja i kthehet në këtë pjesë të njejtës gjykatë për rigjykim.

A r s y e t i m i

./.

Gjykata e Qarkut në Prizren me aktgjykimin P.nr.6/86 datë 9 prill 1986, i ka shpallur fajtor: të akuzuarin Haki Gashi për veprën penale, bashkimi për veprimtari armiqësore, parashikuar me nenin 136 par.1 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ dhe të akuzuarin Skender Basha për veprën penale, bashkimi për veprimtari armiqësore parashikuar me nenin 136 par.2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ dhe për këto vepra i ka gjykuar: të akuzuarit Haki Gashi me 7 vjet burgimi ndërsa të akuzuarin Skender Basha me 4 vjet burgimi. Në dënimet e shqiptuara këtyre të akuzuarve iu ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim. I ka obliguar që në mënyrë solidare t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale, ndërsa secili veç e veç me emër të paushali gjyqësor nga 1.000 dinarë.

Me të njejtin aktgjykimi i akuzuari Sadik Halitjaha në pajtim me dispozitën e nenit 350 pika 3 të LPP është liruar nga akuza për veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore, parashikuar me nenin 136 par.2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ.

Kundër këtij aktgjykimi kanë paraqitur ankesa:

- prokurori publik i qarkut në Prizren, vetëm ndaj pjesës liruese, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme aktgjykimin e kundërshtuar në pjesën liruese që ka të bëjë me të akuzuarin Sadik Halitjaha të prishë dhe çështjen, në këtë pjesë, t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë për rigjykim;

- I akuzuari Haki Gashi, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktikë me propozim që Gjykata Supreme aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoi ashtu që këtij të akuzuari t'i shqiptoi një dënim me të butë;

- I akuzuari Skender Basha, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për dënimin (del nga përmbajtja e ankesës), me propozim që aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që t'i shqiptohet një dënim më i butë;

- Mbrojtësi i të akuzuarit Haki Gashi, av. Xhafer Kasemi dhe Fazli Balaj, (ankesa të veçanta) për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, duke propozuar, dhe atë: av. Xhafer Kasemi që aktgjykimi i kundërshtuar të prishet dhe çështja t'i kthehet të njejtës gjykatë për rigjykim, ose të ndryshohet përkitazi me vendimin për dënimin, ashtuqë këtij të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë, ndërkaq av. Fazli Balaj, që aktgjykimi i kundërshtuar të prishet dhe çështja t'i kthehet të njejtës gjykatë për rigjykim, ose të ndryshohet përkitazi me cilësimin juridike të veprës ashtuqë në veprimet e këtij të akuzuari Gjykata Supreme të gjej se ekzistojnë elementet e veprës penale bashkimi për të kryer vepra penale të caktuara me ligjin federativ, parashikuar me nenin 254 par.1 të LP të RSFJ dhe për këtë vepër t'i shqiptoi një dënim më të butë, ose ta ndryshoi përkitazi me vendimin për dënimin ashtuqë këtij të akuzuari t'i shqiptoi një dënim më të butë; dhe

- mbrojtësi i të akuzuarit Skendër Basha av. Hylki Kurtaj, për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që Gjykata Supreme, aktgjykimin e kundërshtuar të ndryshoi dhe këtij të akuzuari t'i shqiptoi një dënim me të butë.

Në ankesën e Prokurorit publik të qarkut në Prizren përgjegje ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit Sadik Halitjaha, av. Engjëll Çeta, me propozim që ankesa e prokurorit publik të Qarkut në Prizren të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i kundërshtuar të vërtetohet në pjesën që ka të bëjë me këtë të akuzuar.

Sipas kërkesës së mbrojtësve të të akuzuarve, Gjykata Supreme seancën e kolegjit e mbajti në pajtim me nenin 371 të LPP në të cilën mbrojtësi Nazli Balaj, sqaroi pretendimet ankimore dhe ngeli pranë propozimeve të bëra në ankesë. Në seancë edhe pse të lajmëruar nuk muanrën pjesë i akuzuari Sadik Halitjaha dhe mbrojtësi i tij av. Engjel Çeta. I akuzuari Haki Gashi i cili gjindet në paraburgim u informua për mbrojtjen e seancës, por kolegji nuk e pa të nevojshme prezancën e tij në seancë.

Prokurori publik krehinor, me shkrim ka propozuar që ankesa e prokurorit publik të qarkut në Prizren të aprovohet, ndërsa ankesa e të akuzuarve Haki Gashi dhe Skender Basha si dhe ato të mbrojtësve të tyre të refuzohet si të pabazuara.

Gjykata Supreme i shqyrroti shkresat e lëndës, aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 376 par.1 të LPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në ankesa, konstatoi:

Ankesa e të akuzuarit Skender Basha si dhe ajo e mbrojtësit të tij nuk janë të bazuara. Pjesëshëm të bazuara janë ankesat e të akuzuarit Haki Gashi dhe të mbrojtësve të tij, ndërsa e bazuar është ankesa e prokurorit publik të qarkut në Prizren.

Për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale aktgjykimi i shkallës së parë e kundërshtojnë mbrojtësit e të akuzuarit Haki Gashi. Në arsyetimin e kësaj baze ankimore av. Xhafer Kasemi pretendon se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i pakutpueshëm dhe kontr dikton me arsyerat e dhëna, sepse derisa në dispozitiv theksohet se i akuzuari Haki Gashi është kryesues i grupti armiqësor, në arsyetim thuhet se i është bashkuar, është bërë anëtarë i grupit armiqësor të Gafur Elshanit,. Ndërkaq, mbrojtësi Nazli Balaj konsideron se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i pakuptueshëm, nukjanë paraqitur janë në kundërshtim me shkresat e lëndës, pra përmbanë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 364 par.1 pika 11 të LPP, tëcilat sipas ankesës qëndrojnë në këto rrethana: nga dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar nuk të shifet se kur dhe ku u formua grupi armiqësor por cekat "prej muajit maj e deri në fillim të muajit nëntor të vitit 1985 në Prishtinë dhe në fshatrat Reçan dhe Semetisht..." ndërsa i akuzuari Haki Gashi është paraburgos me 15 shtator 1985, mëtej, në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar nuk i panë arsyera se

në çmënyrë dhe me çfarë mjete do ta realizoi grupi armiqsor qëllimin e vet që KSA e Kosovës ta fitoi statusin e Republikës. Me në fund në aktgjykim e kundërshtuar nuk cekët se çfarë ka armiqsore ndaj vendit tonë në pamfletin "Pararoja" dhe Librin "Eurokomunizmi është antikomunizëm".

Gjykata Supreme gjen se këto pretendime ankimore nuk janë të bazuara. Nuk është kontestuese, e këtë e pohon edhe vet i akuzuari Haki Gashi, se prej muajit maj të vjetit 1985, në bisedat që ka pasur me bashkim Mazrekun dhe të pandehurin Gafur Elshanin, i cili momentalisht është në arrati, kanë vendosur që të formojnë grupin armiqësor të cilin e kanë pagëzuar "komiteti i rrethit për territorin e komunës së Suharekës" i cili ka qenë dhe ka vepruar në kuadër të organizatës armiqësore "komiteti organizativ i marksist-Leninistve të Kosovës" dhe për këtë qëllim më parë janë njoftuar me statutin dhe plan programin e kësaj organizate armiqësore me pamfletin armiqësor "Pararoja" - organ i komitetit organizativ të marksist-leninistve të Kosovës, kanë angazhuar edhe të akuzuarin Skender Basha dhe në muajin gusht të vitit 1985 në fshatin Semetisht kanë bërë edhe betimin edhe atë të akuzuarit Haki Gashi, Skender Basha dhe i pandehuri Gafur Elshani. Pra, nuk është kontestuese se i akuzuari Haki Gashi dhe i pandehuri Gafur Elshani kanë formuar grupin armiqësor të lartëpërmendur. Pra, me padyshim është vërtetuar se është krijuar grupi armiqësor në kuptim të par.1 të nenit 136 të LP të RSFJ, dhe se i akuzuari Haki Gashi atë e ka krijuar së bashku me Gafur Elshanin. Qëllimi dhe detyrat e grupit të përmendur armiqësor rrezulltojnë nga statuti dhe planprogrami i organizatës armiqësore "Komiteti organizativ i marksist-leninistve të Kosovës". Aty janë qartë të përcaktuara qëllimet, menyra e veprimit dhe detyrat e kësaj organizate armiqësore. Nga shkresat e lëndës del se i akuzuari Haki Gashi është paraburgosur me 15 nëntor 1985, mirëpo, në aktgjykimin e kundërshtuar është bërë një lëshim i lidhur me këtë sepse përdori sa në dispozitiv në pjesën ku janë përshkruar shënimet personale të akuzuarit Haki Gashi cekë se i njejti në paraburgim është prej 15 nëntor 1985, ndërsa në pjesën ku i është shqiptuar dënimi dhe llogaritja e paraburgimit i është llogaritur prej 15 shtatorit 1985, pra fjala është për gabim qartë teknik.
Në shkresa të lëndës gjinden edhe pamfleti armiqësor"Pararoja" - organi i komitetit organizativ të marksist-leninistve të Kosovës përmbajtja e të cilit është me karakter armiqësor ndaj vendit tonë, e poashtu edhe libri, "Eurokomunizmi është antikomunizëm" të Enver Hoxhës.

Nga arsyerat e sipërpërmendura nuk janë arprovuar pretendimet ankimore në këtë bazë, sepse në anën tjetër gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar ka dhënë arsyera të mjaftuara, përkitzai me të akuzuarin Haki Gashi dhe Skender Basha, mbi të gjitha faktet dhe rrethanat relevante të kësaj çështjeje penale, në mënyrë të çartë janë paraqitur veprimet inkriminuese të të akuzuarit Haki Gashi dhe Skender Basha, drejt janë vlerësuar provat e administurara dhe janë dhënë arsyera mbi vlerësimin juridik të veprave. Nuk as shkelje tjera sesenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kjo Gjykat i vërenë detyrimisht në pajtim të nenit 376 par.1 të LPP.

./.

Në arsyetimin e bazave ankimore,vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal, brojtësi khafer Kasëmi, pretendon se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka konkluduar se i akuzuari Haki Gashi është krijues i grupit armiqësor, duke konsideruar si krijues është Gafur Elshani, ndërsa i akuzuari Haki Gashi vetëm është bërë anëtarë i grupit të përmendur. Pra, pretendon se i akuzuari Haki Gashi nuk është krijues i grupit, prandaj edhe gabimisht është aplikuar ndaj tij ligji penal, duke pretenduar se në veprimet inkriminuese të këtij të akuzuari përmbahen elementet e veprës penale parashikuar nga neni 136 par.2 të LP të RSFJ.

Pëashtu edhe i akuzuari Haki Gashi në ankesë pretendon se është dashtë që veprimet e tia inkriminuese të cilësohet sipas par.2 të nenit 136 të LP të RSFJ, meqë edhe më parë ka ekzistuar organizata armiqësore e marksist-leninistëve të Kosovës. Ndërkaq, mbrojtësi Fazli Balaj, pretendon se i akuzuari Haki Gashi nuk mund të konsiderohet si krijues i grupit armiqësor, por eventualisht si pjestar i grupit për të kryer veprën penale të caktuar me ligjin federativ të parashikuar me nenin 254 par.1 të LP të RSFJ.

Gjykata Supreme konstatoi se edhe këto pretendime ankimore, nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të padyshimit ka vërtetuar se i akuzuari Haki Gashi është krijues i grupit armiqësor "Komiteti i rrethit për territorin e komunes së Suharekës", dhe as me ankesa me asgjë një gjendje e tillë nuk vihet në dyshim, për çka edhe është bërë fjalë me lartë-lidhur me pretendimet ankimore për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Në anën tjetër nuk është kontestuese se më parë ka ekzistuar organizata armiqësore e marksist-leninistve të Kosovës, por poashtu është jokontestuese se i akuzuari Haki Gashi së bashku me Gafur Elshanin kanë krijuar grupin e lartëpërmendur armiqësor për çfarë pas parapregaditjeve kanë bërë kontituimin, kanë caktuar detyrat-postet, me ç'rast i akuzuari Haki është caktuar sekretar ekzekutiv i grupit, kanë caktuar pseudonimet, për veprimtari konspirative, dhe kanë bërë betimin. Prandaj, me padyshim është vërtetuar se i akuzuari Haki Gashi ishte krijues i grupit në kuptim të par.1 të nenit 136 të LP të RSFJ i cili për platformë të veprimtarisë ka pasur statutin dhe plan programin e organizatës armiqësore të marksist-leninistëve të Kosovës.

Të gjitha këto rrethana vërtetojnë se në veprimet inkriminuese të të akuzuarit Haki Gashi ekziston vepra penale e parashikuar me nenin 136 par.1 të LP të RSFJ.

I akuzuari Skender Basha, me ankesë aktgjykimin e shkallës së parë e kundërshton, për sakak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo nga përmbajtja e saj, del se në seancë e kundërshton, vetëm për vendimin për dënimin për

çka do të bëhet fjalë më poshtë. Mirëpo, edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka gjetur se në veprimet inkriminuese të këtij të akuzuari, të përshkruara me hollësisht në dispozitivn nën II të aktgjykimit të kundërshtuar, qëndrojnë elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor,.

Duke shqyrtuar çështjen përktisai me vendimin për dënimin Gjykata Supreme gjen se pretendimet ankimore të të akuzuarit Skender Basha dhe mbrojtësit të tij nuk janë të bazuara, sepse dënimi i shqiptuar këtij të akuzuari është caktuar drejt dhe në harmoni me rrezikshmërinë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të këtij të akuzuari. Me rastin e caktimit të dënimit këtij të akuzuari Gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar dhe ika marrë në konsiderim të gjitha rrethanat, të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i ultë ose më i lartë, siç parashikon dispozita e nenit 41 të LP të RSFJ. Rrethanat lehtësuese të cilat ceken në ankesa gjykata e shkallës së parë i ka njohur dhe i ka vlerësuar. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, nuk ka vend që të akuzuarit Skender Basha t'i shqipohet dënimi më i butë, siç pa bazë cekët në ankesa, sepse nga shkresat e lëndës del se i njejti edhe më parë ka qenë i gjykuar për të njejtat vepra penale, pra është recidivist special. prandej me dënim të butë nuk do të arrihej qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 33 të LP të RSFJ.

Mdërkaq, sa i përket të akuzuarit Haki Gashi, në këtë bazë pretendimet ankimore janë të bazuara, sepse Gjykata Supreme konsideron se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë këtij të akuzuari është i ashpër sepse, përveç rrethanës lehtësuese së është moshës së re, të cilën e ka vërtetuar dhe vlerësuar edhe gjykata e shkallës së parë, ekzistojnë edhe rrethana tjera lehtësuese siç janë: ranimi i plotë i veprës penale në të gjitha fazat e procedurës penale, se më parë nuk ka qenë i gjykuar, se veprimtaria e tij armiqësore ka qenë në interval të shkurtër kohor, e cila është përmbajtur vetëm në veprimtari verbale dhe takime. Nga ana tjetër rrethanat rënduese të cilat i ka konstatuar gjykata e shkallës së parë nuk qëndrojnë, sepse ato paraqesin elemente të veprës penale për të cilëm ky i akuzuar është shpallur fajor. Prandaj, duke i pazur parasysh këto rrethana Gjykata Supreme ka gjetur se ka vend që këtij të akuzuari t'i shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i cili është harmoni me rrezikshmërinë shoqërore të veprës së kryer penale, dhe me shkallën e përgjegjësisë penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 33 të LP të RSFJ. Poashtu, është i bazuar, pretendimi ankimor se këtij të akuzuari është dashtë që në dënimin e shqiptuar t'i llogaritet edhe dënimi i vuajtur sipas aktvendimit të gjykatës komunale për kundërvajtje, në pajtim me nenin 50 par.1 të LP të RSFJ, sepse ky privim nga liria ka të bëjë me veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Nga arsyerat e cekura më lartë për të akuzuarin Skender Basha dhe Haki Gashi e në pajtim me dispozitën e nenit 384 dhe 387 të LPP u vendos si nën pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Përkitazi me pjesën lirues të aktgjykimit të kundërshtuar, pra për të akuzuarin Sadik Halitjaha, ankesa e prokurorit publik të qarkut në Prizren është e bazuar. Gjykata e shkallës së parë të akuzuarit Sadik Halitjaha e ka liruar nga akuza për vepër penale, bashkimi për veprimtari armiqësore të parashikuar me nenin 136 par.2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ, duke konstatuar: "poashtu gjykata vërtetoi se i akuzuari Sadik Halitjaha edhe pse ka marr pjesë në mbledhjen e këtij grupi armiqësor në tetor të vitit 1985 në shtëpinë e Nhabir Morinës nuk është antarsuar në këtë grup nga se pas leximit të planprogramit të grupit ka kuptuar se komiteti armiqësor në fjalë shtë themeluar me qëllime armiqësore kundër rregullimit federativ të RSFJ". Ky konstatim i gjykatës së shkallës së parë rrezulton nga deklarata e vet të akuzuarit Sadik. Nga kjo del se i akuzuari Sadik Halitjaha ka marrë në dijeni se po përgaditet organizimi i grupit armiqësor, është njoftuar dhe ka kuptuar platformën e këtij grupi, pra ka lexuar planin dhe programin e grupit armiqësor, Prandaj, në rigjykim gjykata e shkallës së parë duke pasur parasysh këto rrethana duhet të hetoi se e ekzistojnë në veprimet e të akuzuarit Sadik elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar, apo eventualisht të ndonjë veprë tjetër penale.

Nga arësyerat e cekura më lartë e në pajtim të dispozitës së nenit 385 të LPP, u vendos si nën pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ap.Kzh.nr.226/86 datë 17 shtator 1986.

Procesmbajtësi
Sadije Njekiqi,d.v.

Kryet ar i koelgj
Durmish Koqinaj

Barazhanë:
1.
2.

Saktësinë e kësij p...
Сагласност овог пре...
me origjinalin e vërtetoj
са изворним потврђује

Shefi i regjistraturës
së gjykatës
Управник судске
писарнице

Socialist... REPUBLIKA SOCIALISTE AUTONOME E KOSOVËS PRISHTINË



RBIMI I KONTABILITETIT SHOQËROR
BA DRUŠTVENOG KNJIGOVODSTVA

FLETËPAGESË E PËRGJITHSHME
OPŠTA UPLATNICA

FTESË – PRIZNANICA

nr. i postës
br. pošte

Shifra
Šifra

Rrjedha
Tok

o je: Skender Bashë Vranë

(emërtimi dhe adresa e paguesit) – (naziv i adresa uplatioca)

P-69/84
Kp-1/85-1

numri llogarisë – broj računa

68500-845/37

ëzuesit
iku Gjykata e Gjakut Prizren

(emërtimi dhe selia e shfrytëzuesit) – (naziv i sedište korisnika)

imi i xhirimit
a doznake Paushallesh

DIN. 5,175,-

besh.
ë numër
poziv
na broj

(kompenzimi i arkëtuar) – (naplaćena naknada)

(numri i ditarit) – (broj dnevnika)

(nënshkrimi) – (potpis)

1

drole

Në
U

më
dana

SHKSH – Obr. br. 10 SDK («Rilindja»)

Dëftesë me të cilën duhej heqë harxhimet e procedurës penale kundra meje.

NGA GJYQI I QARKUT NË PRIZREN

PËR VEPRIMTARI ARMIQËSORE U DËNUAN DY VETA

Prizren, 9 prill

Në Gjykatën e Qarkut në Prizren, para trupit gjykues të të pestëve, të cilin e kryesoi gjyqtari Fadil Nushi, sot përfundoi gjykimi i tre personave nga komuna e Suharekës, të akuzuar se janë marrë me veprimtari të organizuar armiqësore nga pozitat e nacionalizmit dhe të irredentizmit shqiptar, me qëllim të rrëzimit të pushtetit të klasës punëtore, të ndryshimit antikushtetues të rregullimit federativ të RSFJ dhe prishjes së vëllazërim--bashkimit dhe të bashkëjetesës.

I akuzuari Haki Gashi, 28 vjeç, absolvent i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë, nga fshati Semetisht, me aktgjykimin e Gjykatës është shpallur fajtor për shkak se ka kryer vepër penale të bashkimit për veprimtari armiqësore nga neni 136 paragrafi një lidhur me nenin 114 të Ligjit penal të RSFJ dhe u dënua me 7 vjet burg.

I akuzuari Skender Basha, 25 vjeç, student i Fakultetit të Shkencave Natyrore në Prishtinë, nga fshati Vraniq, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale të bashkimit për veprimtari armiqësore nga neni 136 paragrafi 2 lidhur me nenin 114 të Ligjit penal të RSFJ dhe u dënua me 4 vjet burg.

I akuzuari Sadik Halitjaha, 31 vjeçar, punëtor nga fshati Mushitisht u lirua nga akuza në mungesë të provave.

I akuzuari Haki Gashi, së bashku me një person tjetër, i cili gjendet në arrati, prej qershorit e deri në nëntor të vitit 1985, në Prishtinë dhe në fshatrat Reçan dhe Semetisht – KK e Suharekës, ka formuar grupin armiqësor në formë të treshit, të cilit i është bashkuar edhe i akuzuari Skender Basha, të quajtur «Komiteti i rrethit për territorin e Suharekës», i cili i përket organizatës armiqësore nga i ashtuquajtur «Komitet organizativ i marksist-leninistëve të Kosovës», i formuar me qëllim të ndryshimit antikushtetues të rregullimit federativ të RSFJ, që Krahina Socialiste Autonome e Kosovës të fitojë statusin e republikës, e bashkuar me të gjitha vendet e banuara me shqiptarë.

V.B.

Shkrim i së përditshmes "Rilindja".

U DH E Z I M

PERSONAT TE CILET U SJELLIN PAQETA DHE GJERA TJERA TE PARABURGOSURVE OBLIGOHEN QE T`IU PERMBAHEN KETIJ UDHEZIMI KONFORM RREGULLORES SE BURGUT TE QARKUT NE PRIZREN

1. PAQETA MUND TE PERMBAJ:

- Prodhime te keksave gjer me 1 kgr.
- Prodhime te mishit te thate gjer me 2 kgr. te prera ne copa gjer me 2 cm.
- Peme gjer me 3 kgr.
- Buke gjer me 2 kgr. e prere ne 4 pjese.
- Gjesende tjera dhe rrobe gjer me 2 kgr.
- Pesha e lejueshme e paqetes mund te jete gjer me 10 kgr.

Nuk pranohen gjerat qe prishen lehte, gjerat e paketuara prej fabrike te mbeshtjellur me ambalazhe te metalit (konzervat, tetrapak, te qelqit dhe te ngjashme) si dhe kafe, tambel, djath, pite dhe te ngjajshme me tekstin.

2. Vizitat behen ne çdo te 1 dhe 15 te muajit por ne ditet e punes prej ores 09 me lejen e marrur prej organit gjegjes i cili udheheq proceduren paraprake, duke patur ne konsiderim kohen e parashiquar ne lejen e dhanun. Paqetat mirren gjate dites ne kohen e vizites.

3. Te paraburgosurit mund te shkembejne letra me familjet e tyre 2 here ne muaj dhe ate te shkruar ne nje faqe te letres nese autorizohen nga organi i cili udheheq proceduren. Letrat me permbajtje fyese dhe te papelqyeshme nuk dergohen apo dorezohen.

4. Me rastin e dorezimit te paqetave, palet detyrohen te bejne regjistrimin e sendeve te cilat i dorezojne. Pa regjistrin e permbajtjes se paqetes, paqeta nuk pranohet. Fletoregjistrimin e sendeve e nenshkruan pala e cila dorezon paqeten duke theksuar daten e dorezimit te paqetes.

5. Paqetat kontrollohen me rastin e pranimit.

Gjerat dhe sendet e palejuara te cilat nuk perfshihen ne permbajtjen e paqetave sipas ketij Udhezimi i kthehen pales.

D R E J T O R I A

e Burgut te Qarkut ne Prizren

Socijalistička Republika Bosna i Hercegovina
REPUBLIČKI SEKRETARIJAT
ZA PRAVOSUĐE I UPRAVU
S A R A J E V O

Broj: 02-246-314/87

Sarajevo: 12.11. 7. 198.... godina

OKRUŽNI ZATVOR
S A R A J E V O

PREDMET: SKENDER BAŠA, osudjeni - premještaj.

Od Pokrajinskog sekretarijata za pravosudje i upravu SAP Kosovo - Priština dobili smo dopis slijedeće sadržine:

" Ovom Sekretarijatu obratio se osudjeni Skender Baša, s molbom za premeštaj na dalje izdržavanje izrečene kazne zatvora iz Zatvora u Sarajevu u neku od kazneno-popravnih ustanova na teritoriji SAP Kosovo.

S obzirom, da iz objektivnih razloga, nismo u mogućnosti dati saglasnost za navedeni premeštaj, molimo vas da obavestite imenovanog da je njegova molba za premeštaj odbijena".

Po prednjem molimo da postupite.

OBAVJEST: SKENDER BAŠA, osudjeni
OKRUŽNI ZATVOR
SARAJEVO

POMOĆNIK
REPUBLIČKOG SEKRETARA
Pašić Safet

Lënda mbi refuzimin e kërkesës sime që të vuaj burgun në Kosovë.



RS E SËRBISË KSA E KOSOVËS — СР СРБИЈА САР КОСОВО
KUVENDI I KOMUNËS SË SUHAREKËS-СКУПШТИНА ОПШТИНЕ СУВА РЕКА
12- Nr. 88
Бр.
15.01. 88 vit. год.
ZYRA E VENDIT BUKOSH
МЕСНА КАНЦЕЛАРИЈА БУКОШ

Na zahtev Raba Loshi iz s. Vranič SO SuvaReka,
izdaje muse -

P O T V R D A

Da RABA LOŠI,iz s. Vrabič SO SuvaReka,je žena BAŠA SKENDER u vanbračnom stanju.

Potvrda izdaje se na zahtev radi posete kod KPD.u Foči.

Sekretar mesne zajednice
Sahit LLugaxhija

Vërtetim se Raba Loshi është gruaja e Skender Basha dhe se mund ta vizitoj në burg.

Socijalistička Republika Bosna i Hercegovina
KAZNENO-POPRAVNI DOM
F O Č A

Broj: 03-4943/89
Datum: 24.11.1989. g.

Na osnovu člana 124. stav 2. Zakona o izvršenju krivičnih i prekršajnih sankcija (»Službeni list SRBiH«, broj 34/77), izdaje se

P O T V R D A
O IZDRŽANOJ KAZNI

kojom se potvrđuje da je BAŠA Ibrahima SKENDER

rođen 25.5.1961X godine u Vranićima SO-e Suva Reka

SR Srbija sa prebivalištem u Vranićima

SO-e Suva Reka SR Srbija

dana 24.11.1989. godine izdržao je kaznu zatvora u trajanju od 4/četiri/ godine

i - mjeseci po presudi ~~Opštinskog~~ — Okružnog suda u Prizrenu

broj K: 6/86 od 9.4.1986. godine.

Na izdržavanju kazne nalazio se od 24.11.1985. do 24.11.1989. godine.

Imenovani je pušten na slobodu po izdržanoj kazni, ~~xxxx

u zbuluan natën e së dielës në OT-Savua
franceze), njofton Zyra e doganave

joftimin e AFP-së që e përcjell "Bujku"
dije se refugjatët që udhëtonin të fshehur
një kamioni të marrë me qira dhe
yesi u kapën gjatë një kontrolli të
ën kur shoferi i automjetit në fjalë duhej
nte taksën e kalimit në autostradë. Ata u
në organet e drejtësisë.
shtëmbëdhjetë prej tyre kishin pasaporta
e pa vizë dhe tre të tjerë nga Kosova ishin
mente.
leklaruan se kishin ndërmend të shkonin
nani, ku udhërrëfyesi do të merrte rreth
arka gjermane, - theksoi drejtoria e
hme e doganave franceze. Trafikanti me
zvicerane, punonjës në hekurudhat e
ndi, i kishte marrë ata në ngarkim në
ku kishin mbërritur nga Bari duke ardhur
i Zi. Ai kishte pohuar se kishte organizuar
udhëtim tjetër në të njëjtat kushte dhe
e vete rreth 9.000 franka franceze (1.800
në valutë të ndryshme dhe një kartë
dërkombëtare që i përkiste nje personi të
het në një komunikatë të lëshuar nga i
rim.

ersiteti i Jenës ndau bursa r studentët dhe punëtorët shkencorë të UP-së

htinë, 17 prill (QIK)
orati i Universitetit të Jenës dhe Ministria
ngenit i kanë akorduar Universitetit të
s tri bursa për studentë dhe dy për punëtorë
orë të UP-së, njofton Shërbimi për
n i UP-së.
i nga këta bursa do të jetë nga Fondi i
e akordon kryeministri i shtetit Thuringen.
joftimin që me këtë rast i është dërguar
të UP-së, dr. Ejup Statovci thuhet se
iteti i Jenës ka vendosur të konkurrojë tek
onet adekuate federale gjermane për të
edhe bursa të tjerë për studentë dhe për
shkencorë të Universitetit të Prishtinës,
për pajisje me libra dhe me mjete tjera
e për Universitetin e Prishtinës.
ori Statovci i ka bërë ftesë rektorit të
itetit të Jenës prof.dr. Georg Machnik që
një Universitetin e Prishtinës.

anet e instaluara ushtarake erizaj u dërguan thirrje ish-oficerëve shqiptarë

htinë, 17 prill (QIK)
ve të fundit, organet e instaluara serbe të
s në Ferizaj u dërguan thirrje për mobilizim
erëve shqiptarë, njofton KI i Degës së
në Ferizaj.

Njoftohet se thirrje të këtilla deri tash janë shpërndarë në fshatrat Talinovc i Muhaxhirëve, Cërnillë, Varosh dhe Nikadin, ndërsa bëhet e ditur se ish-oficerët shqiptarë nuk u janë përgjigjur thirrjeve të këtilla.

Dhuna e përditshme në Kosovë

Prishtinë, 17 prill (QIK)

Kamenicë: - Më 11 prill, policia serbe thirri Zijadin Spahiun nga Muçivërci që të paraqitet në stacionin e policisë në Kamenicë. Z. Spahiu, i cili është sekretar koordinator i partive politike shqiptare në Kamenicë u pyet rreth funksionimit të partive politike, për trupin koordinues, si dhe për pëlqimin nga ana e LDK-së për zgjedhjen e Adem Demaçit për deputet në Parlamentin e Kosovës.

Ferizaj: - Më 16 prill, policia serbe me pretekst të kërkimit të armëve ishte në shtëpinë e Milaim Veselit në Greme. Policët iu kërcënuan bashkëshortes dhe vajzës së tij, që nëse nuk dorëzon armën, Milaimin do ta "hekurosin" me dajak.

Suharekë: - Më 1 prill, policia serbe e postkomandës së Mushtishtit i dërgoi thirrje Xhavit J. Bashës, anëtar i Kryesisë së Aktivit të LDK-së në Vraniq, nga i cili kërkoi të dorëzojë një pushkë automatike. Ai u urdhërua që të nesërmen t'i komunikojë Skënder Bashës, kryetar i Aktivit të LDK-së dhe ish-i burgosur politik, që të paraqitet në polici. Skënder Basha nuk u paraqit në polici, ndërsa të nesërmen, rreth orës 14, dy policë bastisën shtëpinë e tij dhe e arrestuan. Policia mori një material me temën "Pasqyra e lëvizjes së popullsisë gjatë viteve 1945-1955", 18 libreza të LDK-së, si dhe dokumentacionin personal. Nga ai policia kërkoi armë dhe i lanë thirrjen që të paraqitet sërish më 10 prill në stacionin e policisë në Suharekë. Ai u morë në pyetje edhe më 9, 10 dhe 11 prill.

Me të njëjtin pretekst në pyetje janë marrë edhe Sylë Basha, Sylë J. Basha i cili është keqtrajtuar fizikisht, Jakup Llugaxhiu dhe djali i tij Sahit Llugaxhiu, pastaj Ajet Shehu, Agim Basha, i cili është keqtrajtuar fizikisht, pastaj Hetem, Ali e Haxhi Kolgeci, ky i fundit në cilësinë e inkasantit të Nënkëshillit të KKF, së bashku me vëllezërit Sokol e Xhavit Kolgeci.

(Kronika e dhunës u përgatit sipas njoftimeve të komisioneve për informim të degëve të LDK-së)

Disa avokatë serbë kërkojnë që Jugosllavia e vetëshpallur të vëhet nën mbikëqyrjen e OKB-së

Prishtinë, 17 prill (QIK)

Kohë më parë në Vërnjaçka Banjë një grup avokatësh e filluan një peticion me kërkesë që Jugosllavia e vetëshpallur të vehet nën mbikëqyrjen e Oraganizatës së Kombeve të Bashkuara. Këtij

Njoftim i Qendra për Informim e Kosovës "QIK".



_____ Бр. SL / 96

ПОЗИВ

На основу члана 151. Закона о кривичном поступку, позива се BAŠA (IBRAHIM) ŠKELQER

по занимању POQOPRIVREDNIK са боравиштем у S. VRANIĆE улица — бр. —

у ODP SUVA REKA KOD MIŠKA IZ DB

/назив органа унутрашњих послова/

ул. — бр. — на дан 09 IV 19 96 год.

у 09 часова, соба бр. — ради давања обавештења у вези RADI OBAVJAŠTENJA INF. RAZGOVORA

У случају неодазивању овом позиву бићете принудно доведени на основу члана 151. ст. 3 ЗКП.

Овлашћено службено лице,

/М.П./

Обр. бр. 1 — Позив грађанину

Ftesë për paraqitje në bisedë informative në Shërbimin e Sigurimit Shtetërorë.

~~~
~~~